

Xhubleta në UNESCO!

GJUHA E SIMBOLEVE TE XHUBLETA

nga Luljeta Dano



Reportazh pa reporter mbi takimet nëpër
Shqipëri për promovimin e romanit më të ri
të shkrimtarit Visar Zhiti, “Këpuca e aktorit”

Me Visar Zhitin, ia mbathëm Shqipërisë *Këpucën e aktorit*

Nga Andreas Dushi

(fq. 4)

SHËNIME MBI LIBRAT

SHENJUESIT E REALITETIT KOZMOGONIK NË POETIKËN E KACALIDHËS

Nga Alisa Velaj

(fq. 8)

“PSHERËTIMA E HUMBjes”, E BUJAR SKËNDOS, NJË ROMAN QË MERITON VËMENDJE

Nga Fitim Zekthi

(fq. 18)

AGRON TUFA NË DY ROMANE

Nga Namir Lapardhaja

(fq. 9)

Romani i Fatit si Faj Tragjik. “Zemra
është një vend i vetmuar”, i Rudolf Markut

DY KOZMPOLITË TË VETMUAR

Nga Gëzim Basha

(fq. 10)

MREKULLIA E SHKRIMIT “MËRIA E ZANAVE” TË GRIGOR BANUSHIT

nga Zhuljeta Grabocka

(fq. 11)

SHËNIME RRETH ROMANIT “AMERIKANI” TË ODISE KOTE

Nga Dr. Dorian Koçi

(fq. 17)



ME KADARENË, NË SHTËPINË E TIJ

nga Anastas Kapurani

Kështu e takojmë shkrimtarin — dhe fjala këtu është përherë për shkrimtarin që rron me artin e vërtetë — në fillim në librin e tij, dhe pastaj në shtëpinë e tij. Pa nisur mirë, na duhet të bëjmë një sqarim, ngaqë nuk na lë të shtyhem më tej: fjalën *shtëpi* këtu e përdorim në kuptimin e strehës së shenjtë që mbledh për shkrimtarin hapësirën përtej librit. Atë që gjejmë në libër, ngjan që na del dhe tepron kur gjykojmë shkrimtarin. Dhe, megjithatë, ka një shtysë të brendshme, gati të papërbalueshme, që na çon medoemos në shtëpinë e shkrimtarit, aty ku shkrimtari i thotë bukës bukë dhe kripës kripë. Ç’është kjo shtysë, dhe nga vjen kjo dëshirë?

(fq. 13)

IN MEMORIAM FASLI HALITI

Nga Xhevair Lleshi

(fq. 15)

PIKËLLIMI I PËRKTHYESIT DEDË GAJTANI (KOLA)

Nga Xhahid Bushati

(fq. 6)



Takimi me Hitlerin pas pushtimit
nazist të Norvegjisë

KNUT HAM SUN

SHKRIMTARI ME KARRIERËN MË
TË ÇUDITSHME TË SHEKULLIT

Jeffrey Frank, *The New Yorker*

(fq. 22)

BIBLIOTEKË

Mirash Martinoviq

(fq. 14)

Kohë e poemave të mëdha

Biser Mehmeti

(fq. 12)

Lulja e hidhur

Aleksandër Bardhi

(fq. 16)

Perëndimi që vdes mbi lumë

Rei Hodo

(fq. 10)

Trekëmbëshi ku varen yjet

Rigel Rizaj

(fq. 21)

Lakuriqësia

Pol Milo

(fq. 7)

*“My way” në epokën e
performatizmit*

Dritare për kulturë gjuhe KEQPËRDORIME FJALËSH A “NGATËRRIME” GJUHËSORE

(fq. 5)

nga Akademik Jani Thomai

Rodrigo Garcias “Lamtumirë Gabo e Mercedes”
DASHURI, VDEKJE E KUJTME
NË KOHË PANDEMIE

Nga Enver S. Morina

(fq. 20)

*Kumtesë e mbajtur në Konferencën Vjetore Ndërkombëtare,
Takimet XVI të Institutit Alb - Shkenca, tetor 2021.*

GJUHA E SIMBOLEVE TE XHUBLETA

nga Luljeta Dano

Xhubleta në UNESCO - MIRËNJOHJA IME

Së pari falenderoj Ministrinë e Kulturës dhe Ministren, Znj. Elva Margariti që projekttoi dhe realizoi dosjen përkatëse, me mbështetjen financiare të Fondit Shqiptaro - Amerikan të Zhvillimit, AADF, punë falë së cilës kemi sot realitetin e shumëpritur: Xhubleta në UNESCO! Dijebërja e Xhubletës si teknologji artizanale dhe në format e përdorimit të saj do të ndikojë nëpërmjet politikave promovuese të turizmit kulturor të kemi sa më shumë zjarre ndezur në vatrën malësore, ku plaga sociale e shkretimit nga emigrimi i popullatës vendase është e rëndë. Pasqyrim i simbolikës së Qëndresës dhe Lirisë, Xhubleta Shqiptare me firmën e Tij, si Ministër i Kulturës, Z. Visar Zhiti, fitoi statusin e lartë, si KRYEVEPËR e Trashëgimisë Kombëtare Kulturore, në 12 qershor 2013. Falemnderit gjithmonë, Visar Zhiti! Duke qenë tanimë pjesë e trashëgimisë kulturore të qytetërimit njerëzor, paraqitja e Xhubletës nis si Kryevepër e trashëgimisë Kombëtare. MIRËNJOHJE të thellë, për këdo, me të cilin në rrugëtimin tim shtatëmbëdhjetëvjeçar me xhubletën, kam bashkëpunuar: studiuesit e etnologjisë dhe bartësit kulturorë, bijtë e Xhubletës, gazetarët e kulturës, koleksionistët privatë dhe tregtarët e antikuarit! Falenderoj me gjithë zemër miqtë e mi, emra të nderuar të letërsisë bashkëkohore shqipe që më përkrahën të parët dhe gjithmonë në atë që kisha për të thënë, si besimtarë të gjuhës dhe tekstit, e që mbështetën punën time ndër vite, për këtë gjuhë piktogramash të qëndisura mbi xhubletë, e cila mund të lexohet duke "u përkthyer" në fragmente të caktuara, madje hera - herës edhe si tekste më të plota, sipas fjalorëve të simboleve e miteve kozmogonike. Përulë me nderimin më të lartë për koleksionistët privatë shqiptarë, ata janë shpëtimtarët e vërtetë të xhubletës së vjetër me artin e tyre të koleksionimit dhe atdhetarinë, ka shumë sublimim dhe sakrifica individuale dhe familjare në çfarë kanë arritur! Kudo ku ndodhen këto koleksione etnografike në Tiranë, Shkodër, Kosovë, Mali i Zi, në thelb, ai është një: Koleksioni i shpëtuar i Xhubletës Shqiptare. Mendoj se, koleksioni tërësor i Xhubletës Shqiptare ndër koleksionet private numëron afro 1100 - 1200 xhubleta, pjesë e të cilit janë edhe gjashtëdhjetë xhubleta të koleksionit tim. Njerëz të kulturës, artistë, koleksionistë me interesa të ndryshme kanë koleksionuar nga njëzetë, dyzetë a njëqind e pesëdhjetë e gjer në gjashtëqind xhubleta. Në këtë inventar prej afërsisht 1200 xhubletash, nuk po numëroj xhubletat e trashëguara që ndodhen në familjet malësore. Në mjaft familje shqiptare sidomos në Mal të Zi, kam parë që ruhen në gjendje shumë të mirë në arkat e vjetra të pajave të nuseve gjer në tetë a dhjetë xhubleta të familjes. Edhe një kërkesë për Kuvendin e Shqipërisë në emër të Qendra Antropologjike XHUBLETA, të ligjësojë një ditë të caktuar, që të kemi: Dita Ndërkombëtare e Xhubletës.

Luljeta Dano

Padija ime sa vjen dhe rritet, sa më shumë shtrohen pyetjet që i bëj vetes ndërsa bashkëjetoj prej gjashtëmbëdhjetë vitesh me "tekstet" magjepsëse të Xhubletës Shqiptare. Si një kumt ogurbardhë, matriarka e studimeve etnologjike shqiptare, Prof. Dr. Andromaqi Gjergji, e çel një ligjëratë të mbajtur më 1995, se kultura popullore shqiptare është

një fushë hulumtimi, poaq arkaike sa gjuha shqipe, në mos më shumë... e që mbas kthesave të forta shoqërore, ato ripërtërihen. ... dhe do të gjejnë shprehje në shumë drejtime, ndoshta edhe me një shkëlqim të ri⁽¹⁾.

Objektet etnografike fotografuar për ilustrimin e kësaj kumtese kanë një vjetërsi fizike 100-250 vjeçare, por tipologjia e tyre, gjuha e simboleve të qëndisura në to, një farë shkrimi dore shkruar mbi shajak me spik, fije metalike apo rruaza shumëngjyrëshe, unë besoj se, vjen nga parahistoria ende e pamatur me kohë, gjuhë që fatmirësisht na vjen e gjallë ndër shqiptarët e sotëm.

Janë objekte nga koleksioni i jashtëzakonshëm i Xhubletës Shqiptare me stolitë e saj, që përbëhet nga arkiva etnografike shtetërore, koleksionet etnografike private, si edhe fototeka e pasur shqiptare dhe e huaj.


Si tipologji e veshjeve të lashta të kulturës minoike, xhubleta që vjen në kohën tonë ka disa pasqyrime në veshjet e vendeve mesdhetare, fort e ngjashme me veshjen



popullore të Malësisë së Avrës në Francë, disa guna shajaku në treva të tjera etnologjike shqiptare dhe ballkanike, ku paradigma e Xhubletës me Gunën Myzeqare me Rrëkë, i bën këto të dyja të duken si negativ i filmit me fotografinë. Guna Myzeqare me Rrëkë⁽²⁾, del me gajtanë të kuq, të bardhë dhe blu. Gajtanët tek xhubleta quhen spik dhe janë gjithmonë në ngjyrë të zezë. Spiku ka teknologjinë e vet të prodhimit dhe ndërtimit në veshjen me xhubletë. Një model tejet interesant dhe pikturik është kombinimi rreshtave të spikut me ivat e shajakta në kabanoren e fundit të xhubletës, në disa raste të rralla me ngjyra që fillojnë nga më të errëtat dhe vijnë duke u çelur, e zezë mbi të zezë dhe kjo larmishmëri e të zezës quhet Ylber i Zi.

Simotra e xhubletës në brigjet e largëta të Norvegjisë është veshja popullore norvegjeze e quajtur Bunad⁽³⁾, përkatësisht një model i veçantë që rrethohet në fund me një ose disa shirita të kuq ose jeshil, për të cilën shkroi së pari Prof. Dr. Agim Bido. Kjo veshje është e pranishme fizikisht që nga viti 1700. Janë pothuaj 55.000 variante të Bunad - it në mbarë Norvegjinë, duket një rekord marramendës, por Norvegjia ka gjithashtu Policinë e Bunad - it e cila monitorin çdo bartës dhe prodhues të saj që të mos shtojë asnjë element joautentik. Elementë të tjerë dekorues në filigramën e bunad - it norvegjez, janë afërsisht të ngjashëm në trajtë dhe funksion, si të xhubleta, me veti mbrojtëse të shëndetit atribuar ikonave kultike në stolitë prej ari dhe argjendi që shoqërojnë këtë veshje, çantat e dorës me dekoracionin metalik që të kujton kreun e kolonës zbkuruese prej filigramë te masha e xhubletës, vathët, manshetat e veçuara dhe të lidhura me lidhëse, madje shquhen edhe të njëjtat simbole të rozetës diellore, hënzës, yllit, Lules së Jetës me gjashtë petale, Lotusi Mistik, etj.

Sistemin e simboleve në piktograma, Manly Palmer Hall e quan gjuhë të mistereve të të gjitha natyrave: Një simbol mund të zbulojë ose të fshehtë, sepse për të diturit objekti i simbolit është i lexueshëm, kurse për të paditurit simboli mbetet i padepërtueshëm.



Pikëtakimi me këto figura - simbole që dekorojnë xhubletën shqiptare, para se të jetë etnicitet, apo mbishtresë antropologjike, pra, pikëtakimi sot me këto simbole është fundekrye transhendencial. Ashtu siç është numri ϕ , *fi* greke, raporti i artë, konstantja matematikore irracionale përafërsisht e barabartë me 1,6180339887. (Φ është përpjestimi hyjnor me të cilën besohet se Zoti krijoi botërat, natyrën dhe jetën, është sekreti i përmasave të përkryera në arkitekturë dhe arte). Ashtu siç është dhe π , *pi* greke, konstante matematikore irracionale, e ashtuquajtur konstantja e Arkimit, raporti i perimetrit të rrethit me diametrin e tij, përafërsisht e barabartë me 3,14159 26535... (π është një numër real duke mos qënë algjebrik, por konsiderohet ekuacion transhendencial).

Edhe natyra e simboleve potenciale të xhubletës për të cilat po flasim, mendoj që janë mirfilli të tilla.

Begatia e piktogramave në objekte të ndryshme, si në veshje, dru, gur, metal, shkëmbinj, shpella, ikonografi dhe mblata që shoqërojnë ritet zakonore, në lëkurën njerëzore si tatuazhe, ngado në trevat etnologjike shqiptare brenda dhe përreth kufijve të Shqipërisë ku banojnë shqiptarët, por edhe tek popujt e tjerë të Ballkanit, i përket një estetike transhendentale të arketipeve⁽⁴⁾, thënë me fjalët e Jungut, i mbart pavetëdija kolektive dhe bëhen një lloj altari për jetën e vetëdijshme, “*përbëjnë gjuhën e psikikës së lindur*”.

Xhubleta është trashëgimi kulturore kombëtare e popullit shqiptar, materiale dhe shpirtërore, në vetëdijën e të cilit Xhubleta simbolizon personazhe të rëndësishëm mitologjikë dhe historikë, Rozafën legjendare, zanat e maleve, heroinat e luftës kundër pushtuesit, Nora e Kelmendit dhe Tringë Smajla, madje artistikisht përfaqëson vetë Mëmëdheun, Nënë Shqipëri, në luftërat e saj shekullore për liri dhe pavarësi.

Antropologjikisht Xhubleta konsiderohet njëzëri nga studiuesit shqiptarë dhe të huaj me një bibliografi të pasur, një veshje me vijimësi modelesh të lashta të kulturës së popujve mesdhetarë, ende e gjallë tek shqiptarët e Alpeve, duke filluar me teknologjitë e prodhimit të pjesëve të ndryshme të saj, si veshje, si stoli, modelet e flokëve dhe ngjyra e sanksionuar e tyre, si dhe gjuha e simbolikës së përdorur në dekorimin e kësaj veshjeje, me funksion të lartë kultik dhe është bartëse piktogramash që tregojnë mite antike dhe parahistorike, si Perëndesha Athina, krejt siç e përshkroi H. Shlimman kur zbuloi Trojën, si dhe mitin kozmogonik të Hermiopolisit, etj.⁽⁵⁾

Në simbolikën gjetur në një brez xhublete, është vetë Athinaja me të gjithë parametrat që shënoi H. SCHLIEGMANN nga gjetjet e Trojës: Ajo ka fytyrë në trajtë kukuvaqje, sy të mëdhenj e të kërcyer, pa këmbët dhe pa krahët, me gjatësinë e bustit që në të gjitha rastet e paraqitjes së Athina Paladës shkon gjer te kërthiza. Kërthiza e Paladiumit Legjendar, me një rreth dhjetë herë më të madh se gjiri, dhe kordoni ombikal shoqërohen me simbolet e Zeusit, shoqërohen me një *Zvastika* që ka diellin në qendër, si dhe me një shembëlltyrë mburoje⁽⁶⁾.

Doktrina e krijimit të botës në qytetin Hermopolis, në Egjiptin e Mesëm hymnizon daljen e Pesë Perëndive nga Qyteti i Shenjtë i të Tetëve; një kryeperëndi dhe katër perëndi meshkuj që sollën secili dhe përbërësin e vet femër, domethënë katër femra si gjarpërinj: “Ishin katër elementë meshkuj dhe një prijës I Paemër që më vonë u quajt Thoti. Çdo njeri nga të katërt solli me vete përbërësin e tij femër... të katër meshkujt vizatoheshin si bretkosa dhe femrat si gjarpërinj që notonin nëpër baltën dhe llumin e kaosit, hiçit zanafillor, nga i cili u ngrit përpjetë gjithçka. Në “Tekstet e piramidës” thuhet se: Ujërat folën me Pafundësinë, Hiçin, Askundin dhe Errësirën, që do të thotë se Nuni u foli katër shokëve të tij meshkuj dhe kështu nisi procesi i krijimit. Ka të ngjarë që të katër elementët të kenë ardhur së bashku dhe jashtë bashkimit të tyre, erdhi veza zanafillore, e cila nuk mund të shihej, pasi ka ekzistuar para se të vinte drita. Jashtë vezës erdhi drita e diellit, të cilën të tetë elementët krijues të gjithësisë e ngritën lart në qiell”⁽⁷⁾.

Fenomeni i dekorimit me këto simbole në Kostumin Kombëtar Shqiptar me Xhubletë të grave të Veriut, pas një soditjeje të ngulitur pa ia shqitur sytë, në përpjekjen për t’i lexuar ato tekste, ka epërsinë të tejkalojë kështu vetveten. Ajo shkëlqen si dielli. Ornamentikën e qëndisjeve mbi këtë veshje mund ta familjarizojmë me shkrimin piktografik hitit e egjiptian, ose me petroglifet, tatuazhet, hajmalitë, mitet botëkrijuese dhe shkrime të tjera nga fise që ende dëshmojnë traditë dhe parahistori nga tërë kontinentet.

A është simboli i qëndisur në xhubletë mbrojtës për fatin e mirë të gruas që e mban? A është transformues në një ngjarje që në varësi të rrethanave duhet të përfundojë doemos mirë?

Çfarë duan të na kumtojnë këto simbole të pranëvendosura si tekste?

Parimi i kompozimit të ornamenteve në këto objekte etnografike është simetria majtas - djathtas ndaj një figure



të vetme në qendër, e ngjashme me simbolikën e Kultit Solar, ose me Katër Ungjillorët dhe Krishtin Pantokrator në mes; diku kemi ndoshta zinxhirët e ADN - së; spektrin e ngjyrave të ylberit; yjësi; fetusin, uterusin; gërma S që më së shumti del e shtrirë horizontalisht në simbolikë do të thotë gjysëm diell - gjysëm gjarpër, në optikë S përfaqëson udhën e realizimit të të parit nga syri, kurse në ornamentikën e veshjes së grave veriore shqiptare shumë e pranishme është edhe shenja e infinitit, 8 horizontale; etj. etj. Kurse numërimi i shenjëzave është gjithmonë numër kultik: nga 1 deri tek 10, 12, 13, 16, 24, ... etj. P.sh: Një simbol, i cili gjendet m’u në qendër të një përparëseje xhublete e cila veç të tjerave ka tre radhë horizontale me numrin e simboleve duke filluar nga poshtë rreshti i fundit në raportin 13:7:5, raport i cili mbart kode të rëndësishme piramidale ende të panjohura për ne⁽³⁾.

Së pari këtë figurëz, e përafrojmë me përhapjen e valës zanore, por më pas e gjendet e qartë dhe e njëjtë: 1. Si paraqitje grafike të magnitudës gravitacionale të planetit Tokë. 2. Si strukturë të krahëve spiralë të galaktikës së Udhës së Qumështit. 3. Si foto konceptuale të NASA - s, po të shihnim jashtë shtëpisë tonë galaktike, Galaktikën tonë të Udhës së Qumështit, strukturën e vëzhguar dhe ekstrapolare të krahëve spiralë të Udhës së Qumështit me Galaktikën fqinjë spirale NGC 7331, e cila referohet si binjake me Udhën e Qumështit, moshë e së cilës konsiderohet “which is nearly as old as the Universe itself”.

Pra, simbolin tonë të vogël etnografik e vendosim në pasqyrë me dy të tjerë përngjasues makroskopikë nga fushat e fizikës dhe astronomisë. Mundësitat që ofron sot interneti



për praktika të tilla ballafaqimi dhe afërie midis simboleve janë në infinit.


Mund të themi, se milionat e faqeve që mbushin internetin SOT me titujt e Dragoit Briartë të Gjenezës; Gjarpri Ktonik, Gjarpri me pendë; Feniksi; Shqiponja Dykrenore; Veza Kozmike; Pema Mistike (E Jetës); Lulja Mistike (E Jetës); Kyçi Egjiptian i Jetës; Merimanga, Akrepi dhe Kacabujtë - Brumbujt Mistikë; Teta e Shenjtë, (Infiniti); Fallusi Delfik; Simbolet Zeusiane: Gjethja treshe e Lisit të Shenjtë dhe Dy Gjethet Kryq të Lisit Të Shenjtë, Rrufeja; simbolet e kulturës minoane: meandrat lumore e detare, erosi mbi delfin, brirët e demit kretan, si dhe një shumicë simbolesh të tjera në planetin tonë që lidhen kryesisht me Kozmogoninë dhe atributet e Krijuesint të Gjithësisë, pranëvënia e këtyre simboleve qëndisur në veshjen tradicionale të malësorës shqiptare, leximi sipas këtyre rreshtave, më bën të besoj, se interneti nuk është një i ri 31-vjeçar, por “*Është aq i vjetër saç është vetë Universi*”!

BIBLIOGRAFI

- Andromaqi GJERGJI: *Probleme dhe detyra në fushën e studimeve mbi kulturën popullore*, ligjëratë e mbajtur në Seminarine 17 - të Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Tiranë, 24 gusht 1995. Botuar në librin: Ligjërata mbi etnologjinë shqiptare, Tiranë, 2004. ISBN 99927-35-94-5.
- Llambriini MITRUSHI: *Veshje myzeqare të shekullit XIX dhe të shekullit XX*, Etnografia shqiptare, nr. VII, Tiranë, 1976.
- The Norwegian Bunad*, lifeinnorwegian.net
- Luljeta DANO: *Perëndesha Athina dhe simbole të tjera Kozmogonike*, simbolikë, Tiranë, 2007, ISBN 99927 - 691 - 3 - 0.
- Luljeta DANO, *Po aty*.
- JACQUES, E. *Shqiptarët*, fq. 17 - 18, Tiranë, 2001.
- ARMOUR, R. *Zotat dhe mite të Egjiptit të lashtë*, fq. 174 - 176, Tiranë, 2006.



A tëherë kur Visari u largua nga atdheu, atdheu nuk u largua prej tij. Nëse poezia është një produkt i brendashkruar në shpirtin e njeriut që mandej del porsit tekst dhe po të kujtojmë poezinë e shkruar prej tij në burg më 1985, *Harta e atdheut tim*, porsit dy metafora të ngritura në fakte, e shohim atdheun që brenda Visarit rri e pret vetveten për t'i kthyer sado pak nga ajo që i mori e që ai bujarisht i dha. Kështu i thanë te Muzeu i Artit Mesjetar në Korçë kur deshëm të paguanim biletën, Shqipëria të është borbhlie aq sa ti je përjetë mik i çdo muzeu të saj.



Tek ishte në Jerusalem gjatë nëntorit, i premtova se kur t'i dilja për ta pritur në aeroport, do të kisha në dorë librin e tij të ri. Qeshi lehtë dhe mua mu duk sikur s'më besoi. Edhe tani ashtu mendoj kur kujtoj se sa u befusua paraditen e 19 nëntorit në Rinas. "Paska dalë kaq mirë!" tha, pa e hequr nga dora, ndonëse Eda ia kërkonte. Faji im që s'kisha dy kopje, s'më shkoi mendja, ndoshta ngase atë çift e shoh si një e vetme, i bashkuar për të qenë i pandarë, i pandashëm. Ishin akoma ditët e panairit. Me të ardhur të nesërmen aty, i tha gocave të Onufri-t në stendë "Po që qenka bërë punë e paçme, libri im qenka në miqësi të mirë!"

Për orë të tëra, deri sa tirazhi mbaroi, qëndroi dhe dha autografe. Lexues të shumtë, miq të vjetër e të rinj, disa me të cilët e krijoi në atë çast miqësinë, e shihnin, afroheshin, merrnin *Këpuca e aktorit* dhe zinin radhën e bukur, të shprishur, si kaçurela përballë tavolinës me në anën tjetër Visarin.

Paraprakisht kisha bërë një lloj kalendari ku do të shkonim dhe si do ta çonim librin te lexuesi. Fillimisht në Shkodër, Shkodra ime sepse është Shkodra jonë kujtoj t'i kem thënë Visarit në promovimin që u mbajt te biblioteka "Marin Barleti", biblioteka e qytetit. Lexuesit e prisnin, erdhën, e takuan

Reportazh pa reporter mbi takimet nëpër Shqipëri për promovimin e romanit më të ri të shkrimtarit Visar Zhiti, "Këpuca e aktorit"

Me Visar Zhitin, ia mbathëm Shqipërisë *Këpucën e aktorit*

Nga Andreas Dushi



Në bibliotekën "Marin Barleti", Shkodër

dhe e ndoqën me interes diskutimin, me ndërhyrje të herëpashershme, mes tyre edhe të profesorëve si Alfred Çapaliku apo shkrimtarëve, për shembull Xhahid Bushati.

Po atë ditë paradite, me ftesën e nanës time, mësuese letërsie pranë gjimnazit të jezuitëve "Atë Pjetër Meshkalla", Visari bisedoi me gjimnazistët e atyshëm për çështje nga më të ndryshmet. Takimi ishte konceptuar bukur, fillonte me interpretime të poezive të shkruara prej Zhitit para se të arrestohej, mandej pyetje nga nxënësit për to; poezitë e shkruara prej tij në ferrin plot rrugë që më në fund u çan, sërish pyetje e së fundmi, poezitë e lirisë, liri më e gjerë se çdo përgjigje.

Aq ishte Shkodra... E thjeshtë dhe e dashur me shkrimtarin.

Disa ditë më vonë ishim në Durrës. Biblioteka e atjeshme organizoi gjithashtu një promovim për librin, nga ato soj promovimesh që ngrihen mbi naivitetin e bukur e të dashamirësve më të singertë. Visarin e pritën me poezi, me këngë, me lule e me libra, aq sa s'di të them nëse më shumë libra kishim kur ikëm apo kur u kthyem prap në Tiranë.

intermexo

Me rastin e ditëlindjes së tij, më 2 dhjetor 2022, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë organizoi një ekspozitë me të gjithë krijimtarinë e Zhitit. Poezia e tij e parë me titull *Prapë* botuar në "Nëntori", cikli i parë mandej botuar në "Shtigje lufte", heshtje, prap, prap, prap, tmerr i ferrit në Spaç e Qafë të Barit, poezitë e shkruara në burg, liria!, cikli i parë në *Zëri i rinisë*, i dyti në *RD*, libri i parë me poezi *Kujtesa e ajrit* i dyti me poezi të burgut *Hedhë një kafkë të këmbët tuaja*, e të tjera, e të tjera, e të tjera, përkthime të tij në gjuhë të ndryshme, përkthime prej tij nga gjuhë të ndryshme, me dhjetra botime, proza e poezia. Të gjitha në ekspozitorë të vegjël, mbuluar nga kapakë të kristaltë ku bardhëllente liria, dhimbja, vuajtja, dashuria.

Në çeljen e saj foli drejtori i Bibliotekës Kombëtare Piro Misha që kujtoi se si u përfol arrestimi i Visarit, si u tha se u arrestua një poet, si u prit, me ç'ndjesi u shoqërua. Pastaj drejtoresha e Qendrës Kombëtare të Librit dhe të Leximit Alda Bardhyli u ndal në detaje nga krijimtaria e Zhitit, unë si

moderator thashë se isha i lumtur, shumë, për gjithë këtë. Ipeshkvi i Rrëshenit, imzot Gjergj Meta na kujtoi se si mund ta gjejmë pikërisht në personin e Visarit modelin e forcës dhe qëndrueshmërisë në shpresë, jo duke pritur por duke punuar për të. Në fund e mbylli botuesi Hudhri, me vlerësimin për krijimtarinë e Visarit dhe njoftimin se lexuesi tanimë do ta gjejë veprën e tij nën logon e Onufri-t.

Sado u munduan diktatorët, s'ja morën dot poetëve vendin që u takon në shprehjen se ata kanë vetëm lindje, pasi datëlindja e një poeti është ripërtërirja e datëlindjes së gjuhës me të cilën ai shkruan.



Disa ditë më pas, në Vlorë u mirëprit *Këpuca e aktorit* nga nxënësit e gjimnazit "Ali Demi". Me himnin e shkollës shkruar prej Timo Fllokos, ata i uruan Visarit mirëseardhjen dhe e pyetën lidhur me poezi, vargje, citate apo shprehje të marra prej romaneve e tregimeve të tij. E shoqëroja edhe unë, sërish. Hera e parë në Vlorë për mua. Një grua, besoj mësuese, mes të pranishëmve mbante në dorë një kopje të "ExLibris" me disa poezi të përkthëyra nga Visari dhe e shihja që e shfletonte me sytë mbi të, mandej i ngrinte e më shihte ngultazi. Me të mbaruar, më erdhi afër dhe e hapi gazetën në faqen e dytë. Ishte një intervistë e realizuar nga unë dhe përkrah titullit, sikurse është formati, një foto imja. "Ti je ky, apo jo?" tha. "Po..." "Sa i mirë qenke. Të ndjek çdo javë." dhe iku. U gëzova që lexoheshim, lexohesha edhe atje e besoj edhe ajo do të gëzohet kur ta shohë veten këtu.

Të martën me datë 6 dhjetor, e gjitha u mbyll në Korçë. Biblioteka "Thimi Mitko" në bashkëpunim me klubin letrar "Bota e re" organizuan promovimin e dy romaneve, të *Këpuca e aktorit* dhe romanit tim *Në besë të tatuazhit tënd*. E kisha me dyshim, s'kisha parë promovime të tilla, por e gjitha shkoi natyrshëm pasi i njihnim tekstet e njëri-tjetrit që në dorëshkrim dhe kishim kontribuar me këshilla te tjetri përgjatë shkrimit të tyre. Visari foli për librin tim, unë për të tijin, ju përgjigjëm pyetjeve, dëgjua akuza, dhamë mendime, nga ato që ka shumë të ngjarë tani mos t'i kujtojë më njeri, dhe bëmë foto, ndonjë autograf, intervista. Prap mes miqsh e lexuesish, nga moderatori Eris Rusi, pedagog e shkrimtar; drejtoresha e bibliotekës Jorida Tollkuçi; pedagogu e studiuesi Neli Naço u ndjemë mirë, mbi të gjitha u ndjemë të mirëpritur.

Dhe tani, kaq. Visari nesër në mëngjes herët nisat për në Çikago, unë i rikthehem punës së përditshme, ata që e morën librin ndoshta kanë mbaruar leximin apo akoma s'e kanë filluar. Nuk e di. Veçse uroj që gjurma e *Këpucës së aktorit* të mbetet përmbi Shqipëri.



Në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë



Në gjimnazin “Atë Pjetër Meshkalla”, Shkodër



Në gjimnazin “Ali Demi”, Vlorë



Në bibliotekën “Thimi Mitko”, Korçë



Në Bibliotekën Publike të Durrësit

Dritare për kulturë gjuhe

KEQPËRDORIME FJALËSH A “NGATËRRIME” GJUHËSORE

nga Akademik Jani Thomai



Në fillim dua të bëj një propozim: mendoj se “EXLIBRIS” është organi publicistik më i përshtatshëm për të hapur një rubrikë të veçantë e të përhershme për kulturën e gjuhës, aq e domosdoshme kur shqipja standarde sot po “masakrohet” në shumë fusha të përdorimit të saj, në drejtshkrim e në drejtshqiptim, në leksik e në sintaksë, jo vetëm në të folur, por edhe në të shkruar, - një rubrikë si dritare, në të cilën kushdo mund të përcjellë vërejtje gjuhësore ose nga e cila kushdo mund të mësojë të jetë më i përpikët në të folur e në të shkruar të gjuhës sonë standarde, të ngrerë kulturën e vet gjuhësore.

Më parë kam shkruar për një dukuri gjuhësore të ditës, që vihet re ende sidomos në ligjërimin politik e në publicistikë, veçan e nxitur nga “zjarri” i tepruar “i oratorëve patetikë” në luftën politike a konkurruese ndërmjet palëve, siç ndodh me shpërdorimin zhvlerësues të fjalëve (“Gjuha shqipe”, Prishtinë, 2014, 2, f.59-76). Aty kam përmendur, të shoqëruar me shumë shembuj, disa prirje të shpërdorimit të fjalëve në ligjërim, si: shpërdorimi i tepruar e pa vend i fjalëve me forcë të veçantë cilësuese e vlerësuese, veçanërisht i fjalëve me ngjyrim emocionues keqësues (sharje, përbuzje, shpërfillje, tallje, ironi, fyerje, urrejtje, poshtërim, baltosje etj.); fryrja e ligjëritimit me fjalë të huaja të panevojshme për “snobizëm linguistik”; fuqizimi tej së vetës i një rasti të veçuar si dukuri e përgjithshme për ta rënduar diçka më shumë se sa peshon, dukuri që vijon ende (“Tashmë nuk ka shqiptar në botë që nuk e di se F. M. nuk gënjen kurrë!”); denduria e përdorimit në shkallën sipërore të mbiemrave e të fjalëve të tjera cilësuese, vend e pa vend, nganjëherë sa folësi a shkruesi, edhe pse përmbledh gjithë fuqitë e mjetet e tij shprehëse, prapë duket që nuk gjen dot më ndonjë fjalë a shprehje më “të fortë” për të thënë, që ta nxijë më shumë dikë a diçka, me dëshirë të zjarrtë që përtej së vërtetës të ushtrojë edhe “trysni gjuhësore” te lexuesi a dëgjuesi, bashkë me tonin e ngritur e me gjeste teatrale; denduria abuzive e përdorimit të disa fjalëve të ditës, kryesisht të huaja (këto me kohë konsumohen e shuhen dhe vijnë të tjera fjalë të ditës, si: *implementoj, lajv, performancë, trend, problematika, prevalon, shou, në fakt...* etj.).

Po në këtë ligjërim politik më shumë, e si pasqyrë e tij edhe në publicistikë, vërehet edhe një dukuri tjetër, që tregon më së paku paditurinë gjuhësore të përdoruesve, pakujdesi a, më keq, zell për përshtypje të sforcuar, siç është keqpërdorimi i disa fjalëve a ngatërrimi i njëres për tjetrën, sidomos të fjalëve që janë afër nga shqiptimi (“kuazihomonime”), por të ndryshme, shpesh edhe të kundërta, nga kuptimi. Më shumë se interpretimi në këtë shkrim i kësaj “rrëmuje” në ligjërim, madje edhe qesharake, flasin shembujt që po sjellim këtu, duke kursyer identitetin e burimit për arsye vendi dhe të përsëritjeve të shumta në ligjëratë të shkruar e sidomos të folur, për të ardhur keq edhe nga ata që mendohet se janë të shkolluar:

Afrimitet (ndikuar nga *afrim*) për *afinitet*:

“...sipas interesave personale kanë krijuar një *afrimitet* të ngushtë e bashkëpunim midis tyre...”;

Afrofë (e ndikuar nga *afro*) për *aforfë* (<fr. *à forfait* “me akord; me afërsi, pa llogartitje”): “...në mungesë të skuadrës kundërshtarë e fituan lojën *afrofe* bardheblutë...”;

Guri i Josifit për *Guri i Sizifit*: “...ta votojmë këtë amandament, mjaft ma, se u ba si *Guri i Josifit*...”;

Iluzion për *aluzion*: “...bëri *iluzion* gjoja se e dinte kush ishte dëshmitar okular...”;

Komplimentar,-e (krh. fr. *complimenter* “përgëzoj”) për *komplementar,-e* (krh. fr. *complémentaire* “plotësues”): “...këto shoqata duhet të jenë *komplimentare* dhe jo përjashtuese...”;

Kopiloj për *kompiloj*: “... të *kopilos*h atje dënohesh me ligj, se është si plagjaturë...”; edhe si emër: *kopilim,-i* për *kompilim,-i*;

Monstër për *mostër*: “Kjo vlen si një *monstër* edhe për të tjerët që duhet ta ndjekin...”;

Njehsoj (nga *njeh* “numëroj”) për *njësoj* (nga *një*: “bëj bashkë; barazoj; unifikoj”): “... le t’i *njehsojmë* forcat në këtë ndërmarrje kaq të madhe që të arrijmë suksesin...”; edhe si emër: *njehsim,-i* për *njësim,-i*; si mbiemër: *njehsuar* (i, e) për *njësuar* (i, e): “...gjuha e *njehsuar* letrare shqipe forcon identitetin tonë kombëtar...”;

Paralelizoj për *paralizoj*: “...ia *kishte paralelizuar* krahun ai thes i rëndë e udha e gjatë...”;

Përshkruaj për *përshkoj*: “...populli ynë ka *përshkruar* një rrugë të gjatë e të vështirë deri sa arriti Pavarësinë...”;

Popullarizuar (i, e) për *populluar* (i, e): “...një lagje kaq e *popullarizuar* e bën jetën e banorëve të vështirë...”; edhe si emër: *popullarizim,-i* për *popullim,-i*;

Prefekt për *perfekt*: “...s’ka kritikë, e ka zgjidhur problemin vetë e në mënyrë *prefekte*, ashtu siç duhej...”;

Premtoj (it. *promettere* “premtoj”) për *permetoj* (it. *permettere* “lë, lejoj”): “... s’na *premt*on koha ta çojmë deri në fund këtë nismë, sado e mirë...”;

Prespektivë (ndoshta e ndikuar nga *pre-*, si te *predikoj, prefekturë, preferoj, preokupoj* etj.) për *perspektivë*: “...vendi ynë do të kishte një *prespektivë* të shkëlqyer, kjo varet nga vetë shqiptarët...”;

Recension për *recesion*: “...kush përgjigjet që jemi në një *recension* të plotë të ekonomisë...”;

Stimulim për *simulim*: “...ishte një *stimulim* i mbrojtësit, që mori kartonin e verdhë...”; edhe si folje: *stimuloj* për *simuloj*;

Traget për *target*: “...e ka realizuar *tragetin* e ditës, thotë, po asgjë s’ka bërë...”.

E kam takuar shpesh rrugëve të qytetit tim. Vonë ia mësova emrin. Për këtë arsye shumë kohë mbeti “I panjohur”, për mua. “I panjohur” mbeti gjithashtu, sepse nuk e përshëndeta dhe nuk e takova asnjëherë, së paku disa minuta. Po kështu ndodhi, për të mos e njohur, edhe pse “jetuam në një qytet”, siç thotë vargu i një poeti shumë të njohur.

Njeriu ende “I panjohur” për mua, pothuajse shëtiste vetëm. Me një vështrim paksa të çuditshëm, shpesh humbës... Ai vështrim, në at’fytirë të brengosur, i ngjante një hënë që nuk donte të perëndonte në qiellin e qytetit të tij, ku banonte. Sikur donte ta jetonte vetëm at’ shkëlqim hënor vetmitar. Sikur e kërkonte dhe e donte vetminë dhe perandorinë e saj.

“Ç’ ishte kjo vetmi e këtij njeriu, që ishte bashkëqytetari im ende i “panjohur”? Ishte një pyetje që ia bëja vetes, po në heshtje, sa herë e “takoja”, dhe përsëri ishim: “të panjohur”. Si ndodhi, kështu kjo panjohësi?!

Një ditë ndodhi e papritura. Po hyja në librarinë “Ora e Shkodrës”. Më pëlqen të vëzhgoj. Më pëlqen, krahas librave që blej, të shkëmbej dhe biseda me librarin (tashmë të njohur), për të marrë informacion të ri për librat që dalin apo që presin të dalin në qarkullim. Teksa po bisedoja... sytë e mi kureshtarë shëtisnin rafteve ku qëndronin librat radhë-radhë. Në një cast ndala sytë dhe u befasoja nga ajo që pashë. Një libër qëndronte disi mënjane. U afrova. E mora në duar me nxitim sikur do ta humbja... E vështroja kopertinën, shfletoja faqet... Sikur nuk i zija besë syve e librit që kisha në duar. Ai qëndronte para meje si thesar, tashmë i njohur. U gëzoja, sa nuk gëzohet njeri në botë. Autori i këtij libri të çmuar ishte ai, *‘I panjohuri’, ai që e takoja shumë herë dhe nuk arrita ta përshëndesja e ta takoja, së paku një herë*. Libri titullohej “Përkthime, poezi dhe poema”. Autori: Dedë Gajtani (Kola).

Në librin e tij mund të numëroje 65 autorë të huaj, ku Deda si poliglot gjuhësh, me kulturën e tij admiruese e gegënishten e tij të dashtun i kishte përkthyer kujdesshëm, me kompetencë. Deda, me anë të këtij libri, me mjeshtërinë e tij të përkthimit na bëri të njohur autorë pak të njohur e shumë të njohur botërorë që lëvronin gjininë e poezisë, duke rritur lavdinë e frymëmarrjen e gjuhës shqipe.

Për punën dhe vlerat e tij, helenisti Gjon Shllaku 22 vjet më parë do të shkruante kështu: “... , mësova në mënyrë të posaçme se Dedë Gajtani ishte shumë i avancuar në gjuhën latine dhe ishte në gjendje të zotëronte krejt fjalorin latinisht-shqip të Padër Aldigerit. Me kohë u informova se Deda, nga që kishte një pregatitje të jashtëzakonshme të gjuhës italiane, gjithashtu kuptohet edhe për gjuhën shqipe, kishte bërë përkthime të shumta nga letërsia latine: si nga Tibuli, disa prej elegjive të këndshme e të dhimbshme; nga Properci, lirika të shquara për pasuri, stil dhe ide të larmishme; ndonjë nga poemat elegante të Katulit dhe të tjera nga latinishtja. Nga letërsia italiane kishte përkthyer lirika të Aleksandër Manzoni, si: “Pesë maji” etj. Kishte përkthyer “Kisha e Polentos” dhe “Valët e Klitumnit” të Karduçit, etj., etj. ... Pas disa vitesh që kishte dalë në pension, më erdhi në shtëpinë time në Qafë-Hardhi. U gëzoja pa masë që më erdhi në shtëpi, ai personalitet i ëmbël, modest, i thjeshtë, pensionist, por energjik. Kishte sjellë me vete një paketë të madhe me dorëshkrimet e veta. Mbaj mend që lexuem me kënaqësi të madhe përrallat e Fedrit me një gegnishte të pastër, të rrjedhshme, me fjalë të zgjedhuna e shprehje të larmishme origjinale shqipe, thuajse

Shënime për librin “Përkthime, poezi dhe poema” të autorit Dedë Gajtani (Kola), Filara, Tiranë, 2014

PIKËLLIMI I PËRKTHYESIT DEDË GAJTANI (KOLA)

Nga Xhahid Bushati

po lexon Fedrin në origjinal (shqip), por me të ardhë gjynah që ai përkthim, dhe shumë lirika, balada, poema të huaja: gjermane, italiane, latine; të përkthyer me aq elegancë dhe harmoni në gjuhën shqipe nga mendja e dora e mjeshtri poet Dedë Gajtani, nuk kishin parë dritën e botimit.”

Dedë Gajtani lindi në Gajtan, Shkodër, më 07.06.1915. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Kolegjin Saverian (Jezuitëve) në Shkodër. Ndërsa studimet e larta i vazhdoi në Kolegjin “Propaganda Fide”, në Romë, Itali, të cilat i mbaroi në vitin 1941. Që në shkollë të mesme e më vonë kur ishte student filloi të shkruante poezi. Ishte i apasionuar pas letërsisë botërore dhe gjuhëve të huaja. Nga viti 1941-1945 punoi në Institutin e Studimeve (Bibliotekën “Dante Alighieri”) në Tiranë. Në vitin 1945 emërohet arsimtar në Fier. Këtu fillon edhe kalvari i vuajtjeve të tij. Në një ditë të vitit 1946, kur ishte duke shëtitur në Manastirin e Ardenicës, e arrestojnë. E mbajnë disa muaj në hetuesi, në burgun e Beratit. E akuzojnë si agjent të Vatikanit, të Amerikës, etj. ... Pasi del nga burgu në vitin 1947, atë dhe familjen e tij e dëbojnë nga Tirana për motive

politike. Dedën e emërojnë arsimtar në Maqellarë të Peshkopisë. Më pas në Krujë. Pas një viti e pushojnë nga puna. Në vitin 1954-1958 emërohet përsëri mësues fillore në fshatin Orosh të Mirditës, më pas në malësitë e Dukagjinit, e më pas në fshatrat e Malësisë së Madhe. Në vitin 1965 e pushojnë përsëri nga puna. Punoi punëtor ndërtimi për 5 vjet, deri sa doli në pension. Ishte i apasionuar pas natyrës, pikturës, notit dhe shahut. Ndërroi jetë, më 07.12.1993, në moshën 78-vjeçare në Shkodër. Po të shikohen “udhëtimet” e jetës së Dedës e po të shënohen në kalendar, ai kalendar është gjithë vuajtje. Është ferr, tmerr, dhimbje e pafund!

Libri “Përkthime, poezi dhe poema” më shumë se gjithçka, nga koncepti dhe struktura, i ngjan një antologjie të pasur poetike. Ndërsa vetë autori i ngjan një “Lundërtari” që shtegtoi qytet më qytet, shtet më shtet, kontinent më kontinent, duke kapërcyer dete dhe oqeanë; vetëm me një qëllim të vetëm e fisnik: të sjellë në gjuhën shqipe sa më shumë emra poetësh të huaj, sa më shumë botë përkthimore. Nuk u lodh së punuari! Ndaj kjo gjeografi poetike “e vizatuar” në këtë libër, ka vetëm dimensionet e pasura kulturore.




Të bie menjëherë në sy edhe kultura shumëgjuhësore e autorit. Me emrin e Dedë Gajtani lidhen poezitë e përkthyer nga: A. Rossini, A. Manzoni, A. Aleardi, G. D’Annunzio, H. Heine, V. Hygo, L. Ariosto, G. Barsottini, Brunamonti, Carrer, G. Capparozzo, D. Guerrazzi, G. Chiarini, A. G. Cesareo, T. Colonna, Chateaubriand, L. Pignoti, G. Mazzoni, G. Carducci, Delille, V. Da Filicaja, G. Deabato, Paul Derouledé, U. Foscolo, A. Fusinato, Longfellow, A. Fogazzara, T. Grossi, J. V. Goethe, A. Graf, G. Giusti, I. Kasandrie, Ada Negri, G. Prati, G. Leopardi, R. Fucini, V. Maro, G. Marradi, A. De Musset, B. Menzini, Mayo, A. Novaro, E. Nencioni, G. Pascoli, P. Parzanese, B. Prina, E. Praga, E. Panzacchi, G. Pastocchi, A. Poliziano, Ruskin, Rinaldi, G. Catullus, F. Schiller, Shelli, B. Sestini, T. Tasso, J. Da Todi, E. Von Bauerfeld, N. Tommaseo, Felic Uda, G. Zanella, A. Zardo, Hebel, C. Bertola; si dhe përshtatje poezish sipas L. Orsinit, A. Manzoni, G. Berchetit.

Dedë Gajtani shumë nga përkthimet e poezive të autorëve që përmendëm më sipër, si dhe të poezive autoriale, i botoi, nëpër vite, edhe në këto revista: “Kumbona e së Dieles”, “Rrezja jonë”, “Shkëndija” (Tiranë), “Mbas Teje”, “Jehona e së Dieles”; në gazetën: “Balli i Rinisë”, “Zani i Shna Ndout”, Bashkim i Kombit” (Tiranë), “Cirka”, “Familja e Krishterë”. Nga gjurmimet tona, na rezultoi se plot përkthime e krijime janë botuar para vitin 1944. Ndërsa të tjera shkojnë edhe pas vitit 1992.

Në pjesën e dytë të librit, Deda kësaj here na shfaqet si krijues, ka përfshirë një cikël poezish, që në formimin e tij kulturor ndjek me besnikëri shumë shkolla poetike të autorëve të përkthyer e pse jo ata kanë dhe ndikimin e tyre, veçanërisht në imazhin poetik. Gjithashtu në këto poezi reflektojnë dhe gjurmët e jetës së tij plot trazime, vuajtje e pabuzëqeshje. Kështu tek poezia “Malli” që i kushtohet Shkodrës, do të gjejmë filladë malli, brengash, kujtimesh, dashurie për qytetin e lindjes. Ndërsa tek poezitë “Kalasë së Rozafatit”, “Andërrime - Vegime”, “Kujtime” etj., në mes andërrimeve vërejmë edhe nota pesimizmi, të kuptueshme këto për një shpirt të lodhur e të raskapitur siç ishte ai i Dedës. Edhe pse në këtë gjendje nuk harron t’u kushtojë poezi Poetit t’ambël Shantogjës me titull “Zogu pa çerdhe” e Mësuesit të tij Ndre Mjedjes, për të cilin thotë: “Atje në Mjedë vajtojnë bilbilat, / Përmbi gema të njomë të fojletës. / E përsërisin lehtë currilat / Si tue kja andrën e jetës.”

Në vazhdim të ciklit, po përmend një poezi e cila është shkruar italisht dhe ia kushton të shoqes Marijes, të cilën e quan Ave Maria. (Deda është në Romë. Është viti 1938.) Kurse tek poezia në formë ninulle që ia kushton “Vajzës sime”, spektri i gjerë i dashurisë atnore zë vend hijshëm në çdo fjalë e rrezaton në çdo figurë që përzgjedh me kujdes prindi. (Peshkopi, viti 1949). Në fund po lë ca rreshta për poezinë “Nanë, lamtumirë!” Meditimi përmes vargut refren: “Nanë, lamtumirë!” sikur shkrin përmallimet dhe dramën e poetit.

Shkodër, tetor, 2022



*Kam jetuar një jetë të mbushur plot
Kam udhëtuar në çdo autostradë
Por më shumë, më shumë se kaq
e bëra sipas mënyrës time!*
Frank Sinatra, My way

Në brigjet e adriatikut lindor, në një tavernë, bar apo lokal, të arëduar me dërrasa, ishte ulur një piktor dhe një shkrimtar. Ata kishin një gotë balte përpara. Dukej si birrë e veçantë. Në hyrje, një shkrim me drita ndriçuese, kishte shkruar emrin e lokalit. *My way!* Mënyra ime. Stili im.

Më tej ishte edhe një foto e këngëtarit Frank Sinatra. Ndërkohë që piktori dhe shkrimtari ishin përqendruar në diskutime të veçanta mbi artin kontemporan, dhe kritika të barasvlershme me artistët e mbarë botës, ose ndoshta, edhe fare të pabarazvlefshme. Por askush nuk do të mund ta përcaktonte këtë. Ndërkohë që dy miq të tjerë të tyre erdhën dhe u bashkuan me ta në tavolinë.

Ka qenë viti gjashtëdhjetë e nëntë kur këngëtari Paul Anka shkroi tekstin e këngës legjendare *My Way*, i frymëzuar nga nga një këngë franceze të po asaj periudhe. Më pas këngën ja besoi më së miri këngëtarit të famshëm Frank Sinatra, i cili e shëndroi në një hit të pavdekshëm. Në vitin shtatëdhjetë e katër ai e këndoi atë në oborrin e *Madison Square*, ku la pas, një nga regjistrimet më prekëse të një periudhe të plotë të postmodernizmit muzikor, drejt fundit të saj.

Ndërkohë që rrymat e reja të ekzibicionizmit muzikor kishin filluar të hidhnin hapat e para. Në fillim të viteve shtatëdhjetë, grupet muzikore si *Deep Purple*, *Pink Floyd*, *AC-DC*, *Jethro Tull*, *Black Sabbath*, dalëngadalë po filloni të rriteshin, për të pushtuar tregjet muzikore në pesëdhjetë vitet e ardhshme. Të gjitha këto ndryshime në botën e artit dhe të muzikës, hapën dyert e ndryshimeve, duke modifikuar strukturalizmin tradicional, duke thyer tabutë e ndaluara dhe duke futur mundësinë për konceptime të reja artistike, drejt një performance të re. Kishte filluar epoka e *Performatizmit Artistik*.

Moda gjithashtu hyri në një fazë ndryshimesh, dhe bashkë me të filluan të ndryshonin stilet e lokaleve, pub-eve, bareve apo tavernave.

Një kombinim të till e gjen në një qytet antik bregdetar, me traditë të lashtë në ndërthurjen atipike të stileve dhe kulturave. Në një lokal të arëduar me dërrasa, sapo hyn sheh veten të rrethuar nga një kombinim artistik që të bën të ndihesh rehat. Këto diskutime dhe kritika artistike, të vlefshme, të barazvlefshme apo të pabarazvlefshme, lundronin në tavolinë.

– Një birrë të lutem – porositi Martini.
– Çfarë birrash kini?

Në lokal binin në sy një sasi e madhe me logo birrash nga më të ndryshmet. Benediktiner hell, Bitburger, Fischer, Erdinger Weissbrau, Tennents larger.

– Dëshiron të provosh një Benediktiner Hell? – tha një kamariere e buzëqeshur, sikur vinte bashkë me birrën nga europa veriore, e ftohtë dhe e sjellshme. Ndërkohë që kënga *Civil War*, nga grupi Guns N’ Roses dëgjohej në sfond, e shtonte etjen për birra të sapo prezantuar. *Civil War!* Luftë civile. Sapo përfundon një luftë, fillon menjëherë një tjetër. Duket sikur grupet e *rock*-ut ishin parashikuesit më

“MY WAY” NË EPOKËN E PERFORMATIZMIT

Nga Pol Milo

të mirë të historisë, pas Nostradamusit. Kur bëhet fjalë për parashikime, të gjithë duan të shohin apokalipsin. Fundin e madh. Finalen. Tokën që përmbysen, yjet që bien, detin që ngrihet dhe si në ekranet e kinemave futuriste dhe performatiste, koka, pasi ngrihet lart, përfundon... me një birrë.

Hell!

Një Benediktiner Hell? Çfarë lloj birre është kjo?

Një Benediktiner Hell, dukej si një bekim në ferr. Një formulë e krijuar nga dikur, para katër shekujsh, nga murgit Benediktiner në manastirin Ettal, në zonën e Bavarisë.

Birrat erdhën nëpër gota balte si poçe mesjetare, kurse muzika kishte kaluar nga Guns N’ Roses te AC-DC. Highway to hell! Goditjet e baterisë vibronin lëngun në gotë. Autostrada për në ferr, me një Benediktiner në dorë. Benediktiner Hell! Ç’ferr apo parajsë!?

– Kjo është birra ime, mënyra ime, *My way!* – tha Martini.

– Ja, do ta shohim! – tha shkrimtari i çuditshëm pranë piktorit.

Ndërsa piktori qëndronte pranë murales së ekspozuar dhe fantazonte në brendësi të mendimit të tij. Nëse duhej një kompozim klasik dhe enigmatik, apo një peisazh veror me palma dhe plazhe tropikale, të cilat freskojnë iluzionet.

Këtu ka disa kombinime absurde për mendimin. Këtu ti je edhe shkrimtari, edhe poeti, je njëkohësisht edhe piktori, edhe shkencëtari! Mund të pikturosh universin, por edhe mund të jesh vetë ti që krijon universin tënd. Ashtu si ti do! Tashmë je në epokën e performatizmit, antistrukturalizmit, ti mund të thyesh rregullat dhe ti rindërtosh konceptet e tua si të duash. Edhe për së prapthi.

Murgu i bekuar, krijuesi i formulës magjike, duket sikur rri sipër fuçive me birrë dhe kënaqet me ne kur na dëgjon. Të gjithë e shijojnë formulën e tij magjike, por asnjëri nuk do që të zbulohet ajo formulë, asnjëri nuk do ta hetojë atë. Ajo është

perfekte. Më mirë le të mbetet mister. Le të qëndrojë ashtu si është, mjafton që birrat të jenë brenda stilit të vet, mjafton që birrat të mbushen njëra pas tjetrës. Edhe të pihen gjithashtu njëra pas tjetrës. Secila sipas stilit të vet. My beer, my way! Ky është performatizëm. Nuk është më postmodernizëm. Në epoka të çuditshme globale, në vende të çuditshme antimoderne me klimë mesdhetare, edhe të huaj e vizitorë habiten me zakone tërësisht në ndryshim.

– Por sot, ama është ndryshe. Sot është ekonomi tregu, – tha shkrimtari, – nuk është më formati standard. Sot tregu është i lirë. Çdo gjë, sot, përcaktohet nga tregu. Kërkesë, ofertë!

Piktori pohoi me kokë.

– Për çfarë shkruan ti shkrimtar? – pyeti ai, – Për njerëz të ligj? Apo për njerëz që vuajnë?

– Jo, kurrsesi nuk mund të shkruaj për njerëz të ligj. As për njerëz që vuajnë. Ndoshta për njerëz të mirë, që pinë!

– Pse, ata që pinë, a nuk vuajnë?

– Ndoshta. Këta të mite janë njerëz të mirë. Pinë por dëgjojnë muzikë. Duan ritëm, stil! Jazz, blues, rock. Por kryesorja është që duan të pijnë. Birra! Nga më të çuditshmet. Mundësisht artizanale.

Po ti piktor? Çfarë pikturon? Njerëz? Peisazhe? Karaktere?

– Pyetje e bukur! – tha piktori, – Po, dikur pikturoja njerëz. Kam pikturuar njerëzit e qytetit tim. Të gjithë, një nga një! Pa asnjë përjashtim. Më Pas i ekspozova atje, në galerinë qendrore të qytetit. Disa më falenderuan. Disa të tjerë më shanë. Njerëzit kanë frikë nga pikturat e tyre. Pëlqejnë pikturat e të tjerëve. Por kur shohin veten e tyre të pikturuar, tremben. Njësoj si *Dorian Gray*. Nuk duan të shohin anën e tyre të errën. Janë po ata njerëz që i duan pikturat. Por jo pikturat e tyre.

Ata duan pikturat e njerëzve të tyre të dashur. Ata duan ti kujtojnë ata. Piktura është rruga drejt kujtesës, një hap pranë përjetësisë. Njerëzit nuk i duan pikturat e veta, por ama duan stilin e vet. Nuk e duan stilin e tjetrit. Ata duan stilin e vet



dhe pikturën e tjetrit. Kurse pikturën e vet dhe stilin e tjetrit nuk i duan. Tani nuk i pikturoj më njerëzit. As karakteret. Jam i lodhur me to. Tani pikturoj peisazhe, plazhe. Murale!

Në qytetin bregdetar, që shtrihet si murale plot ngjyra në perëndim, dëgjohej një muzikë rock. *AC-DC*, *Thunderstruck!* I goditur me rrufe! Ndërkohë që në televizor transmetohet një ndeshje futbolli. Në lokalin e veshur me dërrasa, dallohet qartë një logo. *My Way!* Rruga ime? Jo, tamam. *My way!* Mënyra ime! Stili im!

Është një stil jetese, një stil vetjak i të bërit të gjërave, një mënyrë e kalimit të kohës, për të krijuar një kuptim, një ide, një mendim, një pasion, vullnet apo dëshirë.

“Është dëshira ime, që kam për të jetuar kështu. Plot pasion!”

Ndërkohë që birrat e shumëllojshme me gota qelqi dhe balte të shoqëruara me kikirikë dhe kripë i japin karakter këtij shërbimi. Benediktiner hell, Bitburger, Fischer, Erdinger Weissbrau, Tennents larger. My Way. Karakteri im. Stili im, stili juaj! Kombinimi i stileve. Imi dhe juaji. Kush e bën më mirë. Muralja e ngjitur në murin përbri e konfirmon më së miri këtë!

Epilog:

Piktori i dëshpëruar kishte ndezur çakmakun dhe e kishte drejtuar drejt murales.

– Piktor, përse po ja drejton çakmakun murales? A nuk e sheh se ai cigaren, fundja, e ka të ndezur?

– Nuk dua ti ndez cigaren, dua ta djeg! – tha piktori.

– Po përse do ta djegësh atë murale?

– Do ta djeg, do ti vë flakën, sepse s’kam marrë asnjë lek për punën e bërë. Punoj dhe nuk më paguajnë për punën time.

– Po unë që s’kam shitur asnjë libër, çfarë duhet të bëj? – tha shkrimtari, – A ti djeg edhe unë librat që nuk kam shitur!?

Dyrrah, dhjetor 2022



Jorrrallë në poetikën e Kacalidhës rrimeren të njëjtët shenjues. Për shembull, përmendet herë pas here shenjuesi i heraldikëve. Ka heraldikët e saj era, ka heraldikët e saj edhe bora. Diku surrealist e diku tjetër i përfytyruar në kufijtë e onirikes, përmendja e shenjuesit nuk është as e rastësishme, as harresë për monotoninë e qenies. Është lajtmotiv i poezisë që krijon një **botë universale, ku kundrohen ngado simbole dhe shenja të veçanta, të cilat përmes gjuhës metaforike komunikojnë me natyrën dhe elementet e saj të përjetshme, të studiuar këto edhe nga filozofët e lashtë grekë**. Bota përreth me enigmat e saj dhe habitja e realitetit në të cilin ndihemi si të hedhur, krijon asosacione nga më fantastiket tek uni lirik. Këmbëngulja për zbulimin e shenjave përfton ndërlidhjen e elementeve fantastike, shkrirjen e tyre me një të tillë natyrshmëri, sa të duket se magjika që ndodh para syve të lexuesit është i vetmi realitet. Magjia është reale dhe realiteti është magjik. Është ky asosacioni i unit lirik përkundrejt botës dhe i lexuesit kundrejt tekstit që me sa duket e ka shtyrë dhe studiuesin Jorgos Markopulos të mendojë se është *sinkronizimi i ndryshëm nga i yni i poezive të Kacalidhës që përmbys çdo vështrim të cekët, sa mund të lexohen si etnografike, duke shpalosur një realitet tjetër analog me atë që në prozë përcaktohet si realizëm magjik*. Është kaq mitike dhe kaq fëminore soditja plot kërshëri e unit lirik sa shenjat e zbuluara i përkasin një bote të përralltë. Surrealizmit i mbivendoset kështu magjika e pacak, duke i mëshuar thelbit të manifestit të realizmit magjik: *besoja në magjinë e jetës reale*.

“Nën këtë qiell dimëror dhe drurët lakuriq si

e vërteta, dalë prej baptisterit të pagëzimit, kanë ngritur duart drejt diellit dhe universit.” (Nën këtë qiell drurët s’mund të heshtin)

Kështu është dhe uni lirik i poetit, si ky dru i lakuriqtë e i vërtetë, që ka ngritur duar lart drejt diellit e universit, në lutje e përgjërëm për natyrën që t’i shfaqë shenjat e saj.

Në agun e krijimtarisë, Kacalidha pataksej prej shenjave të realitetit dhe vetëm i rrëfente ato. Ja si përjetohet për unin lirik dhe recipientin e tekstit poetik ajo çka quajmë pataksje, në poezinë “Katër qiparisa zgjateshin në muzg”, botuar në “Zërin e rinisë”, në maj të vitit 1970: Poezia e shkurtër, e ndërtuar mbi pesë distikë ka këto vargje: *“Katër qiparisa zgjateshin në muzg/ Fryu veriu i natës, njëri u këput/ Në mëngjes u zgjuam, dheu qe acar/ Qiparisi i anës, mespërmes qe çarë/ Tre të tjerë rrinin mbështjellë në borë/ Si bardë vështronin brymën dimërore/ Në mëngjes rrugicat bora kishte zënë/ Me një vig e ngritëm bardin tonë të rënë/ Ahe, pisha, bredha, zgjateshin në muzg/ Bardët mes dëbore mbartnin lart një bust.”* Së pari, na habit vetë konceptimi i poezisë. Poezi të tilla eliptike, të ndërtuara me frymë kaq moderne, të mbrujtura me metafizikën e jetës e dramave të saj, në vitet ‘70, i gjejmë vetëm në këta tri poetë në arealin e Shqipërisë londineze: Fatos Arapit, Sadik Bejkos dhe Niko Kacalidhës. Ajo çka e ndan poetin në shqyrtim nga dy të parët, si në fillimet e krijimtarisë si pas gjysmë shekulli, është se parajsat poetike sendërtohen në tokë. Ndërkohë Arapi e Bejko kanë përzierjen e botëve në ashtet e poetikave të tyre. Lënda qiellore ngjiz një nostalgji për absoluten te Arapi, ndërsa te Bejko një thirrje askurrë të ndryshueshme, se zvetënimet e trajtave e himneve tokësore mund të ringjallen vetëm prej së larti. E nëse me Bejkon, Kacalidhën e bashkon shenjuesi i gurit dhe një anë e errët e poezisë së secilit, ku te Bejko mbizotëruese mbetet e errëta, ndikim nga poetët ekzistencialistë italianë dhe poezia greke, ndërsa te Kacalidha, e

SHENJUESIT E REALITETIT KOZMOGONIK NË POETIKËN E KACALIDHËS

Nga Alisa Velaj

(Vijon nga numri i kaluar)



errëta ecën përkrah me të dielltën, ajo që i ndan dy kolegët është mënyra e ndryshme se si çdonjëri poet e ndërton murin e vet poetik në aksh hapësirë. Për Bejkon, shenjuesi i gurit është simbolika dhe alegoria e gurit ekzistencial në kufirin mes dy botëve, ndërsa te Kacalidha guri është një mister nga të shumtët në botën tonë të dukshme, që patjetër duhet deshifruar.

Poeti dygjuhësh ndikohet nga fryma e poezisë së Arapit në dy drejtime: së pari, në ndërtimin e pyetjeve retorike të shprehura apo të nënkuptuara, si në monologët e dialogët e tij dhe së dyti në mënyrën si kërkon ta ndërfitë botën mitike tek ajo moderne përmes lumit Akeron dhe varkëtarit Karont, apo në tonet elegjiake të soditjes së vdekjes përmes qiparisave. Edhe pse te ndikimi i Akeronit e Karontit, simbolika ka në thelb mitin helen, perceptimi i transhëndencës te Kacalidha ndikohet dukshëm nga Arapi, me vargje si: *“Karont, lëre sonte kacidhen e ferrit/ se do të mbeten stoqe të vdekurit e mi/ që s’kanë as kacidhen e Karontit”*. Trishtimi i vdekjes ndërkohë spërkatet herë-herë te të dy poetët shqiptarë nga pjalmët poetike të trishtimit të Lorkës, jehonë që nënvizohet edhe nga studiuesi grek Kristos Papageorgiu, ndërsa shkruan: *“Nuk shprehet trishtim, por gazavaj shpengues, përrallor, me një qasje të përmbajtur. Shpesh, në poezitë ku vdekja ose ndjenja e vdekjes ka fjalën e parë, secili mund të dëgjojë jehonën e Lorkës”*. Njësoj si tek Arapi, uni lirik i Kacalidhës pyet edhe njëherë pasi megjulla e habitjes dhe e misterit është tashmë e shpërndarë. Ja disa shembuj: *“Në mbrëmjet*

që të dehte jasemini/ gjeti vdekja të ndalonte shkallëve të mia?” te lirika “Në mbrëmjet që të dehte jasemini”, *“Si qenkërka kështu pas puthjes?”* te lirika me të njëjtin titull (por pa shenjë pikëpyetje në fund në titullit), *“Tempuj të përflakur në damarët e natës/ Ku ta gjej gurin filozofal për eliksirin e busteve?”* te poema “Eliksiri i gurit” etj. **Por nëse Bejko e Arapi i konfirmojnë misteret e realitetit tokësor dhe pse-të i kërkojnë prej qiellit, Kacalidha e sheh qiellin si pjesë të tokës.** Pikërisht aty janë dhe parajsat. Prandaj kozmogonia e Kacalidhës nuk i shter asnjëherë kuptimet e shenjave. Aq habit mosshterimi i dukjeve të shenjave që merren e rimerren, aq të ndryshme dhe të pangjara fare me njëra-tjetrën janë rimarjet poetike në imagjinatën e unit lirik, sa në këtë këndvështrim, lirika e Kacalidhës mbetet e pangjashme me askënd tjetër në poezinë bashkëkohore shqipe. Habit shumë dhe Rreshpja me fantazitë e tij, me ndryshimin se te ky i fundit, shenjuesit e njëjtë ngjizin të ndryshmen e njëjtë, por asnjëherë të njëjtën e ndryshme si te Kacalidha, çka ngjiz te kjo poetikë **mozaikë të rrallë** të realizmit magjik, po të shprehemi me gjuhën e Jorgos Markopulos.

Po le t’i kthehemi aktit mortor të një druri dhe tri përcjellësve të tij në botën tjetër. Misteri kryesor është se kush e rrëfen “ndodhinë” në këtë poezi. Vargu i parë është: *“Katër qiparisa zgjateshin në muzg”*. Pra duket se narracioni lirik vjen nga jashtë asaj çka ndodh. Dikush tjetër na kumton ngjarjen në këtë baladë. Mandej,

zëri i parë dhe i vetëm, ia lë vendin disa zërave njëherësh në vargun *“Në mëngjes u zgjuam, dheu qe acar”* dhe mandej në tjetrin varg *“Me një vig e ngritëm bardin tonë të rënë”*. Mos nuk ka qenë një zë i vetëm ai që rrëfente ngjarjen? Mos kanë qenë disa zëra bashkë si në koret antike të tragjeditive? Poezia mbyllet me vargun: *“Bardët mes dëbore mbartnin lart një bust.”* Mjegulla e misterit dendësohet sërish. Deri para vargut të fundit mund të aludohet se polifonia e zërave rrëfimtari janë zërat e qiparisave që mbartin në krahë bardin e tyre të rënë. Por, po të ishin qiparisat ata që bartën sivëllanë e tyre drejt përtejbotës, pse do ta mbyllnin duke rrëfyer për veten në vetën e tretë shumë në vargun e fundit? Më e besueshme vjen interpretimi se kemi dy zëra në këtë poezi. Distiku i parë, distiku i tretë dhe i pestë është ndodhia epike e rrëfyer nga narratori. Distiku i dytë dhe i katërt është monologu i vetë qiparisave, rrëfimi lirik polifonik. Bardët janë këngëtarë, ndërkohë qiparisat shpirtëzohen duke u indentifikuar me bardët. Qiparisat këngëtarë nuk tuten prej vdekjes. Sepse, udha e këngës si udhë e jetës duhet të vazhdojë. Ata mbartin bustin e këngës si monument para të cilit brezat duhet të përulen për të mos e lënë në mes këngën. Shpirtëzimi i qiparisit ndodh edhe në këngën popullore me vargun “Udhës shkon një qiparis”, por te Kacalidha shenjuesi i këngës popullore është habitja e shenjave të një realiteti që poeti kërkon ta zbulojë me këmbëngulje, e ndërsa mpleksja e zërave ka krijuar një baladë moderne, tronditja që vjen prej dramës së vdekjes e lë lexuesin në një komunikim të hapur me natyrën.

Në vëllimet e para me poezi, Kacalidha vinte i tillë për lexuesin. Poetika e tij identifikonte shenjat e realitetit dhe në procesin ekzistencial të botëkrijimit, pataksej me çdo dukuri të realitetit. Mandej në dy vëllimet e tjera “Profecitë e drurëve” (1998) dhe “Pagëzimi i zogjve” (2004), shenjat e thërrasin unin lirik për t’i rrëfyer të vërtetat. Lirika e Kacalidhës nuk habitet më prej mrekullive e tragjeditive të realitetit, por ky i fundit i jep poetit të drejtën e zbulimit të profecive të natyrës e gjithë elementet e saj si: drurët, stinët, detin, malin etj. Poeti madje di të fshehtat e kohës së agullimit, të muzgjeve e të natës. Me fjalë të tjera, zbulesat e natyrës dhe kohës së saj të përjetshme në tokë. Në këtë fazë të krijimtarisë natyra i përgjigjet unit lirik që i ngre himne elementeve e dukurive të saj. Një nga poezitë e shumta sintezë që përfaqëson tiparet thelbësore të poetikës së Kacalidhës në këtë fazë krijimtarie është lirika “Ungjillëzimi i zogjve” me vargjet antologjike: *“Cika cipën e agullimit dhe përnjëherësh/ m’u zbërthye trupi i mëngjesit/ Cika cipën e agullimit dhe m’u zbërthye trupi i ditës/ me një qiell koralesh hedhur përsipër/ Cika cipën e agullimit dhe poshtë saj më shfaqej/ e përhënura e moçme, e vesuara mitike.../ Cika cipën e agullimit dhe poshtë saj/ drithërohej ungjillëzimi i zogjve”*. Shkallëzimi ngjites nga njëra strofë në tjetrën rrok krejt rrafshin ekzistencial të njohjes. Uni lirik bëhet pjesë e kohës reale, me zbërthimin e trupit të mëngjesit e trupit të gjithë ditës para tij, pjesë e mistereve të territ e dritës, natës e ditës. Fill pas kësaj bëhet qytetar i botëve të moçme plot mite e legjenda. Në fund, agullimi apo feksja e dritës në ag e çon në hapësirën qiellore të pagëzimit të zogjve. Poeti aty, i mbështjellë prej pagëzimit të fluturakëve, arrin t’u shkojë deri në palcë profecive të natyrës. Në poezinë “Drurët profetikë” Kacalidha shkruan: *“Syth i fjetur jam i drurit profetik”*. Uni lirik, tani pas të kuptuarit dhe të përjetuarit të procesit të pagëzimit, nga njeri i pataksur prej realitetit është shndërruar në mbartës të profecive, në syth të drurit profetik. Shenjat e realitetit, shenjat mitike dhe ato biblike do të dijë t’i deshifrojë më së miri,

për të na ngjizur kshtu kohën universale në aktin soditës të botëkrijimit.

Në antologjinë poetike jetësore “Heraldikët e borës” të Niko Kacalidhës, ka dhe një sërë prozash poetike që botohen për herë të parë. Janë si sasi një libër i plotë, nëse do të ishin botuar veçmas. Gjuha burimore e poetit ka arritur kulmin e saj. Të duket se lexon De Radën, me ato imazhe gati fëmijërore të peizazheve, me një botë ku çdo gjë është në lëvizje. **Por fëmijërimi i poetit nuk e bën aktin e soditjes naiv si te De Rada, apo si në rrëfenjat e lashta mitike të krijuara në kohën e foshnjërisë së njeriut, prej nga ku është ndikuar dhe poeti arbëresh.** Fëmijërimi e bën aktin e soditjes të ngjizë një realitet plot vezullime. Në fakt, secila prej prozave poetike është në funksion të një tabloje të plotë të shpirtit poetik që pasi i ka njohur të tëra të vërtetat profetike të natyrës, të realiteteve të prekshme dhe të tjerave realitete paralele që fshihen pas profecisë së gurëve, drurëve, deteve, maleve etj., është në gjendje të shpikë vetë profecitë e tij për një jetë mrekullore. Secila rrëfenjë lidhet me tjetrën jo në vazhden e një lidhje logjike, por në mënyrë sintetike. Secila pamje shkrepëtisë në sytë e lexuesit plotëson një pjesë të mozaikut të realizmit magjik, prozën poetike “Rishfaqja e vegimeve”, ku kufiri mes ëndrrës dhe realitetit është aq i tejpushëm.


“Tani, shpesh mbrëmjeve ikim larg, unë dhe borsi, rikthehemi duke mbështetur sqepat e shtypur meduzë në brymën e xhamit, banorë nostalgjikë duke kërkuar dikë të na hapë nga brenda. Netë të tëra endemi me mikun e vjetër borsin e brishtë të dimrit. Ai me sqepin prej bore nga njëra anë tërheq perden e kadifejtë dhe unë nga tjetra me gishtin e trëndafiltë të fëmijës. Shiko, thotë, a ka njëri brenda? Duart më dridheshin në vegimin e dëborës. Dy doreza leshi varur të ngrira pas grilave. Zgjata duart dhe trokita. Asgjë nuk pipëitinte. Thirra. Asnjë flokëbardhë kureshtar nuk nxori kokën në dritare. Fotografitë e gjyshërve kërcisnin në mure apo kërcenin bulkthat mbi kornizat e tyre? U zgjova fëmijë dhe jashtë kërcisnin borërat.”

Gjejmë shenja përfytyrimesh onirike që janë në funksion të dritësimit të realitetit. Fragment pas fragmenti apo rrëfenjë pas rrëfenje, drita ia beh njëherazi njësoj si te fragmentet e De Radës. Me po atë tis engjëllor, me po atë mbështjellje prej fantastikeje, me po atë eliptizëm për t'i shpikur realitet paralele si në fluturimet pindarike. Për një çast rrëfimi të çon te realja, pastaj te fantastikja brenda realitetit, mandej të duket se gjithçka ish vegim i një ëndrrë. Vegimet kur janë aty të ngërthejnë me hir a pahir, ndërsa kur mjegullohen të japin më parë udhën se si t'i rishfaqësh sërish. Naiviteti deradian ia lë vendin fëmijërimin me kas, një lloj ëndje për të mos u shkëputur nga pafajësia, për të mos e turbulluar atë me turbullirat e botërave të zvetënuara. Gati në të gjitha rrëfenjat vjen kulti i vendlindjes, pragut, ëndrrës magjike të shtëpisë fëmijërore, që e mbartim mbi shpinë si një strehë të sigurt, drejt së cilës rendim të sigurt, kur shpirtin na e mëkon me dhimbje trualli i vuajtjeve të maturimit. Poeti ka frikë ta humbasë fëmijën e strehuar në zemrën e tij, aq frikë sa i thërret tërë vegimet e fëmijës për ta rikrijuar edhe njëherë botën nga e para, sa herë engjëjt e bardhë të dëborës, engjëjt e kaltër të detit apo engjëjt e hareshëm të diellit, fillojnë e bërtasin se dikush i panjohur diku po ua rrëmben prej krahëve magjinë e ëndrrës. Kacalidha vegon dhe ëndërron që të mos vdesë ideali për një botë të mrekullueshme dhe një qenie njerëzore të mjeruar nga braktisja e mrekullive të vogla, pa të cilat venitet mrekullia më e madhe: ekzistenca jonë në parajsat tokësore.

Shënime për librin “Ngjizja e përlyeme” dhe “Paqja e përgjakur e Adamit”

AGRON TUFA NË DY ROMANE

Nga Namir Lapardhaja



Romani “Ngjizja e papërlyeme” kaloi pa vëmendjen e duhur dhe pa rrehonën e merituar. Për nga forma strukturore, ai është ndërtuar mbi bazën e rrathëve interferues rrëfimor, i përbërë nga katër të tillë, që mund të qëndrojnë edhe si pjesë më vete, një prologu dhe epilogu, në qendër të të cilëve është një protagonist (Martin Gega – emër që e ndeshim edhe në romane të mëparshëm të autorit, një lloj alteregoje që e ka shoqëruar në të gjithë procesin krijues), i cili herë rrëfen në vetën e parë (është ai që rrëfen për veten), herë në vetën e tretë (janë të tjerët ata që rrëfejnë për të apo rreth tij); po ashtu, edhe përsa i përket përmbajtjes, romani rrëfen një fenomen të dhimbshëm dhe aspak për t’u krenuar të shoqërisë shqiptare në vitet ’60-të të shekullit të kaluar: ndarjet e vajzave ruse prej djemve shqiptarë në periudhën e prishjes së marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik dhe vuajtjet, persekutimet, internimet apo dënimet e ndryshme të atyre që nuk pranuan që regjimi t’i diktonte edhe se më kë duhet të ndanin shtratin bashkëshortor.

Nga ana tjetër, “Paqja e përgjakur e Adamit” është romani i fundit i shkrimtarit Agron Tufa. Sipas shënimeve autorial në faqen e fundit, vepra është përfunduar në Bex të Zvicrës, në shtator të vitit 2022, pra në vendbanimin aktual të autorit.

Tema e këtij romani, në dallim nga “Ngjizja e papërlyeme”, është marrë nga aktualiteti, ku në qendër të tij është protagonistin Adam Zaganjori, një njeri i mirë, i urtë, i moralshëm, pakëz naiv si pasojë e besimt të shumtë që ka tek njerëzit, veçanërisht tek të afërmit, dhe peripecitë e jetës së tij, nga normaliteti i përditshëm në rrokullisjen e pakthim drejt fatalitetit të vdekjes, pas kalimit të mundimeve të shumta njerëzore. Në ndryshim nga romani paraardhës, “Paqja e përgjakur e Adamit” ka një strukturë rrëfimtare lienare. Ngjarjet në të fillojnë nga fillimi dhe jepen në mënyrë kronologjike drejt fundit, pa përthyerje kohore dhe hapësinore. Duke qenë poet i mirëfilltë dhe i mrekullueshëm, gjuha poetike, karakteristikë për veprat e mëparshme, ka ruajtur tek ky roman veçoritë e gjuhës së prozës, duke dhënë gjithçka me masë, pa tepri, pa ngarkesë emocionale, që vjen si pasojë


e thellësisë gjuhësore apo e figuracionit të saj. Në pikënisje të këtij romani gjejmë gjurmë të *zanafillës së njerëzimit*, por mjeshtëria krijuese e autorit, thurja e fabulës dhe e intrigës së saj, arrijnë ta fshehin dhe ta sendërtojnë rrëfimin, duke e mbajtur lexuesin të gozhduar deri në faqen e fundit për të marrë vesh fatin e protagonistit, i cili, gjatë faqeve të romanit, shpeshherë bëhet, pa kuptuar, edhe fati i vetë lexuesit.

Të dy romanet e shkrimtarit Agron Tufa ndërthurin fatin e individit. “Ngjizja...” përshkruan individin në diktaturë dhe shtypjen e tij në forma dhe mënyra të ndryshme, që vjen si rezultat i ingranazheve shtypëse të sistemit, ndërsa “Paqja e përgjakur...” trajton fatin e individit në bashkëkohësi, në demokraci, madje në dekadat e fundit, gjë që del edhe nga një mori shenjash tekstuale dhe elementeve të tjera.

Elementet fantastike të “Ngjizjes së papërlyeme” (ngelja shtatzënë e Ljuba Borisovës si pasojë e gëlltitjes së dorëshkrimeve të të shoqit), janë zëvendësuar nga një realizëm therrës tek “Paqja e përgjakur e Adamit”, sa që të duket sikur gjithçka që zhvillohet është aty përbri teje, ndërsa ti vetëm pret që të mbyllësh faqet e romanit dhe ta shohësh në realitet atë që po përshkruhet.

Shtypja dhe pafuqia e individit përballë sistemit është një ndër karakteristikat e letërsisë ekzistencialiste. Në faqet e fundit të “Paqes së përgjakur të Adamit” të shfaqet Mërsoi i Kamsyë dhe vezullimet prej diellit të ngjashme me të, çka i shkaktojnë vegulli protagonistit apo reflektim në sy të elementeve metalike mbi tavolinë, gjë që shkaktojnë edhe vdekjen e personazheve.

Jo për ta ekzagjeruar apo për të mos qenë objektiv, kur mbarova së lexuari romanin voluminoz “Ngjizja e papërlyeme” krejt natyrshëm mendova se kjo vepër, nëse do të arrihej të përkthehej në mënyrë mjeshtërore në gjuhën pritëse, do të konkuronte denjësisht në dimensionet evropiane dhe botërore të letërsisë, gjë që do t’i bënte nder kulturës dhe gjuhës shqipe, ndërsa romani “Paqja e përgjakur e Adamit” është një vepër që i qëndron mrekullisht shtratit të letërsisë shqipe dhe dëshmon edhe një herë mjeshtërinë krijuese të shkrimtarit Agron Tufa.



Romani i Fatit si Faj Tragjik. “Zemra është një vend i vetmuar”, i Rudolf Markut

DY KOZMPOLITË TË VETMUAR

Nga Gëzim Basha


Romani, Zemra është një vend i vetmuar—roman i renies në terr politik dhe i jetes në rgrackën e tij—është me gjase romani më i mire i Rudolf Markut dhe hyn padyshim ndër romanet me të mirë të krejt letërsisë Shqipe jo vetëm në tre dekadat e saj të fundit. Në qender të tij është një vajze gjermane, Fräulein R.H, një blonde e bukur, e cila pas njohjes në Dubrovnik dhe vendimit për t’u martuar me shqiptartin e hijshëm Martin, mbeti peng në Shqipëri komuniste për shkak të pafajsisë së saj. Përmes fatit të karaktereve të veta, autori ofron veshtrimes kaleidoskopike dhe imagjinative në Shqipërinë e tre koheve; Luftës së Dytë Botërore, diktatures komuniste, dhe tranzicionit.

Ky roman elaboron temën e madhe të egzistencës pa pretenduar modelin egzistencialist, ngaqë “krimin” ketu e kryen fati jo karakteri—refuzimi i dashurisë së një violinisti glamorous për hir të një qasjeje me të thjeshtë por që doli shumë më e nderlikuar. Me një proze poetike plot precizion, ky roman fatidik eksploron pasojat që shkaktojnë tek individit kthesat e papritura të fatit, traumat e mbijetesës nën peshën e poshtërimit, rrezimet e befta dhe përpjekjet e mundimshme për ta ruajtur integritetin personal si esence humane, jashtë ethosit politik të ditës.

Bota e romanit zbulohet përmes syrit të një rrefimtari i cili, ngaqë flet në vetën e parë, nuk heziton të adaptojë teknikat e ëkauntit personal, jofiksional në emër të besueshmërisë apo nevojës për të marrë, në momente të caktuara, pozitën e deshmitarit. Kjo lloj përfshirjeje e drejtperdrejtë e rrefimtarit lehtëson jo vetëm raportin e tij me heroinen e romanit, jo vetëm raportimin e tij nga një bote absurde dhe e transfiguruar, por edhe kolonien kryesore të struktura narrative—vizionin e autorit mbi totalitarizmin.

Tek Rudolf Marku, totalitarizmi paraqitet si një rrezik i erret, universal e prapë i personalizuar, por gjithsesi mbetet vetëm sfond ngaqë me shumë se sa për politiken, autori ka interesim për etiken dhe estetikën. Dy personazhet e tij fokale, Roza dhe Martini, modelohen në një prej rrethanave më absurde që mund të mendohet, janë dy kozmopolite në një vend të izoluar, dhe për këtë paguajnë tاجر të rende.

Zemra është një vend i vetmuar, me lehtësinë e matur e prapë thuhet pindarike të bredhjes me lehtësi në hapësira jo shqiptare, ka brilancën e Dr. Gjilperës të Faik Konicës dhe ri me dinjitet estetik në shoqërinë e tij ngaqë është konstruktuar si një eksplorim elegant i mardhenieve të pashpjegueshme të dashurisë dhe fatit, domozdoshmërisë dhe rastesisë, debulesës dhe vdekjes, tehuajzimit, shpresës dhe solidaritetit njerëzor.



TREKËMBËSHI KU VAREN YJET

Cikël poetik nga Rei Hodo



decrecendo vjeshtake

yje s'ka
prej frymëzimit s'lindin më yje

trishtimin
e fsheh
me zverdhjen
e vjeshtës

qyteti ngjeshet pas trekëmbëshit
ku varen tretur yjet e mbetur

loti njomështon një gjeth vetmitar

kundërshti të forcës

vdes diçka brenda shpirtit
forca shfaqet në të kundërtën e saj

avionë të frikës

gjunjëzohen mbi krahë të valëve
-ftohur prej mallkimesherërat
që udhëtojnë me
avionë të frikërave

ngurtësohet materia e lotit

shpirti akullnajë dhimbjesh

vdes diçka brenda tij
forca humbet në të kundërtën e saj

katedra e nimfave në fund-det
madhështon ujësinë

ndoshta jo epitafi i fundit

qiejt mbajnë në shpinë të tyre
pengun e një
frymëzimit të ndrojtur

le të thonë pas vdekjes se këtu
prehet njeriu
që e desh vargun sa vetë jeta
që për dashurinë në poezi shkarravit letrë

pilotët u ngajnë krizantemave
me qëllim të tyre
të mbajnë lart avionë të frikës

le të thonë pas vdekjes së këtu
ende rron një poet
që shkruan vargje me brinjët e tokës
dhe netëve me hënë të ftohtë
udhëton me shpirtrat e tjerë udhëkalimeve
të botës

larg dykëmbëshave humanë

epoka të shëmbëllyera

shëmbëllyejnë epokat në bardhësi
të horizonteve
poetët lartojnë poezitë
mbi trasë reshë bardhëllore
të humburit flamuj humbjesh
mbështjellin shpirtin
ngrirë pandjeshmëri

baladë për jo për veten

ç'të shkruaj s'mundem ta di dhe
i vogëlth ndjehem të përdor rërën e
Adriatikut
për të shkarravitur
vrasjen e kujtesës së të ardhmes

ngajnë shekujt e kohëve tona
të pamundura në poezi
një varg i ngjizur prej rimës vellobardhë
fshikullon
heronjtë e humbur
shpirtmbështjellur me lavdi të kotë

dorëlëshuar me vargjet dhe një botë
tek e cila frymon vetëm një jetë
për t'u jetuar dhe vetja ime që gjen veten
fshehur tek
gjoksi i një rime duke bërë dashuri

trekëmbëshi ku varen yjet

ngjeshet fort pas trupit të qytetit
ashtu e lakuriqtë
e imët deri në ftohtësi hekuri
nata

pa titull

ushtria e vjeshtës deklaroi ngadhënjimin
ndaj të huajve
të këtij qyteti me mall bregu pa breg

me një pardesë pezmi
diku fshihet një dallgë trishtimi nga nata
natë e ftohtë

bregu në ëndrra fshehur

gjethnaja e tërë një ushtri e vyshkur
në plejadë të fitoreve

Në romanet e botuar kohët e fundit ndihet prirja për të trajtuar temat e ditës. Njëkohshmëria e autorit me lexuesin dhe aktualizimi artistik i tij është përgjegjësi dhe dialogim estetik e qytetar. Romani, si gjini e gjatë e prozës, vihet në funksion të fatit njerëzor, universalizuar si shumësi e ndjeshmërive instiktive e kulturore. Me përgjegjësinë e një prozatori të afirmuar Grigor Banushi në romanin e tij të tretë “Mëria e Zanave” vjen me sfidën e kronikës rreth ngjarjeve të jashtëzakonshme në përditshmërinë e hetimeve të një specialisti të kualifikuar në fushën e zbulimit të krimi, komisar Marin Kurtit. Në ecurinë e hulumtimeve të tij, autori materializon fabulat: si “Humbja e mistershme e jetës” dhe detyrimi i organeve shtetërore për të hetuar mbi të vërtetën e fajtorët. Përjetimi dhe fatkeqësia si ndjesi individuale dhe fatalitet njerëzor. “Vdekja si proces jetik e mister konfliktesh njerëzore”. Romani i tij nuk bie në kurthin e një rrëfimi policor. Grigor Banushi anashkalon dhe hollësitë e një romani psikologjik. Vepra mishëron sigurinë e tij për t’u përfshirë në aktualitet me një prozë të mirëfilltë e të arrirë artistike.

Një ngjarje e bujshme, siç ishte humbja e tre turistëve të huaj në Alpet e Shqipërisë, sjell natyrshëm ndërkombëtarizimi e vështrimit të çështjes. Shkrimtari i zbërthen personazhet e veprës në realitetin e kohës së zbulimit të krimi. Koha reale, një mujore e ngjarjes, ndërthurret me kohët e narracionit në vepër. Ajo sjell veçoritë e një epoqe historike më se pesëdhjetëvjeçare në lidhje me ndikimin e saj në fatin e individit. Prozatori mjeshtërisht plazmon këndvështrimin historik të virtyteve dhe tjetërsimin e njeriut, si nocion kombëtar dhe jo vetëm kaq. Bota, vendi ku lind e vdes njeriu, është kudo njëlloj.

Kur dhimbja trondit themelet e shpirtit, shoqëria kupton se solidarizimi me të, në emër të paqes sociale e lumturisë njerëzore është detyrë. Asnjëherë s’është vonë për t’i mbyllur e lehtësuar sado pak plagët e krimi. Plagë, që trokasin përditë në derën e vjetër të kontinentit plak. Realiteti shqiptar është pjesë e tij me veçoritë gjeopolitnike. Meritë e autorit është vërtetësia e dhënies së kësaj drame. Jo vetëm në dekadën e parë të shekullit të XXI, por edhe më thellë në kohë. Humbja e Irena Bradovskës, njërës prej turistëve, thellon tragjizmin e kalvarit të vuajtjeve e të persekutimit të familjes së saj, nga diktatura më egër e kohës së Luftës së Ftohtë. Nëna e saj, Olga ishte bijë e inxhinier Viron Konjari. Maria, gjyshja, studentja polake e dashuruar me të erdhi të realizonte ëndrrën e lumturisë së saj. Por si shumë të huaj s’u shpëtuan dënimeve e persekutimeve të regjimit komunist. Kujtimet e familjarëve e kishin shtyrë vajzën e re, violinisten e talentuar të vinte në tokën e rrënjëve, me miqtë e saj artistë, Oto e Markus. “Në zhdukjen pa gjurmë” ajo ç’ka kishte mbetur në celuloidin e aparatit të tyre ishte madhështia e njeriut në gjirin e natyrës. Pamjet e mrekullueshme apelonin për paqe dhe harmoni universale.

Realiteti dhe imagjinata

Në një pulze gjigant, komisar Marin kishte rindërtuar ngjarjen e turistëve duke filluar nga aeroporti i Tiranës deri në skajet më veriore të vendit, rrëzë apo majë maleve. Autori i lokalizon veprimet në emërtime toponimike mitike si: Zojmirë e Rrashi i Egër, Liqeni i Zanave, Malet Trueme, Qafa e Hardhuckave, Gropa e Dreqit, Hani i Shegës etj. Këto emërtime të denjë për një dekor shekspirian nuk mund të mos krijonin një figurë stoike e tragjike sa ajo e Sadik Dushit të rënuar familisht. Nuk mund të ishte askush tjetër, simbol i vënies së drejtësisë, në një realitet të përçudnuar patriakal, veçse momumenti i gjallë i Martës me xhubletën e saj njëqindvjeçare.

MREKULLIA E SHKRIMIT “MËRIA E ZANAVE” TË GRIGOR BANUSHIT

nga Zhuljeta Grabocka

Tërësia e episodeve përfshin një periudhë njëqind vjeçare. Tërësia e episodeve luhet natyrshëm sa në realitetin e ngjarjeve të jashtëzakonshme tek legjendarizimi e tyre. Por lexuesi përjeton dhe realizimin e drejtpërdrejtë të personazheve të tjerë femërorë Almës, Haikes, Metildës, Borës pesëmbëdhjetë vjeçare po aq bindshëm sa dhe miklohet me sensin e masës në dhënien e dimensionin “Zanë”. Realiteti e imagjinata ndërthurren në dhënien bardhë e zi të jetës. E bardha i “fanepset” Marinit në errësirën e mungesës së dritës së të vërtetës në gjumin e trazuar si opsion i absurditeti sizifian. Pamundësia e një rezultati konkret në hetime vjen i mirëpritur në shprehjen e modernitet të një proze që endën rrëfimin në hullinë e eposit të lashtë.

Deheroizimi i personazhit

Marin Kurti është personazhi kryesor i veprës. Prej tij rrjedhin të gjitha linjat e subjektit. Formimi dhe përvoja e tij, që prezantohet në faqet e para të romanit duhet të sillni një pritshmëri tjetër për lexuesin. Mos suksesi i tij në hetim është “kurthi” ku autori kërkon ta fusë “heroin”. Përshkrimi artistik i dyzimeve është gjetja kompozicionale, që mban në këmbë rrëfimin emocionues dhe kalimin

e suspansit nga një kapitull tek tjetrit. Natyshmëria e personalitetit të tij është e prekshme, njerëzore. “Lektisja torturuese” nëpër ëndrra krijon mundësinë eklipsuese të komisarit “hero”. Autori zhbiron në psikikën e tij “gruan zanë” në të dy gjëndjet e qënies njerëzore, të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme. Prej këtej botëkuptimi mitik e pagan i Sadushit bëhet faktor ngushëllues për fatin e shituar nga Zanat të familjarëve të tij. Jeta e njeriut shpaloset e merr kuptim e lidhur ngushtë me natyrën e Alpeve të veriut. Madhështia e ashpërsia e tyre fshehin misterin e fatalitetit i cilit jo rrallë herë tingëllon legjendarizues. Pasuria gjuhësore e dialektit të kësaj treve përcjell “ëmbëlsinë” e përjetimit fisnik të dallgëve ku i përplas fati i egër personazhet. Individualizimi gjuhësor bëhet në përputhje me moshën e kulturën e tyre. Në dialogë, përshkrime e monologë ajo rrjedh lakonike e plot ngjyime. Shkrimtari është njohës i thellë i konstitucionit shpirtëror të tyre. Njeriu malësor ka kodet morale shekullore, që i dëshmon me veprime edhe sot. Këto përshkrime alternohen me fatin e njeriut të kohëve moderne përmes realizmit magjik. Por autori nuk e kthen këtë vështrim në parim drejtues estetik. Pasqyrimi realist i ngjarjeve në Hanin e Shegës, në faqet e fundit të romanit, është fataliteti i vetgjyqësisë, prej së cilës vuajmë shumë familje shqiptare. Shuarja e jetës

së Martës së Thive paralajmëron rënien e domosdoshme të perdeve të këtyre skenave makabre. Kapja e shekullit prej moshës së saj është himn i shenjtërisë dhe paprekshmërisë së jetës së njeriut.

Ardhja e hijeve të bardha

Tisi legjendarizues i prezencës së vajzës “Zanë”, pleks një gërshet të bukur rrëfimi. Dilemat e hulumtimit të hetimit prej komisarit Martin nga fillimi deri në fund të romanit vuajnë nga mos realizimi. Prezenca e vajzës në grupin e të humburve dhe vajzave të jetës së tij private, i jep rrëfimit thyerje e mundësi këndvështrimesh analogjike. Thellësia epike e zbulimit të gjurmëve të krimi, të çojnë tek burimin i konflikteve të hershme të eposit legjendar e protagonistëve të tij. Zana, si forcë madhore, justifikon paftësinë e njeriut për të shpjeguar shkakun e akteve fatale. Njeriu mitik pajtohet me to, ndërsa krijuesi modern i përdor si truk artistik. Në këtë trend në roman huazohet përshkrimi i “bardhë” i qënies “Zanë” e painedividualizuar. Por që godet në përjetimin e përditshëm si individualizim p.sh i hijeve apo kofshëve të bardha. Autori e njuh mirë eposin dhe ndërton lehtësisht lidhjet ndërtekstore. Atij nuk i intereson himnizimi e figurës së “Zanës”, por krijimi i kontrastit dhe përfitimi i përjetimit emocional të situatave të jashtëzakonshme. Lexuesi i kualifikuar bën indiferencën midis artit popullor e shkrimit të kultivuar.

Në roman ka faqe të mrekullueshme të bukurisë së Alpeve, liqeneve me bukuri të rrallë, të rrethuar nga kurora e blertë e pyjeve. Në këtë amfiteatër gjigant luhet arti i përjetshëm sa kombëtar aq edhe universal. Kombësia e turistëve i shërben autorit për të dhënë analogjinë e hershme mitike. Me simotrat e tjera në kulturat e popujve të ndryshëm ato pavdeksojnë qëllimin universal të fatit njerëzor. Aty, ku ai është i kërcënuar në ekzistencën e tij. Episodet e shumta tragjike të romanit i japin vlerë jetës. Ato janë pjesë e natyrës dehumanizuese të njeriut, përjetësimi artistik ka qënë dhe mbetet pjesë e objektit të artit. Romani “Mëria e Zanave” është arritje cilësore jo vetëm e autorit, por edhe e letërsisë bashkëkohore. E denjë për nga vlerat artistike për t’i qëndruar në krah edhe veprave të mrekullueshme lirike të traditës siç është “Mrizi i Zanave”.

Vallja e Zanave Gratë “zana” të vdekura dhe të gjalla. Fragment...

“Çdo natë Irena kërcente vallen e hijeve të bardha që e niste Aishja e mbytur në Drin e vazhdonte Haike e fshehur në subkoshencën e tij, e çonte më tej Alma, që nuk mbushte vetëm ëndrra, por edhe netët e tij pa gjumë...pastaj Irena Bradovska, që ndiqte shoqet në atë valle të përjetshme... kohët e fundit e mbyllte vallen plaka Marë, që vallëzonte ngadalë dhe në shumicën e herës gjendej në qendër të valles, jo mbi këmbë, por mbi piedestalin e saj xhubletë. Nganjëherë hynte në valle edhe Bora pesëmbëdhjetëvjeçare me tërë bukurinë e saj, si vetë dëbora nën dritën e hënës. Në këtë rast Marini ishte pak i turbullt.

Shfaqja e saj ishte e paqartë. Ishte në anën e femrave të gjalla, apo të atyre të vdekura? I tingëllonte si një ogur i zi. Irena i shfaqej më shumë nga të gjitha, në vallen e ëndrrave të tij, herë në pyll, herë mbi sipërfaqen e liqenit. Zanat vallzonin të lehta sikur fluturonin mbi ujë e këmbët e tyre nuk lageshin kurrë. Nganjëherë vallëzonin në fund të liqenit duke u kthyer në nimfa apo sirena dhe nga gojët e tyre të bukura në vend të fluskave të ajrit lëshonin lule shumëngjyrëshe.”



Gruaja e vet i kishte thënë me zë të mekur: pse tërë natën je ngritur nga shtrati e pastja ke pirë raki!... Si ndodhi që një qingj e kishe prerë e pastaj mishin e tij e kishe hudhur në oborrin e shtëpisë!... Kishte dashur t'i tregonte gruas çfarë kishte përjetuar, po kishte qenë i bindur sikur ajo nuk do t'i besonte. Pak para se të lëshohej mbrëmja i kishte mbledhur plaçkat e pastaj ishte larguar nga shtëpia. Gjatë rrugës gruaja gjithnjë i thoshte: nga kush ke frikë që largohesh nga shtëpia kaq papritur.... Në çastin kur durimi i ishte këputur i kishte thënë gruas: sa herë dal natën në oborrin më duket sikur të vdekurit janë ngritur nga varret e pastaj bëjnë dasmë. Edhe kur hyj në dhomë i dëgjoj zërat e tyre të çjerrë si këndojnë e hedhin valle!... Kam frikë se një ditë do të më thërrasin edhe mua të këndoj e të vallëzoj me ta... Gruaja e tij kishte filluar të shqetësohej për të. Ishte e bindur se i gori kishte filluar të vuante nga një sëmundje e rëndë... Pas një kohe të shkurtër mora vesh se ishte vendosur në një shtëpi që gjendej në fund të fshatit. Tri ditë kishte bërë jetë të qetë. Ditën e katër qetësia kishte filluar t'i rrënohej. Natën e katër, edhe pse qepallat i mbante të mbyllura, përsëri i kishte parë njerëzit e vdekur si qëndronin në dhomën e tij dhe gjatë gjithë kohës hedhnin valle të çuditshme e këndonin këngë me zë të lemeritshëm. Pas dy muajsh që kishte jetuar në atë shtëpi dikush i kishte thënë: më mirë kthehu në shtëpinë tënde që gjendet te varret... Ishte kthyer i bindur se aty do të mund të bënte një jetë të qetë. Shtatë ditë e shtatë net kishte pritur në vorbullën e një ankthi që ia hante shpirtin të shfaqeshin njerëzit e vdekur, të cilët ngriheshin nga varret sapo nata lëshohej mbi hapësirë. Megjithatë, ata nuk kishin ardhur. Ishte gëzuar shumë që tash e tutje do të bënte një jetë të qetë... Pasi i tha këto fjalë njeriu i panjohur u largua disa metra larg tij sikur të kishte frikë nga diçka. U mundua ta shikonte hapësirën në të cilën gjendej pa dëshirën e tij. Shikimi i vagëlluar i përplasej në do shkurre të thata... Jam i bindur se këtu diku gjenden varret, i tha vetvetes derisa dëshpërimi si një gjapër i ngordhur ia mbështjellte shpirtin... Kishte frikë se koha po kalonte shumë shpejt. Duhej të kthehej në shtëpi para se dielli të shfaqej në një skaj të qiellit. Kishte frikë se shokët do ta dëbonin gruan e tij nga shtëpia, po më parë do ta dhunin me radhë... U habit kur e pa veten si qëndronte para shtëpisë së mikut të fëmijërisë. Me sytë e vagëlluar i vështronte dritaret e shtëpisë së madhe, i bindur se në njërien prej tyre do ta shihte mikun e tij të dikurshëm... Hapësira e mjegulluar u mbush me zërin e tij, i cili jehonte në të gjitha anët... Një mendje i tha sikur zëri i tij ishte i dobët, prandaj nuk do ta dëgjonte miku i tij. Ndoshta do të arrinte deri te dritatja, po nuk do të mund të hynte brenda... E pa veten si zuri të lëshohet në vorbullën e një pritjes, e cila e mbështjellte të tërin sikur të ishte një gjarpër i ngordhur. Pritja po bëhej gjithnjë e më rëndë. Në imazh i shihte shokët e tij si trokisinin në derën e shtëpisë, nga ku dilte grujana e tij duke iu përgjyeruar me lot në sy. Doli e rrëmbente gruan e tij e pastaj mundohej ta dhunonte....

Derisa notonte nëpër humnerën e mbushur me imazhe të ngrira, me sytë që nuk i bënë mirë dritë përpara iu shfaq një grua me flokë të shpupurishura, e cila kishte fytyrë të fishkur... Pse bërtet ditë e natë te shtëpia ime, i tha gruaja me zë të lartë... Mos je i çmendur!... Zëri i gruas iu duk sikur të ishte i trulluar, sikur një erë që frynte nga të gjitha anët e sillte nga varret. Një mendje e marrë i tha: si nuk e kupton që para teje gjendet një kufomë që është ngritur gabimisht nga varret... Të vdekurit mund të flasin edhe pa gjuhë, mund të ecin edhe pa këmbë, mund të shikojnë edhe pa sy... Derisa dridhej nga ethet e një frikës që gjithnjë e më tepër rritej si një lule e

LULJA E HIDHUR

nga Biser Mehmeti

Fragment nga romani, *Botime Buzuku*

hidhur deshi të fliste, po i ngjau sikur i mungonte gju-ha. Diçka i tha sikur edhe ai ishte i vdekur, prandaj mund të fliste edhe pse nuk e kishte gjuhën. Pasi u mundua disa çaste më në fund e kaploi një gëzim i papërshkrueshëm, ngase e kuptoi se ishte në gjendje të fliste edhe pa gjuhë, të ecte edhe pa këmbë... E kërkoi Malok Kodrën... Gruaja, e cila gjatë gjithë kohës sikur mundohej të zgjohej nga gjumi i vdekjes, filloi ta lëvizte kokën disa herë majtas e djathtas. Në fytyrën e saj tërë asht e lëkurë sikur sorollateshin do kujtime të mykura, të cilat kundërmonin një aromë të neveritshme... A je ti Daki K. apo sytë po më mashtrojnë!... Ka njëqind e më shumë vjet që nuk të kam parë!... Sa shumë qenkëshke plakur!... Ndoshta sytë nuk po më bëjnë mirë dritë!... Derisa fjalët e guras, për të cilën edhe më tutje kishte bindje sikur ishte ngritur nga varri, e godisnin në kokë si me çekan, nuk ishte në gjendje t'i thoshte vetes se ato fjalë që i dëgjonte ishin

të vërteta. Diçka i thoshte sikur para tij nuk gjendej asnjë grua, po një hije e rrejshme që e kishte trilluar nata që nuk kishte fund... Me zërin që i dridhej nga era që frynte në të gjitha anët mezi arriti të thoshte: unë jam Daki K. he mos qofsha!... Gruaja lëshoi një qeshje të hidhur. Qeshja e saj rrëshiqiti nga fytyra tërë asht e lëkurë e pastaj u lëshua në tokën e ftohtë... Sa po më vjen keq që nuk do ta takosh kurrë mikun tënd të fëmijërisë, i tha gruaja me zë të mallëngjyeshëm... Ka shtatë e ndoshta më shumë javë që është larguar nga shtëpia... Eh, i mjeri burri im!... Ndoshta iu mërzi jeta dhe shkoi në një vend të largët për të vdekur!... Një ditë në shtëpinë tonë erdhi një njeri i panjohur, i cili kërkoi ta kalonte natën në shtëpinë tonë. Kur hyri brenda me zë të brengosur tha: ka shtatë ditë e shtatë net që po udhëtoj nëpër këto fusha e male... Jam nga një fshat që gjendet përtej shtatë kodrave... Fshati ynë është në hall me një ujk, i cili po na e shkatërron jetën!...



Kemi kërkuar ndihmë nga shteti, po ai nuk është në gjendje të na ndihmojë!... Jam duke u sorollatur nëpër fshatra të ndryshme me shpresë se mund të gjej një njeri që është në gjendje ta vret atë ujk të mallkuar!... Fshati ofron një shumë të madhe të hollash për atë që e vret ujkun e mallkuar... Të nesërmen burri im i tha njeriut të panjohur: unë jam në gjendje ta vras atë ujk të mallkuar, madje pa më lëvizur qerpiku fa-re!... Iu përgjerova të mos nisej në atë rrugë të rrezikshme, po nuk më dëgjoi... Pasi mbeta fillikat në shtëpi fillova të jetoj me shpresë se burri im një ditë do të kthehej në shtëpi, po më kot. Stinët janë ndërruar tri e ndoshta më shumë herë e unë ende vazhdoj të shpresoj se ai një ditë do të kthehet. Megjithatë, kam filluar të frikësohem se ujkun e ka hëngër trupin e tij, i cili ka mbetur mbi dhe pa u varrosur... E di që e ke pasur mik të dashur, prandaj t'u kisha lutur ta kërkosh burrin tim, nëse jo të gjallë së paku të vdekur...

Ngadalë ia ktheu shpinën gruas, e cila dridhej nga ethet e acarit e të frikës. Sapo deshi të kthehet për në shtëpi, kur një mendje e marrë i tha: kjo nuk është rruga nëpër të cilën ke ardhur!... U ndal edhe pse nuk dëshiroi të ndalej... Nuk e di cilës rrugë kam ardhur edhe sikur të mundohem njëqind vjet, i tha vetvetes... Jo, jo, nuk dua të shkoj në shtëpi!... Dua ta gjej rrugën që më shpie në atë fshat, në të cilin ujkun i torturon fshatarët... Do ta vras me duart e mia e pastaj do të kthehem në shtëpi me një grumbull me pare! Pasi t'i laj borxhet do t'i kërkoj fëmijët e mi... Ndoshta një ditë në shtëpinë time sërish kthehet lumturia... Zuri të ecte me hapa të ngadalshëm nëpër një rrugë të shkretë, nëpër të cilën nuk shihte asnjë gjurmë njeriu. Në një çast i ngjau sikur prapa i shkonte grua e mikut, e cila i lutej me zë të përvajshëm që të mos largohej prej saj, sepse kishte frikë të jetonte vetëm në shtëpinë që gjendej afër varrezave... Gjatë natës nga varret ngrihen të vdekurit e pastaj vijnë në dhomën time dhe gjastë gjithë kohës këndojnë me zë të çuditshëm do këngë të neveritshme. Disa prej tyre shtrihen në shtrat afër meje e pastaj bëjnë dsashuri me mua... Kam filluar të dyshoj sikur me njërin prej tyre kam mbetur shtatzënë!... O zot, a ka trishtim më të madh se të mbetesh shtatzënë me një të vdekur!... Nuk e di si do të duket fëmija kur ta lindi!... Sa më shumë që orvatej t'i lëvizte këmbët aq më shumë ato i ngatërroheshin në mes veti. Kur e pa veten afër një lumi, i cili i dukej i shterur, vetëm atëherë e ndjeu etjen si zuri të zgjohej nëpër do rrugë të braktisura... Nuk e di sa ditë nuk kam ngrënë e nuk kam pirë, i tha vetvetes me zë të mekur. Sapo u afrua te lumi që ta shuante etjen që po ia verbonte te dy sytë e ballit, i ngjau sikur mbi suprinën e tij e pa një diell të heshtur, i cili ishte shtrirë gjër e gjatë dhe sikur bënte një gjumë të qetë. Ndoshta gjatë asaj kohe dielli i heshtur shihte një ëndërr, të cilën nuk dëshironte ta shihte. Në atë çast e kaploi dëshira që të shtrihej mbi syprinën e atij lumi të shterur, i bindur se vetëm aty do të mund të bënte një gjumë të qetë, madje gjatë asaj kohe do të shihte ëndërr sikur gjendej në shtratin e dhomës së vet duke bërë një gjumë të ëmbël...

BISER MEHMETI

ROMAN

LULJA E HIDHUR



"Diskurs modern fatesh njerëzore, figurim i thelluar dhe një dramacitet i arrirë në zbërthimin e ekzistencialës së personazheve."

DAN IBRAHIMI

BUZUKU

1

Kështu e takojmë shkrimtarin - dhe fjala këtu është përherë për shkrimtarin që rron me artin e vërtetë - në fillim në librin e tij, dhe pastaj në shtëpinë e tij. Pa nisur mirë, na duhet të bëjmë një sqarim, ngaqë nuk na lë të shtyhem më tej: fjalën *shtëpi* këtu e përdorim në kuptimin e strehës së shenjtë që mbledh për shkrimtarin hapsirën përtej librit. Atë që gjejmë në libër, ngjan që na del dhe tepron kur gjykojmë shkrimtarin. Dhe, megjithatë, ka një shtysë të brendshme, gati të papërballueshme, që na çon medoemos në shtëpinë e shkrimtarit, aty ku shkrimtari i thotë bukës bukë dhe kripës kripë. Ç'është kjo shtysë, dhe nga vjen kjo dëshirë?


Qenia e njeriut të letrave është fatalisht e ndarë mëdysh, është dy në një: shkrimtari është në fillim njeriu i librit, pra vetja që shkruan, dhe pastaj njeriu i shtëpisë, pra vetja që flet. Dhe, thujse të gjithë bien në një mendje me këtë ndarje, e bëjnë të tyren, si të thuash, me një frymë. Të jetë kjo ndarje kaq e thjeshtë? Me këtë ndarje, njeriu i letrave bëhet sfidë e vdekshme e njerit prej ligjeve themeltarë të asaj metafizike që na vjen nga agu i europianizmit dhe na flet me Platonin dhe Aristotelin. Dihet që këta të fundit i japin përparësi dhe vejnë të parën fjalën e folur, dhe pastaj atë të shkruar. Dhe, megjithatë e përsëri, është ky ligj që rëndon aq shumë i ndriçuar gjer në fund? Qysh flasim? - pyet Heidegger përpara nesh. Dhe përgjigjet: ndërsa gjithmonë dëgjojmë atë që na flet brenda nesh. Dhe kjo që na flet brenda nesh, as nga qiell bie, dhe as e varur mbi humnerë është: ajo është e *shkruar* thellë brenda qenies sonë. Pas gjithë gjasash, këtë të vërtetë të qëruar dëgjoi Derrida dhe pastaj i vihet punës me zell për ta vënë këtë ndarje mbi tjetër themel, duke sjellë këtu një vizion ndryshe. Kjo është arsyeja pse kjo ndarje ka qenë përherë e pranishme në debatet e rëndësishme letrare, ndërsa në kohët tona në krye del shkolla që lidhet me emrin e Frojdit.

Ç'mbetet në esencë nga kjo përplasje e bujshme në mes të Librit dhe Shtëpisë kur është fjala për njeriun e letrave? Mbetet një *diçka* që vërtet rëndon shumë dhe që na flet nga humnerat e kësaj pyetje: Ç'gjejmë në shtëpinë e shkrimtarit dhe që nuk e gjejmë, na përvidhet, në librin e tij? Dhe pastaj e rëndësishme kjo: kjo që gjejmë në shtëpinë e shkrimtarit, si na ndihmon të shikojmë më mirë atë që na flet në librin e tij?

2

Paradigma na vjen andej nga edhe pritej të vinte: nga Tolstoj i madh. Është koha kur në qiellin e letrave ruse nisi të shfaqej një yll i ri, me ndriçim tjetërllor, dhe ndërsa shfaqej, ky yll po e zotëronte këtë qiell të paanë. Ky ishte Çehovi. Dhe, - e çuditshme, rrugëtimin e parë të largët nga vendi i tij Çehovi i ri e bën ... për ku? Për në *shtëpinë* e Tolstojit, me fjalë të tjera, në Jasnaja Poljana që tashmë është shndërruar në *mythos* me të bëmat e njeriut të madh të letrave. Çfarë u shfaq para syve Çehovit të ri atë mëngjes të nxehtë gushti? Dëshmia vjen nga *Folio* e dëgjuar angleze.¹ Më tepër se njeriu që njohim, para Çehovit rrinte një *kreshnik*, i pikuar drejt e nga gjiri i përrallës ruse: një trup i bëshëm, gjithë shëndet dhe qiri më këmbë, gjysëm lakuriq ngaqë këtë radhë nuk ishte veshur me kaftanin e tij proverbial por i mbuluar me një peshqir të gjatë që i zbriste gjer poshtë, me këmbët e mëdhaja mbathur në nallane të drunjta, ndërsa nga fytyra e mbuluar e tëra me flokë dhe mjekër të gjatë e vështronin dy sy me shikim të vetëtimtë, të zënë përherë për diku,

¹ John Sutherland. Introduction, qtd. In: Leo Tolstoy. Collected stories, vol. One. London: The Folio Society, 2007.



dhe që vetëm ata e dinin. Me të mësuar se kush ishte i porsaardhuri i panjohur Tolstoj i rrëmbeu për krahu dhe të dy u drejtuan për në një barangë të drunjtë. Ç'kishte kuturisur këtu magjistari plak? Kishte këputur një mëngë uji nga vija që kalonte në çifligun e tij, dhe kjo rritej në një pellg të madh. Sapo mbërritën këtu, Tolstoj nuk e bëri të gjatë: hodhi peshqirin dhe u krodh në ujë, dhe me mjekrën që i voziste mbi ujë, mes tyre nisi një bisedë e lirë dhe gazmore, dhe që nuk donte të mbaronte ndonjëherë: për dobitë e larjes me ujin e natyrës, për drurët dhe shpesët e çifligut, për të korrat dhe punët e shumta të bujqësisë, për fshatarkat ruse të mira dhe punëtorë, dhe si qysh ai i tmerronte herë pas here me *Dionysos*-in e tij të harbuar dhe të panginjur, për netët e gjata me hënë, për ... Ndërsa për letërsinë ... asnjë fjalë. Dhe megjithatë Çehovi e quante veten me fat pasi këtu, dhe krejt papritur, takoi atë që një ditë shpresonte ta gjente në qiell: *gjestin* e plotësuar së gjithash që mban të kyçur dritën që na duhet për të zbritur gjer në rrënjë të fjalës së shkrimtarit.

Këtë bëri Tolstoj i madh, me një akt të vetëm, të thjeshtë, pa qibër, veç i kryer papritur dhe rrëmbimthi, ndaj aq çlironjës në natyrën e tij: improvizoi dhe rrëfeu në pëllëmbë të dorës këtë gjë aq të vështirë: *gjestin* (gjest - gesture: larë në dritën e vizionit që sjell Walter Benjamin këtu) që zbulon dhe sjellë në dritë të panjohurën e parë të magjisë së tij krijuese. Çfarë vjen në dritë me *gjestin* e Tolstojit? Një energji e pashtershme, një rrëmet ndijor buisës që ngjan se del dhe tepron për ta rrokur jetën në tërë larminë e saj krijuese. Njerëzit e mësuar që merren me Tolstojin këtë pikasin tek ai. Por është një gjë ta kërkoshe e gjeshe këtë tipar përcaktues në librin e Tolstojit dhe krejt tjetër ta përjetosh atë të gjallë, para syve, të kapshme si diçka prej mishi e gjaku. Dhe - le ta theksojmë këtë - edhe pse tepër i rrallë (në më të shumtën e rasteve shkrimtari e merr atë me vete) *gjesti* lind, rritet e shfaqet jo në librin por në *shtëpinë* e shkrimtarit, pasi jo libri

por *shtëpia* e shkrimtarit është mëma e gjestit.

3

Rrugën për në shtëpinë e Kadaresë mua ma hapi Lasgushi. Sapo kishte dalë libri im në anglisht për Lasgushin, dhe njeriu i madh i letrave shqip bëri atë që do të më mbeste për tërë jetën shkruar në sy e në mendje: më thirri dhe u takuam në shtëpinë e tij. E njëjta gjë do të ndodhte më vonë me librin për Migjenin. Kështu, si pa kuptuar do të thoshte Lasgushi, ajo që ndërkohë kishte nisur të rritej në muzg, një ditë doli në dritë: te Lasgushi, te Migjeni unë shkova vetëm që një ditë të veja më mirë tek Kadareja Por ajo që s'më vinte mendja kurrë që do të ndodhte një ditë, as atëherë as më vonë, ishte pikërisht kjo që edhe ndodhi: që në shtëpinë e Kadaresë unë do të përjetoja po atë çudi që Çehovi përjetoi në shtëpinë e Tolstojit.

Ato ditë *Onufri* kishte nxjerrë serinë e plotë të veprave të Kadaresë, një punë e fisme që të kujton, pa më të voglën tepri, klasin e lartë të shtëpisë botuese të dëgjuar angleze *Folio*. Natyrisht, kjo ishte ngjarje e gëzueshme familjare te Kadarenjtë, dhe këtë gëzim unë pata rastin ta jetoj nga afër, ngaqë u ndodha aty, atë pasdite të nxehtë gushti. Po ç'kisha të bëja unë me këtë ngjarje të ngushtë familjare? Asgjë dhe gjithçka. Si vizitor i rastësishëm, unë s'mund të isha veçse në periferi të asaj që ndodhte rrotull meje. Po atëherë, pse *gjithçka*? Sepse kështu u zhvillua kjo ngjarje dhe kështu u shpërfaq thelbi i saj i vështirë, që do të thotë aq shumë për mua.

Është i vështirë gëzimi që vjen nga libri, ngaqë libri fisnikëron e dritëson jo me gjë tjetër por me rëndesën e tij, dhe kjo rëndesë është e tillë që lë gjithmonë diçka të pambaruar për njeriun, që ky të kthehet e rikthehet te libri herë pas here, për tërë jetën.

Ja dhe skena e paharruar, aq e kursyer në natyrën e say, veç aq e ngarkuar me të panjohura që rëndojnë. Po cilët janë

aktorët e saj të pakët? Po e nis me të zonjën e shtëpisë, me Helenën (kush ka shijuar nga afër mikëpritjen e saj bujare, besoj se do të jetë në një mendje me mua: me këtë zonjë të fisme, nuk është që mikëpritja e bukur shqiptare flet, ajo *këndon*). Helena hidhte vështrimin te librat, pastaj diçka e trazuar mblidhej thellë qenies së saj, dhe kjo pastaj i vizatohej në fytyrë por që e kish të vështirë të jepte zë, por që më në fund një shishe me verë që u ndodh rastësisht pranë librave i erdhi në ndihmë, dhe ajo ia pat aty për aty, me befasinë e zbulimit dhe dritën e aforizmës: Pa shih, nuk e dija që vera e mirë shkoka aq mirë me librin e mirë.

Po Bujari, botuesi i mirënjohur i Kadaresë? Nuk e di ç'thonë të tjerët, por për mua, kur është fjala për librin, Bujari ka diçka të veçantë, që është vështirë të vihet në fjalë: libri i mirë e kërkon Bujarin, libri i mirë ndihet paq me Bujarin, mes tyre ka një *empathy* tjetërllor, ashtu si ajo e zjarrit me furrëtarin e regjur. Ja kjo marrëdhënie fatlume me librin ndriçonte në fytyrën e Bujarit, i kënaqur gjer në asht të shpirtit.

Po Kadareja? Ismaili kërkoi që një nga librat e serisë të qëndronte aty, mbi tavolinë, pranë tij. Dhe pikërisht këtu është zanafilla e shtegtimit tim të vështirë dhe aq të lumtur, nga periferia në qendër të ngjarjes, sa që mund të them këtë: dukej sikur një dorë e padukur e kish ngritur këtë skenë enkas për mua. Nuk di për të tjerët, por unë u tërhoqa i tëri, si me magji, në atë që Kadareja nisi të bëjë në heshtje, i patrazuar nga të tjerët rrotull. Pse, ç'po bënte Kadareja? Kadareja nisi të shikonte Kadarenë tjetër, të gdhendur me mjeshtëri në kapakun e librit. Pse, çishte e veçanta që bënte Kadareja i librit? Me Kadarenë e librit ndodh kjo çudi: kudo që ta vesh, ai gjithmonë do të jetë *sikur ndodhet në buzë të greminës*, sepse ai greminën kërkon dhe greminën gjen, që të mbledhë aty dritën që vjen nga thellësi të tilla të abysta të ekzistencës njerëzore dhe pastaj i hap udhë kësaj drite të humnertë të gjejë syrin e njeriut dhe të mblidhet në zemër të tij e të bëhet: njohje, mençuri, fjalë.

Ja këtë po bënte Kadareja: me syrin e tij të përqendruar e depërtues, po shikonte me tjetër vëmendje, me ashk e përbujë, si nuk do ngopej ndonjëherë, Kadarenë tjetër të librit. Dhe, më në fund, ndodhi ajo që pritej: Kadareja i librit nisi të lëvizte tok me librin, po ndodhte me fjalë të tjera çudia që Walter Benjamin pikasi në frymëzim e tij hyjnor. Një vështrim i përqendruar dhe i matur, thënë ndryshe që di se ç'shikon, e lëviz sendin nga vendi. Dhe më tej shton: shpirti, i gjësë së gjallë a të vdekur qoftë, ka vetëm një lutje: kërkon vëmendjen e njeriut.

Kështu erdhi çasti kur Kadareja e pa atë që kërkonte dhe nuk mund të priste më: zgjati dorë për tek libri. Por, me ta çikur, dora u tërhoq, bëri prapa, siç bëjmë kur na djeg papritur diçka, dhe megjithatë, zmbrapsja këtë radhë ishte ndryshe: do të thoshe që Kadaresë edhe i dhëmbi, edhe i pëlqeu kafshimi i beftë i flakës së padukur që veç ai mund ta shikonte. Ja, - *gjesti* pa të dytë i Kadaresë: mes tij dhe librit, mes tij dhe fjalës së tij, ngrihet përherë një *flakë e padukur*, dhe në këtë flakë digjet përjetësisht e Vërteta e tij e madhe dhe e vështirë.

Do të shkruash për Kadarenë? - pyeta veten aty për aty. Ja kjo është e vështira që duhet të bësh: të mbledhësh këtë flakë të padukur që ngrihet mes tij dhe fjalës së tij. Nga na gjen kjo flakë dhe ku ngjizet kjo çudi e padukur? Nga thellësi të abysta të ekzistencës njerëzore dhe pastaj ngjitet pa u ndalur në lartësi të epërme dhe bëhet venë e fisme, nga më të ndriturat, në letërsinë e madhe europiane.

Athinë, dhjetor 2022

Duke lexuar **“Persët”** e Eskilit,
këto ditë... shoh ditët tona...

MARIUPOL

Ai qytet
Nuk është më
Mbi tokë
E lanë atë
Banorët
E fundit
Ai qytet është fshirë
Nga faqja e dheut
E të tjerët të vdekur
Në varre
Masive
Dhe fëmijët
Mes tyre
Lodrat
Nga të cilat
Nuk u ndanë
Shkuan me ta
Në vdekje
Qyteti nuk është më
Mbi tokë
Ai qytet është
Në qiell
Jerusalemi Qiellor
U ngjit mes
Qyteteve të pavdekshëm
Mes Gjonëve
Dhe Augustinëve
Shndritë
Mes yjeve
Njerëzit do e
Presin
Të vijë
Të zbresë
Në tokë
T'i turpërojë
Shkatërruesit
Ai qytet u gjend
Ndër qytetet
E padukshme të Kalvinit

U ngrit
I plagosur
Dhe i masakruar
I paarritshëm
nga çdo armë
Vuan plagët
Tokësore
Me të vdekurit
Dhe banorët e gjallë
U ngrit
Deri te Zoti
Zoti e përqafoi
Shkatërruesit
I përqesh
Dhe kur të kapërcejë
Çdo plagë
Zoti do t'i
Japi krahë
Do e lëshojë
Nëpër kujtesën e
Njerëzimit
Atëherë nuk do
Mund
Ta arrijë asnjë
Granatë
Zjarri
As shkatërruesit
Tani është
Në vend të sigurt
Në qiell
Tani është
Te Zoti

2 maj

KORI I PLEQVE PERSË

Kaherë s'ka lajme
Ata shkuan larg
Për të mbërritur lajmet
Kaluan shumë kufij
Vendet e huaja të shkatërrojnë
Të vrasin
Nënat e pafuqishme
Fëmijët e sapolindur

KOHË E POEMAVE TË MËDHA

poezi nga Mirash Martinoviq

Përktheu nga gjuha malazeze Qazim Muja



Asnjë luftë pa të
Nuk mundet
Ah luftëra të neveritshme
Dëgjohen vajtimet
Dëgjohen gjëmimet
Në qytetin e zbrazët
Hijet enden
Fantazmat
Shpirtrat e tyre
Si një luzmë bletësh
Rreth kosheres boshe
Qyteti u bë varr
Hijet lëvizin qytetit
Ushtria e madhe iku
Athua do kthehet

NË SUZA

(Atosa, nëna e Kserksit)

Në Suza tensionim
Suza e shkretë pa njerëz
Dikur një kryeqytet i fuqishëm
I Persisë
Vdekja në ajër
Në çdo cep të qytetit
Futet në dhomat mbretërore
Me thesare të pasura
Kah do që shkoj
Takoј hijet
Komandantët që
U nisën
Në krye të ushtrive të fuqishme
Me armën që mendja e njeriut
E shpiku
Dhe armëtarët e ndreqën
E largët është toka ku shkuan
Asnjë zë apo lajmëtar nga andej
Mendoj ashtu si
Një nënë e kujdesshme mendon
Ëndrrat më shqetësojnë
Fantazmat nuk më lënë të qetë
Luftërat
Grumbuj të vdekurish
Kudo trupa
Të shpërndara

Pa kokë dhe pa duar
Pa sy
Zotat i largojnë fantazmat
Më falni një gjumë të qetë
Do bëj fljime falënderimi
Për t'ju mëshiruar
Kot po lutem
Nuk ka perëndi
E braktisën Suzën
Prania e tyre nuk ndihet
Suza u mund
Pleqtë
Në fund të jetës
Fantazmat sundojnë qytetin
Suza është një qytet fantazmë
Pranë altarëve në tempuj
Kudo fantazma
Sikur nuk është më
Ushtria jonë
Sikur nuk janë më
Komandantët e saj
Eh shkuan me shumë élan
Dhe me shpresë
Në largësi të panjohura
Duke shpalosur flamuj ushtarakë
Duke kënduar
Këngët e fitores

LAJMËTARI

(Përderisa ka njerëz, bedenat qëndrojnë)

Mezi arrita gjallë në Suzë
Për të dhënë lajmin e keq
Që barta përtej
Kodrave dhe maleve të larta
Nëpër fushat me baltë
Rrugëve nëpër të cilat
Shkoi ushtri jonë e fuqishme
E armatës trime të etur
Për luftëra
Pushtime e etur
Për pre
Me komandantë trima
Dhe një mendim
Të vetëm
Për të shkatërruar Heladën

Por perënditë ishin
Më të shpejta në mendje
Kserksi i harroi
Perënditë
Harroi
Drejtësinë
Dëshira e vetme ishte
Të pushtojë Heladën
Me zinxhirë skllavërie ta prangosë
Por fati i luftës u kthye
Forcat që
Me çdo gjë menaxhojnë
U kthyen kundër nesh
Ushtri e fuqishme u kërdis
Falangë e pa trembshme që
Vdekjen mbillte në çdo anë
Unë isha dëshmitar
I shkatërrimit tonë
Në Salaminë na
Braktisi fati
Na e mbylli rrethin
Flota
U shkatërrua
Njëmijë anije
U fundosen
Mijëra luftëtarë
Vdiqën

U hapën mijëra varre
Në dhe të huaj
Të largët

FRYMA E MBRETIT DARIUS

Edhe pse nga kjo anë
E di
Por më thuaj Atosë
Ti je akoma atje
Çfarë ndodhi në të vërtetë
I shoh pleqtë që habiten
Ata kanë respekt
Për mua të vdekur
Ata nuk do më shqetësonin

Nuk kam asgjë të mirë të të them
Zoti im i mirë
Lavdi e Perandorisë Perse
Ti që s'e kalove kufirin
Ti që i dije
Ligjet
E Zotit e të njeriut
Djali ynë nuk e dinte këtë
Dhe nuk iu përmbajt
Asaj që përcaktojnë
Zotat dhe natyra
Përtej Hellespontit
Bëri urën
Brigjet i lidhi me anije
Deshi ta frenonte detin
Zotave nuk u pëlqej kjo
Kush e frenoi detin
Kaq shumë ushtri provokoi
Qiellit nuk i pëlqej kjo
Vuri në lëvizje fuqitë që
Me forcë goditën
Djali ynë është arrogant
Atosë
Ai provokoi perënditë
Zemërimin e Qiellit
Ndaj ushtarëve tanë
Shpirti im po fliste me të
Dëgjoi por nuk deshi
Të bindej
Donte një popull të lirë
Ta hidhte në skllavëri
Të thyente shpirtin e tyre
Kjo nuk është e mundur
Këtë nuk e duan zotat
Ai mbolli tërbimin
Prandaj mblodhi
Frytet e së keqes
Të vdekurit nuk bëjnë asgjë
Shumë e dashura bashkëshorte
Tani po bartë barrën më të rëndë
Fatin e Perandorisë Perse
Të vdekurit janë ndërgjegjja e zgjuar
Te të gjallët
Por të gjallë pak

Kanë mbetur
Unë duhet të kthehem
Atje nga
Nuk ka kthim
Ajo që mendon se më thirre
Është ndërgjegjja jote, Atosë
Ti më thirre
Dhe ia arrite
Por kush
Do i thërrasë të vdekurit e shumtë
Që mbetën në Salaminë
Dhe ata afër Platesë
Dhe ata në vende të tjera
Asnjëherë në një ditë
Nuk vdiqën aq shumë edhe
Më shumë mbetën në Beoti
Thesali dhe Maqedoni
Duke vdekur nga uria
Shumë u mbytën
Në lumin Strymon
Në ujërat e tij të shenjta
Peshqve për gosti
Kur disku i diellit
Shkriu koren e akullit
Kush do t'i zgjojë
Ushtritë e vdekura
Atë ëndrrën që ëndërrove
Se djali ynë Kserksi
Vuri në zgjedhë dy gra
Një grua persiane
Dhe një tjetër greke
U bë realitet
Grekja theu zgjedhën
Që ia vuri në qafë
Atë e shtyu
Dhe ra

Por ku u zhduk tani?
I famshmi i fuqishmi Darius
Ishte për një çast dhe iku
Hadi nuk të lëshon
Të gjithë janë *tani* atje te ti
Do i takosh herët a vonë
Ty zotat të lejuan për pak
Por kush do u lejojë atyre
Të vijë
Të vijë lulja e tokës Perse
Në livadhet tona tokësore
Të lulëzojë
Edhe një herë
Për pak
Ajo dëgjoi zërin e Dariusit
Mardoniusi nuk do kthehet
Që me një ushtri të vogël mbeti
Të luftojë
Ai është i vdekur
Të vdekur të gjithë ata që shkuan
Po t'u ngritshin monumente
Ata do mbulonin Persinë
Ai që përhapte blasfemi
U dallua mbi të tjerët
Duke shkatërruar tempujt grekë
Duke thyer perënditë
Statujat e tyre të shenjta
Duke mos e ditur se
Shpirti i tyre kalon
Në luftëtarët e tyre
Që t'u japë forcë dhe krahë
Prandaj dhe fituan

U bënë tempuj të gjallë
Strehimore e perëndive

E kujt është Susa tani
E shkretë
Pa njerëz dhe perëndi

KORI

*Në çfarë përfundimi, i fuqishmi Darius,
çojnë fjalët e tua?*

SHPIRT I DARIUSIT

*Mos e sulmoni më kurrë Greqinë!
Edhe po të jetë ushtria juaj më e fuqishmja.
Toka është aleati i tyre.
Dhe nga kjo anë
Më kujtohen shpesh
Termopilet dhe Maratona*

Isha perandor

Perandoria ime ishte
Nga lindja e deri në perëndim të
Diellit
E ku jam tani?
Atosë

Ku është Perandoria ime
E ku dielli

ZËRI I ESKILIT

Me ne nuk ishin
Zotat
As Zeusi e as Posejdoni
As të tjerët
Në Maratonë
As në Salaminë
Ishim ne
Me vetveten
Në vendin e vet

Me ne ishin
Fëmijët tanë
Athina
Qytet i lirë
Lule nga
Fushat tona
E dinim që do binte
Ai gjigant
Perandori e gjithëfuqishme

Me ne ishin
Lumenjtë tanë
Dhe malet tona
Gjuha jonë
Fjalët dhe lutjet
Me ne ishte
Çdo gjë e jona
Të gjithë të vdekur prej kohësh
Në këtë tokë
Të lindur
Çdo sinor
Ata pa shenjë
Dhe emër
Dhe ai fshatari
I cili
Mes nesh
U shfaq papritmas
Pa armë
Me parmendë
Filloi të kosiste
Armiqtë
E dija
Se do fitojmë
Sepse në të fliste
Tokë e shenjtë
Emri i tij ishte
Eketlo
Vezullonte në të
Shpirti i Heladës
Kjo ushtrinë tonë
E ngriti
Deri në qiell
Çdo ushtari
I dha krahë
Zotat nga ne
Ikën
Mbetëm vetëm
Po mbështeteshim
Te perënditë
Kush e di çfarë do ndodhte
Kështu
Nuk kishim
Në kë të mbështetemi
Përveç në vetvete
Prandaj fituam
Edhe në Maratonë
Edhe në Salaminë
Njeriu e
Mundi gjigantin
Që ishte i plogësht
Dhe i rëndë i palëvizshëm

Të gjithë të vdekurit ishin
Me ne
Punonin për të gjallët

Krahas kësaj ishim
Të lirë
Për këtë
Fituam

IN MEMORIAM FASLI HALITI

Në 5 dhjetor 1935 lindi poeti Faslli Haliti. Për të Moikom Zeqo është shprehur; “I paimitueshmi dhe i pangjashmi” Poetët si Fasliu do të kujtohen gjithmonë. Sa herë harresa të bjerë si natë mbi poezinë, atë do ta gabojë agimi. Kështu do të ndodhë dhe me poetin. Kur të na duket se e harruam, dikush patjetër do të kujtohet për të. Dhe ky do të jetë lexuesi i dashuruar me poezinë e mirë. Sa herë stigma shfarosëse është lëshuar mbi letërsinë, dikush e ka mbrojtur atë. Perandori kinez Qin Shi Huan që filloi ndërtimin e Murit të Madh, në vitin 213 para lindjes së Krishtit, dha urdhër të digjeshin të gjithë librat, ato të historisë, të antikitetit, duke përfshirë dhe poezinë, sepse i quante gjëra të kota. Dhe kushdo që nuk i bindej urdhrit do të vritej. Çmendurisë së tij nuk iu përgjigjën të gjithë; megjithë trysninë e tmerrshme, terrorin, ndëshkimin, pati shumë nga ata që e fshehën librin, e ruajtën. Harresa është si perandori Qin, por nuk do t’ia dalë me poezinë, veçanërisht me poezinë e mirë, siç është ajo e Faslli Halitit. Sot është koha më e vështirë për poezinë, veçanërisht për të, ajo nuk blihet, ajo nuk lexohet, libraritë nuk e pranojnë, botuesit sakrifikojnë shumë, sepse nuk fitojnë asgjë. Dhe për të njerëzit më të ditur të botës thonë se është mbretëresha e artit. Paradoksale? Ashtu duket! Përmenden Homeri, Shekspiri, Dante, që iu përkasin të gjithë kohërave, por në të vërtetë është koha e bankave; euros dhe dollarit. Mos jemi gjithashtu në kohën e perandorit Qin? Sdua ta besoj, përderisa shkruhen poezi të tilla si DORA dhe TË BËHET, THA ZOTI.

Nga Xhevair Lleshi



DORA

Dora hapet,
Mbyllet.
Dora
Kap,
Lëshon,
Jep dhe merr,
Vë dhe heq pranga,
Lidh dhe zgjidh zinxhirë,
Vë dhe heq litarin,
Godet dhe përkëdhel,
Ngul dhe shkul,
Ngre dhe shemb;
Mbiell dhe korr,
Hap e mbyll dyer.
Dora lan
Dora lyen;
Dora lan dorën,
E majta lan të djathtën,
E djathta të majtën,
Të dyja lajnë njera – tjetrën;
Dora
Është flori,
Dora është topuz;
Ndan dhe bashkon
Dora, pykë,
Ndan dhe çan.
Dora pajton,
Dora bëhet grusht,
Bëhet pëllëmbë, qëllon,
Të lë pesë gishta në faqe
Dora përkëdhel;
Dor flet me gishta,
Flet pa gramatikë,
Pa sintaksë,
Pa morfologji,
Pa gabime ortografike, ortoepike,
Dora bën dhe çbën çdo gjë.

Dora
Autore e çdo vepre,
Autore e çdo ndërtimi,
Autore e çdo konstruksioni,
Autore e çdo shembjeje, shkatërrimi,
Dora firmos lindjet dhe vdekjet,
Dora
Fut dhe nxjerr,
Mbërthen e zbërthen,
Ndez dhe shuan;
Gris
Dhe arnon,
Ngjit
Dhe shqit,
Qep dhe shqep,
Zbardh dhe nxin.
Njeriu s’bën dot pa duar.
Vetëm Zoti bën dhe çbën.

TË BËHET, THA ZOTI

Dhe u bë.
U bë dita, nata
Qielli, dielli, hëna,
Yjet.
U bë toka dhe ujërat,
U bënë erërat, breshëri, vetëtima, rrufeja...
U bënë kafshët, shpendët,
Hidrikët, reptilët, mikroorganizmat, viruset.
Edhe çudibërësi i përrallës i thotë mbretit
si një zot virtual:
Unë e shëroj djalin tënd madhëri.
Nëse më gjendet një kostum
Që të mos jetë prerë me gërshtë,
Të mos jetë qepur
Me gjilpërë,
Të mos ketë asnjë pullë.

fushatë zgjedhore

ka lindur një tigër i ri.

hëna ecën
dy pëllëmbë përmbi tokë.

balta

gjithë baltën e myzeqesë e mora
nëpër duar
të gjeja atë gjurmën e dikurshme
të këmbës time të zbathur,

por më kot, sa kot

gjeta, vetëm kryqin e vogël të
këmbës së një zogu.

tani më duhet ta marr këtë baltë
ti jap jap përmasat e mia, të rikrijoj
vetveten
dhe prapë të bëjë rrugë
dhe prapë të le gjurmë.....

.....tutje, larg, një perëndim I vogël
si zog Ardenice,
loz me ngjyrat e veta
dhe vdes përmbi lumë.

guri

është një gur
me përmasat e një ëndërre

gur
prej gjaku dhe zemre

lahet nëpër lot
lëmyshket nga malli
ndricohet nga një brengë.

dhe ti më thua
se është
vetëm i yti.

njërëzit e mi

njërëzit e mi nuk morën pjesë në
luftë
por me shpirt e zemër
luftës i dhanë bukë.

skanë plagë, dekorata,
as plumba të vdekur në trup,

njërëzit e mi për luftën dhanë
bukë.

dhe buka, si buka, sdo lavdi, as
emër
vec një kryq në heshtje
dhe një dorë në zemër.

faslli haliti

ku kujton se je
fëmijë me kobure
që rrëzove shtambën
nga koka e një cupe.

vetëtin në Hyzgjokaj
bubullin në Lushnje.

ku kujton se je
o I vogli, I miri
dorëzoje koburen
o faslli haliti!...

....krisin shtamba shirash
si shandanë prilli.

kasollja e vogël me lule dimri

sa ngrohtë rridhte jeta
sa ngrohtë,

PERËNDIMI QË VDES
MBI LUMË

Cikël poetik nga Aleksandër Bardhi



natë kasolle të vogël
rrethuar me lule dimri.!

gjersa ti ike një ditë,
ike, e braktise.

se zogjtë e dëborës
që rrisnim së bashku
nuk këndonin më për ty.

pastaj ikën dhe zogjtë.
mbeta vetëm unë, lulet e dimrit

dhe kasollja që kërrusej
nga hija e një korbi!...

askush

askush se vuri re
atë gjestin e pavëmëndhshëm
tek largonte nga fytyra
merimangën e dritës.

askush si pa
rrathët e të zezes
tek thurej si lojë
kurora e djallit.

mort

kam hapur dyert e mortit
për të vërtetën time,

por askush s'më vjen

njërëzit janë lidhur
me gënjeshttrat e veta.

natë

kam humbur monedhën e fatit.

natë, të lutem
ndize pak yllin e sabahut.

pa titull

e shkuara shkoi
dhe e ngjara ngjau,
unë zbrita te kjo tokë

nga brirët e një kau;

sa gjatë, e pafund
sa e lodhshme rruga,
nga buka te kripa
nga kripa te buka!...

lutje

vetëtima e zezë
ulur në gjunjë
bëri kryqin tre herë
përballë shegës me lule,

dhe u fik,

qielli u mbush
me thëllëza shirash...

një burrë i lavdishëm

unë banoj në një shkallë
me një burrë të lavdishëm
thonë se lagjja jonë
emrin e tij do të ketë,
trimëritë, bëmat,
ende njërëzve nëpër festa
ja u japin si hallvë,
ja u shpërndajnë si meshë.

unë banoj në një shkallë
me një burrë të lavdishëm
që është si gjithë të tjerët,
dhe askujt si ngjan;
...në kodrinat e supeve
pakëz të rrëzuara
një yll I vdekur
I veton si nishan.

gravure

doli hëna prapa malit
në male shkriu dëbora

cub i maleve të mia
pse të ra thika nga dora?!

cub, o cubi im
me thikën e dritës
ngulur në gjoks!...

bulevardi “Jakov Xoxa”

në gjurmët e të papunëve
po celin lulet e kripës së hidhur,

Jakov, vëlla!

merimangat e kuqe

më thirri dikush në shullë të dimrit
cohu vëlla, se të sulmon
merimanga,
me atë thumbin e hollë që mpin
nervin e zgjimit
me shënja klinike – vidhimat
e gjata.

vërtet – thashë me vete – herë herë
nuk ndjej
cicërima, zëra, ndonjë tingull lufte...
pastaj mendova se në rrugën time
të gjatë
do kem marr dhe unë
pak helm merimangash të kuqe.

hije

në hijen e deleve të zeza
një ujë
bënë gjumin e vapës.

ditë vere në lushnje

te porta e qytetit
më foli në vesh
e bukura e pazarit:

sot,
kurorëzohet monark
lejleku i sherif balit!...

himn i pakënduar

një here, vec një here u shfaq në
dritaren time
ai shpend i zjarhtë, ai shpirt në
fluturim;
eja, eja – më tha – të këndojmë
himnin e vdekjes
me fytin e një zogu
gjithë qiejt e botës ti pijmë !

dhe shkuan aq vite, aq vite që atëherë
dhe ai himn I pakënduar ende
njomur mi mban sytë
....ishte koha kur zogjtë dimërorë
gjendeshin të vdekur ndanë
udhëve
me ca kokrra breshëri
të kuq në fyt!...

një gotë verë

për miqtë që dua
e kthej nga një gotë verë,
po gjithmonë një gotë bosh
e mbaj për ca të tjerë

qesh ...dhe më kujtohet
fallxhorja në lagje,
që kupën me plumba
e mbante jashtë në dritare.

po këta të tjerët e mi
natyrisht sjanë lugetër,
janë ca kokërrza rrufesh
që vrasin në të kthjellët.

eh... dhe prapë mbush gotën
për mikun që dua,
hajde – thotë fallxhorja
edhe një shëndet për mua!...

dashuri në kopështin e zotit

ku as vdekja s'të gjen
as zoti stë dëbon

atij pylli ne I thoshim kopeshti I zotit
rrethuar me kangjella të padukshme
mëkatesh,
pikërisht aty, në lëndinë e errët
dy trupa lakuriq, bënin ca lojra
zjarresh.

ju përvodha nënës, ciganeve
gjithashtu
e tek përgjoja majë gishtash
hileqar e i paturp,
një shkrepëtimë e zeze nga
kurorat e drurëve
si gjarpër i mëndafshhtë mu
mbështoll në trup.

në cast mu gjend nëna. vallë
c'shënjë më qe dhënë
mua të voglit, nga shënjtorja e
madhe,
dhe ju shëmba nënës, me lutje e të qara
I prekur, I fyer ... nga mallkimi
I ciganeve!..

o zot, sa shumë qeshte nëna me
mua
aq shndrisja e zbukurohesha dhe
unë nga të qarët...

ishte e djelë. binte një shi I butë
gardelinash
si të ishim dasmorë në një dasëm
ciganesh!..

Këngë

ti ike si zogu me këngë në gojë
dhe unë të përcolla
me lutje të heshtura.

tani shpesh e më shpesh
jetoj me dilemën:
ja vlen të jetosh për dashuritë
e humbura ?!
përgjigjen ma jep ti që cdo natë
i lutesh zotit
të më lerë, të shkruaj.... këngë të
bukura!..

dritë e zezë

ndamë ditët, ndamë netët
në mes një dritë të zezë vumë,
dielli mbeti andej nga ti
hën' e zbehtë, këtej nga unë.

ndamë fushat, ndamë kodrat
në mes tyre vumë një lumë
një kështjellë mbeti nga ti
kishë e vjetër këtej nga unë.

në fund pyllin e mëkatit
garanci në kryq e vura,
murg I vjetër këndoi për ty
një murgeshë lutet për mua.

po prapë o prapë në borxh jemi
unë tek ti e ti tek unë...
lumi ngjitet lart nga kisha
dritë e zezë zbret mbi lumë.

çarku

unë ngrija çarkun në pyll
tigri e merrte në gojë...

ulet nata. zbret e vona.
ja dhe pak e shkoj në ëndërr.
tigri lahet mbi një yll
luanesh
më fle te këmbët.

SHËNIME RRETH
ROMANIT
"AMERIKANI" TË
ODISE KOTE.

Nga Dr Dorian Koçi

Gjirokastra është një qytet që rilind
përmes mitesh. Kjo frazë nuk është
frazë shabllone për të përshkruar një
qytet krejt të veçantë në tipologjinë
etno kulturore shqiptare, por një befasi e
vërtetë kur lexon romane që magmën e
vetë shpërthyes e kanë në trashëgiminë
kulturore, mitet dhe rrëfimet e këtj qyteti.
Romani “Amerikani” i shkrimtarit Odise
Kote është një tekst që në nënshtresat e
veta i ka në rrëfimet dhe mitet ciklike të
qytetit po aq sa dhe në dokumentimin
e përditshmërisë së qytetit. Autori, një
zë autoritar tashmë në letrat shqipe ka
krijuar kodin e vet të leximit të së shkuarës
dhe kumtimit të saj në të tashmen. Materia
letrare e romanit “Amerikani” nuk vjen
nga shoqëria e Gjirokastrës mitike, por
e kohës ku një pjesë e madhe e lexuesve
kanë qenë pjesëmarrës dhe protagonistë.
E shkuara e regjimit komunist në Shqipëri

është eksploruar së fundmi në letërsinë
shqipe por libri që kemi sot në duar sjell
një këndvështrim të ri përmes fabulës së
presonazhi kryesor Nelson Andrea, një
shqiptaro-amerikani që humb të gjithë të
drejtat dhe liritë qytetare në Shqipërinë e
viteve 60'. Udhëtimi i tij për në Shqipërinë
komuniste për të përmbushur një amanet
të babait, kthehet papritur një udhëtim
për në ferr. Në këtë rast karakteri kryesor
që përmes rrëfimeve të babait është i afërm
me botën shqiptare, kthehet në një Tjetër
ku gjendet në atdheun e vet. Ky paradoks
rrëfehet që në faqet e para ku personazhi
duket se përjeton krejt papritur një
realitet kafkian , të shndrrimit të detyruar
nga Nelson Andrea –qytetar i botës së lirë
në Nelo Andrea-qytetar i totalitarizmit
komunist shqiptar. Shkrimtari Odise Kote
përdor me mjeshtëri skicimin e realitetit
përmes personazheve që plotësojnë njëri-

tjetrin. Në historinë e letërsisë botërore
dhe veprave të mëdha ekziston pothuajse
gjithmonë një dyshe personazhesh shumë
të afërt që përveçse se ndajnë një miqësi
shumë të ngushtë apo antonizëm mes
tyre në fakt ndihmojnë dhe njëri-tjetrin
për të kuptuar realitetin. Kështu p.sh tek
kryevepra e Servantesit “Don Kishoti i
Mançës”, të sjellë aq mjeshtërisht nga
Noli dhe Petro Zheji në shqip, marrëzive
kalorësiake dhe fluturimeve në fantazi
të Don Kishotit i duhet serioziteti dhe
pafajësia e Sanços për ta rikthyer atë
sërish me këmbë në tokë. Personazhi
tjetër i romanit “Amerikani”Rako Sirani
kthehet në një cerber të ferrit komunist,
ku Nelson Andrea gjendet i zënë në
kurth. I vetmi mjet përmes të cilit Nelson
Andrea udhëton në botën e ëndrrave
dhe braktis realitetin e hidhur është
violina. Loja virtuoze e violinës e mësuar
në Konservatorin e Bostonit kthehet në
himnin e jetës që shpëton Nelson Andrean
nga ferri në të cilin është gremisur.
Arkitektura e dhunës përshkruhet e
shkallëzuar në roman si rrethe të ferrit ku
galeria e personazheve rrëfen përvojën e
vet. Në mënyrë paradoksiuale personazhi
më fatlumtur gjendet Pandora, grua ja e
Nelson Andrea e lindur shurdh memece
e cila ndërvepron me realitetin përmes
shenjave. Qyteti njeh ndrrimet e stinëve
përmes valëve te terrorit. Propaganda,
gënjeshtria dhe terrori janë të dy anët
e një medaljeje në regjimet totalitare.
Nelson Andrea gjendet i mbërthyer mes
këtij trinomi ku burgu i dytë i detyrohet
manipulimit dhe gënjeshtrave të hetuesit
Kenan, një nga burmave të diktaturës.
Romani është një pasyrë e rrëfimit të
mëkateve njerzore, ku babëzia për para,
hedonizmi dhe marrëdhëniet imorale
shfaqen në tërësinë e tyre. Opozitarizmi
i heshtur dhe i drejtë për së drejtë i së
keqes shfaqet përmes portretizimit të
mësuesit të fizikës Oto dhe rrethit të tij
që shndrohohen në përçues të vlerave të
kulturës universale. Format e terrorit
si puna edukuese dhe burgosja nuk i
mposhtin dëshirën për ndryshim ku arti
dhe letërisa kthehen në formë rezistence.
Nata e gjatë agon në sërish përmes
artit dhe muzikës së violinës. Pjesa e
fundit e romanit duket se është një pjesë
muzikale Te Deum e luajtur në tempullin
e demokracisë, ambasadën amerikane të
porsa hapur në Tiranë.

Shkrimtari Odise Kote shquhet për
përdorimin e një gjuhe të pasur dhe gjithë
kolotit të së folmes jugore dhe dialektit të
Gjirokstrës. Leksioni i romanit regjistron
fjalë të së folme së përditshme të cilat
marrin vlerë të veçantë në përdorimin
e tyre nga personazhet. Stili i romanit
dhe kompozicioni reflektojnë tempon
e zhvillimit të ngjarjeve. Në të gjejmë
klimakse që befasojnë lexuesin si janë
futja në burg e Nelson Mandelës që
në fillim të romanit, vdekja e djalit të
tij, futja për së dyti në burg dhe pjesa
e fundit me koncertin në ambasadë.
Përdorimi i ironisë dramatike është një
vlerë e shtuar e këtij romani. Shfaqja e
Rako Siranit në koncertin në amabasadë
shpjegon paradoksin e funksionimit
të demokracisë liberale në Shqipëri.
Ky artific letrar duket se ilustron qartë
idenë se raporti mes perpatorëve të
diktaturës dhe viktimave filloi gabim në
agin e demokracisë shqiptare. Romani
“Amerikani” pasuron letërsinë shqipe,
përveçse është një arritje në prozën
e Odise Kotes. Si i tillë ai meriton një
vëmendje të veçantë dhe besoj se lexuesit
dhe kritika do ta vlerësojnë së shpejti në
hierarkinë e letrave shqipe.



Piro e kishte bërë zakon që çdo mbrëmje të qëndronte gjatë në dhomën e ndenjjes. Lexonte ndonjë libër ose ndiqte ndonjë program në TV. Shkonte me shpresën se ndoshta e shoqja dhe i biri do të vinin e do t'i bashkoheshin. Gradualisht, mund të bisedojmë qetësisht për marrëdhëniet në familje. Në fakt, për prishjen e tyre, mendoi ai. Për moskomunikimin, sidomos për agresivitetin e të birit me të atin. Qoftë edhe për herë të fundit. Njëherë e përgjithmonë.

Anita disa herë kishte ardhur pranë të shoqit. Shkëmbejin ndonjë mendim, por më shumë heshtje. Edhe kjo heshtje është e pasinqertë, mendonte Piro. Njëlloj si fjalët. Ç'jetë e mërztishme në këtë shtëpi, pëshpëriti. U përpoqa t'i jepja vetes një të ardhme, edhe pse jo prej gjakut tim, por ja ku mbërrita. Rrezikoj t'i humbas të gjitha. Ëndërrova me dëshirë të madhe të zgjeroja familjen time, por, me sa duket, po humb edhe atë që kisha.

E shoqja pothuajse asnjëherë nuk shfaqte ndonjë shqetësim për gjendjen e nderë në familje. Asnjëherë nuk e hapi temën e acarimit midis atit e birit. Edhe kur i shoqi kërkonte ta fuste brenda krizës, ajo tërhiqej mënjane. Qëndronte si hije dhe priste vetëm momentin të largohej. Të largohej edhe fizikisht, pasi kishte fshehur shikimin, mendimet, gjykimet e veta. E paqartë dhe e ftohtë deri në dëshpërim! Nga se druhet kjo grua? pyeste veten Piro. Nga ne të tre, i shkoj nëpër mend, është pikërisht ajo që i di më mirë rrethanat e konfliktit. Ndoshta edhe burimin e tyre. Ajo ishte në mes. E kishte zgjedhur vetë këtë rol të cilin, për fat të keq, nuk po e luante ose po e luante keq. E heshtur dhe e pakuptueshme, si gjithmonë kohët e fundit.


Mbrëmje të tëra Fredi nuk doli asnjëherë nga dhoma e tij. Derën e dhomës vazhdonte ta mbante të mbyllur dhe kjo ishte një shenjë e mjaftueshme për Piron se i biri vijonte të ishte i ngarkuar kundër tij. Qëndrimi mbyllur pikërisht këtë dëshmonte. Apo ndoshta tek i biri kishte lindur ndonjë ide për qetësim të marrëdhënieve me të atin? Jo, jo, mendoi qetësisht Piro. Ajo derë e mbyllur shprehte këmbënguljen e Fredit për t'i mbajtur të ngrira marrëdhëniet dhe t'i ashpërsonte kur t'ia sillte rasti. Edhe sa kohë do të zgjasë kjo gjendje e tendosur? Për të plasur sërisht e sërisht. Kjo do të ishte edhe më e padurueshme, konkludoi ai me vete.

Piro kishte menduar njëherë ta thërriste të birin të vinte të ulej krah tij për të biseduar, por i druhej shpërthimit të befasishëm të tij. Donte ta shmangte acarimin e çastit të parë. Kështu kishte ndodhur shpesh më herët. Tani duhej evituar me çdo kusht. Prandaj ai do të vazhdonte të rrinte çdo darkë në të njëjtin vend. Do të priste me durim që dera e të birit të hapej dhe bashkë me të ndoshta do të gjenim një mënyrë qetësuese për shpirtin e tij të trazuar.

Fredi, nga ana e tij, e kishte kuptuar që i ati qëndronte çdo mbrëmje në dhomën e ndenjjes. Madje, për orë të tëra. Ndoshta pret të dal unë, mendonte. Dinte, gjithashtu, se atje ulej edhe e ëma, por, si zakonisht, ajo nuk rrinte gjatë. Edhe kur e bënte këtë, fliste pak ose aspak. Është e qartë se brenda vetes ajo vazhdon të jetë në anën time. Pa u lëkundur, pa mëdyshje, mendoi. Nuk kishim bërë ndonjë pakt. Sicili sillej sipas mënyrës së vet, por ecnim në të njëjtën linjë. Mrekullisht, ishim në harmoni, thoshte ai me ngazëllim.

Tani nuk e kuptoj pse ai po këmbëngul sërisht e sërisht, mendoi Fredi. Ai e di që nuk e duroj. Madje, që e urrej. Nuk dua as ta shoh. Kaq. Megjithatë shumë gjëra nuk i kuptoj. Nuk i shpjegoj dot. Pse nuk e dua më. As pse nuk e duroj dot. Madje, në rastet e përplasjes ndiej një kënaqësi të egër ndërsa e sulmoj, sikundër kur i kthej fjalë, kur e shoh të tromaksur, të shpërfytyruar. Aq sa më duket sikur shpërfytyrohem edhe vetë, bëhem tjetër njeri. Krejtësisht i kundërt nga ai që kam qenë dhe nga ai që jam realisht në jetën e përditshme. Mjafton ta kujtoj atë, mjafton ta di se është ulur aty dhe pret, dhe e humbas toruan. Nuk është si "Pritja e Godosë". Në thelb, është një pritje për sherr. Këtë e dimë të dy, por mua kjo nuk më pëlqen aspak. Nëse dal unë, sherri del bashkë me mua. Nuk kam ç'të bëj. Nuk e shmang dot.

Nuk është aspak se e urrej ngaqë ndiej ndonjë frikë prej tij. Jo, ai është aq paqësor, sa nuk frikëson askënd. Por, për djall, kjo më acaronte edhe më shumë. Më heq trurin, prandaj



shpesh më duket se e urrej në mënyrë të verbër dhe kjo e bën edhe më të pashpjegueshme gjithçka. Diçka që unë nuk jam në gjendje ta shpjegoj. Tërë ajo dashuri që kam pasur për të pa u kuptuar është shuar. Si ka ndodhur? As nuk ia kam idenë. Madje, shpesh nuk arrij të kuptoj nëse ka ndryshuar ai apo unë. Apo ndoshta të dy. Por di që nuk e kuptoj më. Nuk e njoh më. Është bërë i papranueshëm, i pavlefshëm. Diçka duhet të ketë ndodhur tek ai. Apo ndoshta edhe në trurin tim? Ai flet, ndërsa dëgjon. Por, edhe e kundërta: Dëgjon, ndërsa flet. Pa u kuptuar në asnjërin mënyrë. Nuk e di pse është bërë kështu. Ndonjëherë mendoj se ndoshta kështu ka qenë gjithmonë, por unë nuk e kam ditur.

Më mirë të rri këtu në dhomën time, mendonte Fredi. Nuk dua të acarohem me të tani. Nëse do të ndodhte, do të më duheshin orë të tëra të çlirohem prej maktheve të sherrit dhe po të mos ishte mami, ndoshta do të më duheshin ditë të tëra që ta kapërceja atë gjendje që më krijohet pas çdo sherri. Është dashuria e saj, ngrohtësia e saj, aroma e saj, që më kthejnë veten time. Vetëm pranë saj zbutem e bëhem sërisht njeriu që jam në të vërtetë. Nuk është sekret ta them se është pikërisht kjo "vetja ime" që më pëlqen. Me veten time të vërtetë ndihem në paqe, kurse ajo "vetja tjetër" është si një i huaj që vjen tek unë tinëz e më zaptton shpirtin, trurin, gjithçka. Mjafton një provokim i lehtë nga im atë dhe gjithçka brenda meje tjetërsohet brutalisht. Dhe ç'dhembje koke ndiej! Ç'dhembje e padurueshme koke është! Dhe sa shumë dua të dal nga ajo gjendje...

Më kujtohet se më herët jam munduar për orë të tëra të gjykoj veten time. Çfarë më bëri të mos e dua, çfarë më shtyn t'i përgjigjen egër? Aq sa shpeshherë bëhem gati të ngre dorën kundër tij. Disa detaje nga jeta ime e fëmijërisë, disa përkujdesje të tepruara, rroba të shtrenjta, shëtitje në bulevard, për të cilat e kisha fajësuar më herët, tani më duken vogëlsira. Të parëndësishme për një kapërcim të tillë nga adhurimi në shpërfillje. Dhe gradualisht, në urrejtje.

Çfarë është bërë, nuk mund të zhbëhet! mendoi ai, duke kujtuar një varg nga Shekspiri, varg për të cilin kishin diskutuar gjatë për ta zbërthyer pak ditë më parë në leksionet mbi dramën e gjeniut. Natyrisht, pa rënë askush në një mendje me të tjerët. Kurse ai më pret çdo mbrëmje në dhomën e ndenjjes, përpara TV. Çfarë kërkon? T'i jap arsytet pse e urrej? Po ato unë nuk i di as vetë. Ndoshta nuk do t'i di kurrë. Sado përpjekje kam bërë, misterin e kësaj krize nuk e kam pasur asnjëherë të qartë. Gjithçka më duket e mjegullt ose si diçka që

zhvillohet përtej mjegullës, e errët, e vështirë. Një marrëdhënie e pamundur, prandaj ndoshta edhe e pashpjegueshme. Nuk mund ta shtyj më kështu. Dua të çlirohem njëherë e mirë prej saj. Për fat të mirë, më duket se të njëjtën dëshiron edhe ai. Veçse në anën e kundërt. Atëherë, ajo që ka për t'u bërë një ditë le të bëhet sa më parë. Për mirë apo për keq, rëndësi ka të marrë fund kjo mënyrë jetese. Më në fund, secili të dijë vendin e tij, jetën e tij, rrugën e tij. Aty për aty Fredi vendosi që të nesërmen do ta mbante derën hapur dhe sapo të shihte të atin të ulej në kolltuk do të shkonte edhe ai atje. Ishte i sigurt se të njëjtën do të bënte edhe e ëma. Pa orën dhe kuptoi se kishte kaluar mesnata. Me kokën të rënduar dhe me një dhembje të lehtë në të dy tëmthat, ai u zhvesh dhe ra të flinte.

Një ditë më pas Fredi ishte kthyer në shtëpi më herët se zakonisht. Ndërsa po lexonte diçka në dhomën e tij, ndjeu se prindërit erdhën njëri pas tjetrit. Derën e dhomës, sikundër e kishte planifikuar, e kishte lënë të hapur. E ëma e vuri re dhe një drithërimë i përshkoi tërë trupin. Si është e mundur? mendoi ajo. Ndaloj për një çast në hapësirën e çliuar nga dera e hapur dhe e pyeti: Çfarë ka ndodhur kështu? Mirë je? Mirë, thjesht po pres. Nuk do ta mbaj më të mbyllur derën e dhomës. Kur e ke vendosur këtë gjë? Si nuk ma ke thënë? Mbrëmë në mesnatë. Do të ishte e tmerrshme të rimë gjithë jetën në pritje, sikur luajmë teatër absurd. Le të provojmë. Asnjëherë nuk i dihet fundi diçkaje. A mendon edhe ti kështu? Pak a shumë, i tha e ëma dhe u largua qetë-qetë për në dhomën e saj. Më pas dera e apartamentit u hap e u mbyll sërisht. Ishte Piro. Edhe ai nuk i shpëtoi befasisë së derës së hapur. Ankthi i përshkoi trupin, por nuk ndaloj. Vijoi hapat dhe u fut në dhomën e tij.

Në orën e zakonshme ai zuri vend në dhomën e ndenjjes. Në TV ishte momenti i kronikës së zezë. Një krim i rëndë në familje, në një fshat të largët, djali i pret kokën... zbulohet grup kriminal për pastrim parash... Ndërkohë Anita kishte zënë vendin e saj dhe po dëgjonte me vëmendje. Nuk vonoi dhe Fredi doli ngadalë nga dhoma e u ul pa bërë zhurmë. Të tre sy e veshë te TV. Plagoset një polic trafiku... Një sherr ka ndodhur në afërsi të sheshit "Nënë Tereza"... Policia ka qenë afër vendit të ngjarjes dhe ka ndërhyrë menjëherë... ka ndaluar disa studentë... përdorues drogash... konflikt midis shpërndarësve dhe përdoruesve... Inicialet: J. P., K. S., M. N. Asnjëri prej të treve nuk fliste. Ishin të përfshirë në detajet e lajmit. Dukeshin të hutuar dhe të tronditur.

Kundër natyrës së tij, Piro nuk e përmbajti veten dhe pyeti me një zë gati të mekur, si t'i

drejtohej më shumë vetes sesa së shoqes apo të birit: Mos ishte Joeli ai? Nuk ka mundësi, tha sërisht, por këtë herë me zë të plotë dhe me njëfarë sigurie. Pa pritur përgjigje, u ngrit dhe mori në telefon të vëllain. Foli fare shkurt me të. U kthye në vendin e vet dhe pëshpëriti: Joeli kishte qenë. Pas formaliteteve në polici, e kishin lënë të lirë. Si ka mundësi, Joeli nuk merret me gjëra të tilla, tha sërisht. Ku e di ti, i tha i biri, që Joeli nuk merret me sherre droge? E di që ç'ke me të, iu përgjigj Piro. Anita nuk foli. Kështu këmbëngul gjithmonë ti për të tutë. E jo vetëm për ata. Flet pa ditur gjë, tha Fredi. Unë e njoh shumë mirë Joelin, ngriti zërin Piro. Ja, pra, që nuk e njohke fare, ia ktheu Fredi po me zë të lartë. Mos më fol mua ashtu, e kërcënoi i ati. Po çfarë të bëj kur ti flet kot, pa ditur asgjë se çfarë bën Joeli? Kështu flet gjithmonë...

Piro u ngrit në këmbë dhe bëri një hap drejt kolltukut ku ishte ulur i biri. Dukej që nuk po e kontrollonte veten. Ishte gati për një shpërthim edhe më të fortë. Iu duk se i biri e kishte kapur keq dhe po e vinte përpara. Po fyente jo vetëm të atin, por edhe fisin e tij. Prandaj i bërtiti sërisht: Rri aty e mos më fol mua në atë mënyrë. More vesh? Ki respekt! E ul apo e ngre zërin unë, nuk është puna jote. Jam në shtëpinë time dhe bëj atë që mendoj. Dhe mos harro. Unë të mora... Nuk më more për të më shpëtuar mua, ia ktheu Fredi. Më more për të shpëtuar veten. Jo për të më dhënë mua një shans më të mirë në jetë, por për t'i dhënë vetes një shans të ishe i barabartë me të tjerët.

Ishte e qartë se Piro nuk do të dorëzohej, por Fredi ishte edhe më i vendosur. Mendimi se për çfarë ulej aty për çdo ditë dhe ku po e shpinte situatën me të birin e bëri të ndryshonte tonin, por vetëm për një grimë kohe, sepse ashtu siç i erdhi ajo ide edhe iu zhduk. Pa lënë asnjë gjurmë brenda trurit të tij. Po e kapte tërbimi. Donte me çdo kusht ta mposhte të birin. Nuk mund ta pranonte humbjen, por po ndiente ndërkaq se po rrëshqiste poshtë, tepër poshtë. Nuk i kishte lënë vetes asnjë mundësi për t'u rikthyer në gjendje normale.

Çfarë borxhi të kemi ne që na bërtet këtu? Mohon çdo gjë, madje edhe atë që sapo u dha në TV, i tha Fredi. Gjithmonë i njëjti: acarues, mohues... Pse na provokon vazhdimisht? Fredi u ngrit ndërkaq në këmbë. Ishin ballë për ballë. Vetëm dy hapa larg. Ta thashë një herë, këtu bëj çfarë dua. Jam në shtëpinë time. Por ti po na shqetëson shumë ne të tjerëve. Prandaj më mirë mbylle gojën. Mos fol fare. Përndryshe, ja ku është dera. Mos më trego mua derën. Ta tregoj, që ç'ke me të. Dhe po ta them troç tani: Jashtë nga kjo shtëpi! Jashtë! Nuk ke më vend këtu, sepse nuk di çfarë flet e çfarë bën. Je bërë si i marrë. Jo vetëm me këtë që bëre sot, por përherë të njëjtën bën. Nuk na le një herë të qetë. Prandaj, jashtë... jashtë... tani... në këtë minutë... Mos më detyro të të kap me dorë... Provoje edhe atë, ia ktheu Piro. Më pas nuk mori vesh çfarë kishte ndodhur. E pa veten të shtrënguar midis krahëve të të birit, fare pranë derës së hapur. Qërohu që këtej, i bërtiti ai. Nuk ka më vend për ty këtu. Dera e hyrjes përballë u hap paksa. Pastaj një tjetër derë... dhe një tjetër...

Piro qëndronte në këmbë i shpërfytyruar, i zverdhur. Me gjunjët të prerë. I mbushur me djersë të ftohta. Sytë kureshtarë që përgjonin pas dyerve të katit të nëntë u tërhoqën. U dëgjuan disa kërcitje. Dyert u mbyllën njëra pas tjetrës.

Piro qëndronte ende në këmbë duke u dridhur. Kishte qenë vetëm një detaj i vogël, por i tillë që na kishte shtyrë në buzë të greminës, arriti të mendonte. Kuptoi se kishte prekur fundin, pikërisht atë fund që nuk do ta dëshironte kurrë, por tashmë ishte vonë, tepër vonë. Nuk dinte çfarë të bënte. Ta hidhte edhe hapin e fundit? Më duket se përmbysa vetë gjithçka me duart e mia. Deshi të thoshte, me fjalët e mia, por nuk ishte i sigurt për këtë. Ndoshta unë vetë prisha çdo gjë. Me veprimet e mosveprimet. Me fjalët dhe heshtjen. Ose me të gjitha bashkë. U pleksën keq me njëra-tjetrën dhe nuk munda t'i ndaloja? Ç'të ketë qenë kjo prirje? Nuk më duket se ka qenë ndonjë prirje për të shkatërruar vetveten? Përkundrazi. Me sa duket, fatin e kisha kundër dhe nuk munda as ta kuptoja as ta ndaloja atë që unë vetë, ime shoqe me heshtjen e saj vrasëse dhe agresiviteti i lindur i djalit gatuam të gjithë së bashku.

Ishte ende te dera, në këmbë. Ç'bëra

kështu? ulërinte së brendshmi. Ishte në mëdyshjen më të paqartë, në mëdyshjen më kritike të jetës. Ç'të bënte? Ta hidhte hapin e fundit e të dilte apo të luftonte deri në fund aty në këmbë, siç ishin të dy? Jo, jo. Këtë nuk do ta bëja kurrë. Nuk do ta ngrija kurrë dorën kundër djalit, sido që kishin ardhur punët. Nuk do ta bëja kurrë. Mua nuk më lejohet. Kurrresi. Të dorëzohem? Siç ishte dorëzuar shpesh, pa arritur t'u shkonte gjërave deri në fund? Çdo shteg tashmë i ishte mbyllur. Përveç njerit, atij që po ta kapërcente nuk do të mund të rikthehej më. Kërkoj me sy të shoqen, por kolltuku i saj ishte bosh. Si zakonisht, psherëtiu.

Piro e njihte veten. Madje, ishte ndër të rrallët njerëz që ia dinte jo vetëm vlerat, por edhe dobësitë. E dinte që kishte një shpirt delikat, që i shkonte aq mirë me pamjen e tij të përvuajtur. Ishte pikërisht kjo pamje që shpeshherë e bënte tërheqës e enigmatik për të tjerët. Ai e dinte gjithashtu që nuk ishte njeri i veprimit. Ishte tip i ndrojtur. Meditativ. I mbyllur aq shumë, sa jashtë shtëpisë askush nuk ia dinte fatin. Sikundër askush nuk dinte çfarë po hiqte shpirti i tij. Kuptoi se nuk ishte kohë për meditime. Të dy, atë e bir, ishin përballë njëri-tjetrit dhe ose njëri do të duhej të hapte rrugë ose... Nuk ka "ose" tjetër, e mbylli Piro.

Fredi priste kërcënueshëm në këmbë dhe nuk ia ndante sytë të atit. Ishte i tëri i tendosur. Si në një pozicion luftimi. Frynte e shfrynte tërë nervozizëm. Dukej që ishte i vendosur ta shpinte deri në fund atë që nuk e kishte nisur vetë. Ishte në pritje të reagimit të të atit. Më në fund, vuri re se i ati po thyhej, po ligështohet. Dukej që po e pranonte fatin e tij, sado i mbrapshtë të ishte. Vetë e kishte zgjedhur, mendoi Fredi i palëkundur. Vetë e kishte gatuar. Nuk priti më gjatë dhe iu përvesh sërish: Mos u vono më. Dil sa më shpejt, i tha, se po të shtyva unë nuk do të ngrihesh dot më. Nuk të duam më këtu. Siç nuk na do ti. Në këtë shtëpi nuk ka më vend për ty. Ik. Ik. Ke thënë se të pëlqen vetmia. Ja, ia arrite.

Piro nuk po e dëgjonte të birin. Nuk e kishte dëgjuar çfarë kishte thënë. Ndoshta ishte shurdhuar. Ndoshta...

Tonin e kishte të prerë, kurse në brendësi Fredi vlonte edhe më shumë. Po ndiente një lloj padurimi. Po ia behte revolta e tij e njohur, kur ai bëhej brenda një çasti tjetër njeri, i pamëshirshëm. Pasojë e një refuzimi ekstrem për atin, i cili kishte dashur të bëhej baba i mirë, por që nuk ia kishte arritur dot. Luaj nga vendi, i tha përsëri. Nuk ke ç'mendon.

Piro e kuptoi se kishte ngecur keq. Ishte i kryqëzuar. Mungonin vetëm gozhdët. Ishte tërësisht i mpirë, i lodhur. Duart e këmbët nuk i lëvizte dot. Nuk kishte më fuqi as të mendonte, as të vepronte, as të jetonte...

Nuk po mund të hidhte asnjë hap, as përpara as pas. Pas disa çastesh u përmend disi dhe pa nxjerrë zë u kthye e shkoi te portmantoja aty afër. Hapi një sirtar, mori diçka dhe u çapit drejt derës. Kokën e ndiente të rënduar. Plumb e rëndë, arriti të mendonte. Kishte një dhembje therëse brenda vetes, por nuk e dinte ku e kishte marrë goditjen, në kokë, në zemër apo kudo, në tërë trupin. Kuptoi se përfundimisht ishte i humbur. Shumëçka e çmuar brenda tij kishte vdekur, njëherë e përgjithmonë.

Tashmë, tha me vete, do të jem i detyruar të jetoj me një vdekje brenda vetes. Po i vinte keq për veten. Ndiente një dhembje të vërtetë njerëzore. Dhembje e pleksur me një dobësi therëse, që po e gjymtonte tërësisht. Sikur të mos më mjaftonte gjymtimi i lindur, mendoi. Na tani edhe gjykimin e fundit. Deshi të thoshte, gjymtimin e fundit. E ndjeu që ishte ngatërruar, por i ra shkurt: Gjykimi apo gjymtimi, njëlloj janë. Të fundit. Pas tyre nuk ka më asgjë. Përse ta dua më këtë jetë? i shkoi nëpër mend. Çfarë të bëj me të? Dhe sa shumë e kisha dashur? Sa shumë luftova për të. Gjithçka paskësh qenë më kot.

Fati i keq nuk e kishte zhgënjyer as këtë radhë. Ç'nuk kishte bërë ta ndalonte, ta shmangte. Ç'nuk kishte hequr t'i jepte tjetër drejtim, por kishte qenë e pamundur. Si çdo gjë që na vjen nga lart, mendoi ndërsa tërhiqte këmbët zvarrë.

Doli në pushimin e katit dhe pa i hedhur sytë nga ashensori, nisi të zbriste shkallët. Nëntë kate. Nëntë rrathë për të zbritur, nga një kat tek tjetri. Ku po zbres kështu? pyeti veten i pikëlluar. Çfarë mëkatari paskam qenë. A

quhet mëkat ai me të cilin njeriu lind? Në cilin rreth do të ndaloj? Ku më është caktuar vendi? Përse nuk po më hapet ndonjë portë. Po shoh se paska shumë të tilla. Cila është porta ime? Ndjeu se po fliste përçarë. Iu morën këmbët dhe gati sa nuk u rrëzua.

Vazhdonte të zbriste duke i hequr këmbët zvarrë. Nuk kishte asnjë ide për ku ishte nisur. Mbase drejt askundit. Drejt asgjësë. Vërtet ngadalë, por këmbët po e çonin pikërisht atje. Ecte kuturu midis errësirës së shkallëve. Poshtë e më poshtë. Ndërsa rrotullohej e zbriste, ndjeu se jo vetëm këmbët, por edhe mendja po i vinte rrotull. I dukej sikur nga njëri çast në tjetrin do të rrëzohej fare poshtë, në ndonjë hon të errët.

Në shpirt po mbartte peshën e mundimshme të HUMBJES. Dështimin e tij! Po, fundja, jeta ime ka qenë e mbushur me pësime, tha sërish. E kam pranuar tashmë idenë e të pësuarit.

Iu duk se trupi i ishte bërë sa një grusht. Mbase duke zbritur poshtë e më poshtë trupi vetvetiu zvogëlohej, mendoi. Një njeri gati-gati pa peshë. Pendë i lehtë. Trupi pa peshë, shpirti plumb i rëndë, arriti të mendonte me vështirësi. Po ç'është atëherë ajo barrë që ndiej mbi shpinë? Ngadalësoi paksa hapat për të menduar. Ndoshta është pesha e mëkatit që kam bërë në jetën reale, kur vendosa të birësoja... Por jo, ajo gjë nuk më duket të ishte mëkat. U bë më pas? Ndoshta. Ndoshta është diçka tjetër, të cilën unë nuk e gjej dot. Në atë tjetrën, irealen, përkundrazi, më ishte bërë një faj që në zanafillë. Një mëkat që ishte pasuar nga mëkate të tjera. Të gjitha kundër meje.

Më në fund, kuptoi se kishte dalë në trotuar. Përpëliti qepallat nga drita e fortë e neoneve, që ndërkaq ishin ndezur.

Falë Zotit paskam shpëtuar, mendoi. Qenkam ende gjallë. Mbaruan tërë ato rrathë, nga një kat në tjetrin, poshtë e më poshtë, drejt humnerës së jetës sime... Asnjë derë nuk ishte hapur për atë. Kushedi pse, mendoi.

Në dorën që shtrëngonte çelësat e shtëpisë së vjetër ndjeu dhembje. Një psherëtimë e zgjatur i doli nga shpirti. E kuptoi se ishte psherëtimë e humbjes përfundimtare. Psherëtimë e humbjes së pakthyeshme.

“PSHERËTIMA E HUMBJES”, NJË ROMAN QË MERITON VËMENDJE

Nga Fitim Zekthi

Romani “Psherëtimë e humbjes”, me autor Bujar Skëndo, është një elegji për familjen, një dhimbje e thellë për mungesën e dashurisë dhe një brengë për vetminë e emigracionit, por dhe të braktisjes nga njerëzit më të dashur kur je brenda atdheut tënd.

I shkruar me një stil elegant dhe gjuhë të pasur, romani mbart në vetvete një tension të brendshëm, që vjen si pasojë e mungesës së lumturisë dhe të dashurisë. Njeriu e përjeton vetminë dhe braktisjen në mënyrë të thellë dhe brengosëse.

“Psherëtimë e humbjes” përqendrohet në dy linja rrëfimi, të cilat ndërthuren me njëra-tjetrën nga fati i njëjtë i protagonistëve në raport me fëmijët e tyre, ashtu sikurse shërbejnë si një mozaik që jep idenë e së plotës në ndërthurjen e elementeve përbashkues.

Familja e parë përjeton dramën e ndarjes së menjëhershme nga djali i saj. E emigruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në fillim të viteve '90-të për një jetë më të mirë, papritur Mondit, djali i i vetëm i saj, ndërpret në mënyrë të rufeshme kontaktet me prindërit, Adrianin dhe Verën, të cilët, jo vetëm kërkojnë të gjejnë motivet e kësaj heshtjeje të të birit në raport me ta, por, mbi të gjitha, ata thyen shpirtërisht.

Është brenga e prindërit për fëmijën. Është një temë sa aktuale aq edhe universale, sa njerëzore aq edhe shqetësuese në kohën e sotme. Duket sikur tipizohet personazhi për të përgjithësuar fatin, dramën, dhimbjen,

brengën. Të gjithë gjejnë nga pak copëza nga vetja. Është portretizimi i krizës së rëndë shpirtërore që po kalon familja në modernitet, nga i cili nuk po mundet të marrë më të mirën, por po bjerr përditë dhe më shumë vlerat dhe virtytet, duke e lënë qenien të zbrazët.

Mjeshtëria artistike e shkrimtarit Skëndo në këtë roman është zhbirimi psikologjik i karaktereve të personazheve nëpërmjet një vështrimi të thellësishtëm dhe nëpërmjet vetëzbulimit të brendshëm të tyre, që nxjerr në sipërfaqe frikërat, mëdyshjet, dilemat, skutat më të fshehta të botës së brendshme shpirtërore.

Linja e dytë e rrëfimit përqendrohet në Tiranë. Është një dramë e tjetërllotjë e një familjeje shqiptare, së cilës, në dallim nga e para që e përjeton në emigrim, i ndodhë në vendin e saj. Është brenga e mungesës së një fëmije, jo si pasojë e braktisjes së tij, por si rezultat i mospasjes mundësi për të bërë një të tillë. Piro, protagonist i kësaj linje rrëfimi, ndahet nga martesa e parë me mirëkuptim pasi e merr vesh që është steril, ndërsa nga martesa e dytë e kupton që jeta në çift është e bukur, mirëpo mospasja e një fëmije e shndërron atë në monotone dhe nuk i jep mundësinë për të gëzuar normalisht si gjithë të tjerët.

Edhe në këtë linjë rrëfimi duket se kemi të njëjtën metodologji të vetëzbulimit të thellësisë së qenies, duke u futur në skutat më të thella të saj. Vjen një moment kur personazhi dorëzohet dhe pyet: “Pse më ndodhi mua?” Duket i pafuqishëm për t'i dhënë përgjigje pyetjeve që ngre.

Së bashku me të shoqen zgjedhin të birësojnë një fëmijë. Një zgjidhje në dukje e mirë dhe sikur jep rezultatet e para. Harrojnë gjithçka dhe lumturohen pas tij, mirëpo kjo lumturi nuk u zgjat shumë. Të dhënë pas fëmijës, harrojnë vetveten. Bien në monotoni dhe si të gjithë monotonitë përjetojnë ftohjen dhe vetminë, pavarësisht se në dukje arrijnë atë që donin, pasjen e një fëmije. Jo vetëm kaq, por, me rritjen e fëmijës, ai zbulon të vërtetën dhe fillon urrejtja dhe poshtërimi për prindërit që e kanë birësuar. Rifillon vuajtja dhe brenga e Fredit dhe Anitës, të cilët janë të pafuqishëm të ringrihen dhe ta tejkalojnë fatkeqësinë e tyre.

Romani fillon me fjalinë “*Sapo u afra, por ende pa më përshëndetur, Adrian Kota, sikur të nxirrte psherëtimën e fundit, më tha: E humba djalin!*” dhe mbyllet me fjalinë: “*Në dorën që shtrëngonte çelësat e shtëpisë së vjetër, ndieu dhimbje... Një psherëtimë e zgjatur i doli nga shpirti. E kuptoi se ishte psherëtimë e humbjes përfundimtare. Psherëtimë e humbjes së pakthyeshme.*”

Ndonëse fjalja e nisjes së romanit i referohet personazhit të parë dhe fjalja e dytë personazhit tjetër, të dy këto i bashkon fjala çelës “*psherëtimë*”, e cila është reflektuar edhe në titullin e romanit.

Psherëtimë është procesi i marrjes dhe i nxjerrjes së frymës thellë, zakonisht kur njeriu është i brengosur apo i mërziur, kur i kujtohet me mall diçka apo dikush dhe kur do të çlirohet nga ai ankth.

Psherëtimë e personazheve të romanit të Bujar Skëndos është reflektim i brengës dhe i çlirimit prej saj i sa e sa njerëzve, të cilët nuk kanë mundësi për ta përcjellë një gjë të tillë artistikisht, ndërsa autori i romanit ka arritur ta letrarizojë dhe të bëhet zëdhënës i përcimit të shumë brengave tek lexuesi.

Romani i shkrimtarit Bujar Skëndo i ka të gjitha karakteristikat e një romanit psikologjik dhe si i tillë meriton vëmendjen dhe vlerësimin e lexuesit shqiptar, për shkak të tematikës dhe risisë që sjell në trajtimin e veçantë të saj.

BUJAR SKËENDO

Psherëtimë e humbjes



OnufriRoman

Falënderim për dhuratën e çmuar librin. Citate kontekstuale apriori nga një vepër me kujtime që korrespondojnë saktësisht me rrëfimet.

“Të shkruarit rreth vdekjes së njerëzve të dashur duhet të jetë i vjetër sa edhe vetë shkrimi, megjithatë, ngasja për ta bërë këtë më krijon një lëmsh në fytyrë.”

(Rodrigo Garcia “Lamtumirë Gabo dhe Mercedes”, botimi shqip, faqe 25).

Polemika është e vjetër për nga lashtësia, sa që mund të këtë prek mitologjinë. Përmasa dhe më shkas janë krijuar vepra artistike që i kanë rezistuar harresës, duke lënë gjurmë në çdo sistem e periudhë jo vetëm filozofike por edhe letrare. Kryengritja e krijesit modern në shoqërinë mesikane të parasë dhe krizës së leximit e botimit të librit ka rënie ngritjet e saja që herë-herë vijnë e bëhen të pakundërshtueshme, njëherazi edhe të domosdoshme. Utilitarizëm në vete që zgjon një rinjohje për miqtë e “anës tjetër” të protagonistit.

Në studimin “Letërsia dhe artet në krizën e kohës sonë” shkrimtari Ernesto Sabato që në vitet 50-ta të shekullit XX shkruan se “*lakuriqësia, ashtu si vdekja, është demokratike*”. Përherë kam besuar se ka miq të mirë dhe miq të këqij. Prandaj është e vështirë në kohën e sotme të Facebook-ut të shkruhet për “artin e krizës” dhe rëndësinë e polemikës mes miqsh “të vjetër” në të cilën përmbajtje kategoria e kohës është një sfidë pa fitues. Prandaj këto ditë në vend të polemikës, të reagimit zgjodha rileximin e veprës me kujtime te Rodrigo Garcias “Lamtumirë Gabo e Mercedes”.

Në lexuesit me faje bëjmë gabime nëse kyçemi në aktin e njohjes së tyre, sepse ata kanë ingranazhet e arsyes dhe “dobësimi” të tjetrit. Njëri nga ata e meriton ndëshkimin sepse tashmë i është humbur virgjiniteti i miqësisë.

Në shtator të vitit 2021 më është dhuruar nga botuesi libri “Lamtumirë Gabo dhe Mercedes”, libër me kujtime të të birit te Márquez-it Rodrigo Garcia, të përkthyer nga shqip nga origjinali në anglisht nga Engjëllushe Shqarri, botuar nga “Onufri”.

Dylibra “Ditari i zisë” m’i dhuroj botuesi Abdullah Zeneli. Vepra e Roland Barthes kishte një të veçantë në vete, apriori në rilexim dhe para leximit të parë të veprës së Rodrigo Garcia. E lexova fill pasi më vdiq Shkurta, Nëna ime, të cilës përherë i kam thënë në emër. Sa herë e kujtoj sot derdh lot! Për babain që kam kujtime më të thella nuk e derdh lotin e përhershëm sepse më mungon dhe kujtoj sidomos periudhën në vitet e 90-ta çdo mëngjes barte dru me krah nga mali i largët në shtëpi. Ishte dru i rëndë që kur e provoja në oborr të shtëpisë nuk e mbaja në krah as edhe një minutë!

Siç thotë kritiku i letërsisë Boyd Tonkin autori Rodrigo Garcia ka shkruar “*një kujtim të hollë...*”, në detaje për fundin. Katër pjesët e para kanë të bëjnë me vdekjen dhe kujtimet te Gabos derisa pjesa e pestë jeta dhe vdekja e Mercedes.

“... shekulli XX do të përfundonte.” (13)

Jemi gjenerata që përjetuam kapërcimin e shekujve nga njëri tek tjetri. Gjashtë muaj pas lufte do e shkruaja tregimin “*Njollat e hirit pas shiut të akullit*”. Gjashtë muaj që ishim kthyer në shtëpitë gjëmadha të djegura nga forcat militare serbe.

Në fillim në kapitullin e parë Rodrigo Garcia do të shkruaj për bisedat me babain. Më të dëgjuar Márquez citon që shkrimtari “*nuk e mban dot më arkitekturën e pamasë, ose nuk orientohet dot në terrenin e pabesë të një romani të gjatë*.” (14) Një imazh i hapësirës së romanit. “Likuidime” të zhanrit e teorizime të thukëta.

“Dua të shkoj në shtëpi.” (28)

Sikur ka të bëjë me shtëpinë e përjetshme.

Kapitulli i 9 i pjesës së parë na tregon për

Rodrigo Garcias “Lamtumirë Gabo e Mercedes” DASHURI, VDEKJE E KUJTIME NË KOHË PANDEMIE

Nga Enver S. Morina

veprën me kujtime të Márquez-it. Pse ai nuk shkroi më tej.

Kapitulli i 10 i veprës së parë i tëri si citat. Fama dhe suksesi letrar. Gjashtë shkrimtarët që nuk iu dha çmimi Nobel (Tolstoi, Proust-i, Borges-i, Virginia Woolf, Juan Rulfo dhe Graham Greene)?! Leximi. Të metat e veprës. Shterimi i krijimtarisë. “*Pavarësisht nga natyra e shoqërueshme dhe rehatia në dukje që i jepte jeta publike, babai ishte njeri privat, ndonjëherë edhe i mbyllur. Me këtë nuk dua të them se nuk i pëlqente fama apo se pas dekadash të tëra lajkatimesh nuk ishte prekur nga narcizmi, por, gjithsesi, përherë dyshonte në të qenët i famshëm dhe në suksesin letrar. Gjatë viteve na kujtonte herë pas here neve (dhe vetes) se as Tolstoi, as Proust-i apo Borges-i nuk arritën të merrnin çmimin Nobel, sikundër edhe tre shkrimtarët e tij të parapëlqyer, Virginia Woolf, Juan Rulfo dhe Graham Greene. Shpesh i dukej se suksesi i tij nuk ishte diçka që e kish arritur vetë, por diçka që i kishte ndodhur. Nuk i rilexonte kurrë librat e vet (ndonëse shumë më vonë në jetë, kur kujtesa po e linte, filloi t’i lexonte), nga frika se mos gjente të meta që do*

ta bënë t’i vinte turp dhe se mos ia shternin krijimtarinë.” (43)

Të gjithë në pikën e përbashkët të kujtesës së rileximit “për herë të parë” nga këndi i periferisë, goftë i formimit tim të vonshëm, goftë në hapësirat e jetës.

Jorge Luis Borges dhe Gabriel Garcia Márquez në afërsi njëri e tjetri preku moshën 87 vjeçare! Njëri mori çmimin Nobel. Të dhënat thonë që laureati më i ri ishte Rudyard Kipling, i cili ishte 41 vjeç kur u shpërblye në vitin 1907 dhe laureatja më e vjetër që mori çmimin ishte Doris Lessing, e cila ishte 88 vjeç kur u shpërblye në 2007. Njëqind vjet statistika!? Vuajtjet e lexuesit dhe disa shkrimtarëve që nuk e morën çmimin Nobel janë të përhershme.

“... koïncidencë e zymtë...” (45)

Zymtësia e një çasti të përputhshëm e gërshetues vë në analizë koïncidencën si krahasim, si befasi dhe si reagim.

“Asnjë regjisor, shkrimtar, poet – asnjë pikur apo këngë – nuk ka pasur ndonjë ndikim të madh tek unë krahasuar me prindërit, vëllain, gruan dhe vajzat e mia. Tekfundit, shumica e gjërave që duhen ditur,

mësohen në familje.” (46)

Interesimet dhe veprimtaritë e krijesit janë nga më të ndryshme. Mbi të gjitha është familja ajo që përcakton dhe ndikon në formimin krijes dhe artistik.

Kapitulli i 13 (i fundit i pjesës së parë) rrëfen përgatitjen e lajmit të vdekjes.

“Jeta, e vjetër po aq sa dhe e jetuar pafundësisht herë, fatmirësisht vazhdon të jetë e paparashikueshme. Kur vdekja të vjen rrotull, rrallë ndodh të të zhgënjëjë.” (56)

Fundi i kapitullit të 16 dhe kapitulli i 17 i pjesës së dytë rrëfen me më gjerësi e thellësi vetitë e virtytet, dëshirat dhe përkushtimet e Márquez.

“Mendonte se disiplina e fortë ishte një nga gurët themeltarë të shkrimit të një romani, sidomos kur vinte puna të formësimi dhe vendosje e kufijve të historisë. Ai nuk pajtohej me mendimin e atyre që thoshin se krahasuar me shkrimin e skenarëve apo tregimeve të shkurtra, të shkruarit e romaneve ishte një formë më e lirë dhe rrjedhimisht, më e lehtë krijimtarie. Ishte e domosdoshme, argumentonte ai, që shkrimtari të krijonte udhërrëfyesin e vet, me qëllim që të përshkonte “terrenin e rrezikshëm të romanit”, sikundër e quante at.” (64)

*“Kur po shkruante **Dashuria në kohërat e kolerës**, i vuri vetes për qëllim të dëgjonte këngë popullore spanjolle mbi dashurinë e humbur apo të paplotësuar. Më thoshte se romani nuk do t’u afrohej këtyre këngëve për nga natyra melodramatike, por se mund të mësonte prej tyre për teknikat me të cilat ato evokonin ndjenjat.”* (67)

Kapitulli i 18 mund të titullohet “Fati i zotit të ngordhur” a “Varreza e kafshëve të shtëpisë dhe shpëzët”. Debate e ngordhjes së shpendit e qenit dhe fatmirësia në fatkeqësi.

Kapitujt 19, 20 e 21, të fundit e pjesës së dytë dramatike në vete, “të mugëta” siç thotë autori. Vdekja e shkrimtarit.

Gjashtë kapitujt e pjesës së tretë (22-27) tregojnë gjendjen nga fryma e fundit e Ëzrit deri tek futja e kufomës, trupit të Márquez-it në dhomën e djegies.

Në katër kapitujt e pjesës së katërt (28-31) e pamja e babait.

“E kap veten duke kujtuar se si babai thoshte përherë se çdo njeri ka tri jetë: publike, private dhe të fshehtë.” (114)

Rrëfimi në vete dhe mesazhi i babait.

“... në kokë më rri vazhdimisht ideja se ndoshta nuk i njoha sa duhet dhe pa dyshim më vjen keq që nuk i pyeta më shumë për hollësi të jetës së tyre, për mendimet më të fshehta, për shpresat më të mira dhe për gjërat që i frikësonin.” (136)

Pjesa e pestë e fundit ka vetëm një kapitull. Jeta dhe vdekja e nënës. Të dhëna për dorëshkrimet e papërfunduara, fati i tyre dhe i koleksionit.

Te pesë pjesët fillojnë me nga një citat nga vepra e Márquez. Dy citate nga “Njëqind vjet vetmi” dhe nga një nga “Gjenerali në labirintin e tij”, “Vjeshta e patriarkut” dhe “Dashuria në kohën e kolerës”.

Miopia obsesive ndaj përfitimit ka një fund që gjykohet pa mund të marr dënimin e merituar. Lexuesi i takon të ardhmes, krijuesi të kaluarës ndërsa rileximi ndodh në çastin e kohërealës bashkëkohore në të cilën periudhë kërkohet përcaktimi si veçim.

Márquez-i jetën e zgjati pafundësisht përmes jo vetëm *Njëqind vjet vetmi* derisa i biri Rodrigo i shkroi promemorien post mortum që lexuesi të di se për Gabon e Mercedes vdekja nuk është fjala e fundit e jetës.

“... kohëzgjatja e zhveshjes e shndërron publikun në përgjues”, shkruan Roland Barthes. Mbylleni zhveshjen dhe rikujtone bashkëpunimin në interes të njëri-tjetrit, në dobi të lexuesit dhe për të mirën e letërsisë!

Lamtumirë deri në rileximin e radhës!

6 dhjetor 2022, Prishtinë



1.
Drita, kudo drita, nëpër skuta, nëpër lugje, veshtullore dhe e bardhë, e squllët, e thatë, një masë e pamasë, një trajtë e patrajtë, e flurtë, e paprekshme, tejshkuese, drita që ende nuk i thuhej dritë, që nuk i thuhej asgjë dhe që nuk perceptohej aq sa të dëftehej me gisht, as më sy, as me turinj të zgjatur drejt saj, sepse gjendej kudo por kudoi krejt pa emërtim. Drita që zbrazte farën në zgavra, në të çara toke, në gëzofe kafshësh, në gonxhe e sytha, diku në hala rrënjësh të dala. Drita që ish mbarsur si këpushë pas Evës, pas sqetullave të saj, pas seksit të saj dhe as seksi dhe as sqetullat s’do kishin emër më pas nëse drita do të mbeste përgjithnjë aty nga ku vetë ajo nuk dëshironte të ikte. Po kjo dritë që gjendej edhe tek Adami, te mjekra e tij e gjatë, e bukur, si një melankoli e kreshpëruar e ngjyer në argjend, që posa ta shihje nuk të shqitej prej mendjes, që po ta shihje do të të ngatërrohej imazhi i saj kur sytë të ndeshnin gëmushat, drizat e ferrat, barërat e egra të zgjuar prej gjumit plot rrodhe e pleshta, një mjekër, i vetmi vend në të gjithë Edenin ku drita nuk gjente rehati, ku nuk pushonte dot e qetë, si një shtazë fushe që nuk i tereziten dot brinjën nëpër shkëmbe, nëpër gropa, dhe ndaj në çdo agshol të ri kjo dritë, po e njëjta si tek Eva, mezi shmpihej, e gjente veten të plakur, tek i dhembnin kryqet e veta prej drite, tek i kërcisnin eshtrat e mëndafshta, e prapsëprapë nuk ankohej, pasi ajo mjekër ishte kaq e domosdoshme. Po kjo dritë gjendej përreth seksit të tij, së paku përpara se të kuptohej se ai gjendej aty, i fshehur, i gllabëruar, i lënë në një harresë pamore që ia kish zhbërë instiktet shtazore. E ndërsa tek Eva po kjo dritë i qe qepur si gëmushë pas sqetullave, në një etje të egër në dukje, të ngulmët si të një fëmije, sqetullat e Adamit ishin kaq të pastra, të qëruara prej dritës po aq sa edhe prej qimeve, si dy lugje prej kah kundërmonte një aromë barishtesh e myshqesh. Pse vallë?, pse sqetullave të tij i mungonte drita?, a quheshin sqetulla pasi nuk kish dritë në to?, apo mbase bash mungesa e saj i bënte të emërtoheshin vërtet si sqetulla?, ku ishte drita?, nga ia kish mbathur ajo dhe pse nuk tregohej po aq e drejtë dhe e barabartë me këtë burrë të pashëm? Po kësaj gruaje, si nuk i bënte përshtypje ajo mungesë drite në sqetullat e burrit që kish pranë?, apo mos vallë nuk e shquante dot?, a mos vallë nuk shquante as praninë e dritës te vetja? E si mundej ta bënte dallimin nëse për atë, në dukje, sqetullat e atij, po aq sa edhe të sajat, ishin të njësojta? A ishin përnjëmend të njësojta ato?, a kishin një gjini sqetullat, sa edhe ata të dy vetë? Sigurisht që as Adami më një anë dhe as Eva më anë tjetër



RIGEL RIZAJ

LAKURIQËSIA

Nga romani në proces

nuk e shquanin dritën, po aq sa edhe mosdritën. Madje vështirë se mund ta kuptonin kësisoj gjininë e vetes, gjininë e tjetrit, përtej dhe brenda atij lëmshi të dendur drite. Të gjitha këto valë mendimesh ia rrezonin rruzullin e kokës Karlit ndërsa qëndronte pushuar krah Artës, – pas dashurisë, së gjatë, të pafjalë, plot grahma e marramendje, – ndërsa dorën e mbante pushuar mbi njërin gji të saj, duke e ledhatuar herë-herë thithkën e kuqur. Ku ndryshonin ata të dy kur ishin lakuriq?, po kur nuk ishin?, cili ish ndryshimi më i thellë, i pari apo i dyti?

2.
Breshka e pa, ndërsa ecte, edhe pse qenë bërë ditë e muaj e vite e shekuj që e kish vënë re se ajo krijesë ishte krejt e ndryshme prej saj, madje qesharake, krejt qesharake. Pa bisht, pa zhguall. Me dy krye dhe vetëm prej lëkure si të qullët, si tejet të lëmuar. Një top vigan, një rrumbull që s’mundej ta kuptonte, ndaj edhe i shmangej, i ikte tutje siç i iket një kërcënimi. Breshka s’dihej sa kohë kishte që endej nëpër lëndinat e tokës, nëpër shkëmbinjtë ku i pëlqente të strukej e të rrokullisej jo pa rrezik. Zhgualli i saj ishte i fortë dhe s’kish asgjë që mund ta thyente, ta çante, ta kriste, ta shkërmoqte. Breshka nuk e njihte frikën. Breshka nuk njihte asnjë qenie tjetër veç vetes së saj. Ajo njihte vetëm dheun, gurët, drurët, ujërat,

retë dhe qiellin. Veçse tani, përballë kësaj krijese të re, filloi të druhej, ende pa e kuptuar se gjendej në zgrip të frikës. Krijesa lëshonte zëra, dhe breshka s’mund t’ua tirrte kuptimin. Krijesa ecte mbi disa këmbë, dhe breshkës i dukej megjithatë sikur ajo rrotullohej e rrotullohej e rrotullohej. Aq e rrumbullt ishte krijesa, aq qesharake vazhdonte të mbeste ditë pas dite. Edhe pse i druhej, edhe pse ruante njëfarë largësie ndaj saj, breshka ndjente se s’mund t’i ikte plotësisht, s’mund t’i largohej dhe as që dëshironte t’i shmangej. Ngado që ajo shkonte, kjo e ndiqte nga pas, në fshehtësi, me ngadalësinë e saj morfologjike, me lëvizje dhe me gjestë të pakta, si dhe me mendime që i rrihnin në krye e që i dukeshin si të mbështjella me urtësi. Sapo ia behnin shenjat e para të perëndimit, krijesa gatitej të ndiqte një zakon që nuk e ndryshonte kurrë, që nuk e harronte kurrë, pa të cilin sikur s’mund ta mbyllte jetën e saj qesharake e të çuditshme. Ulej diku, mbi një gur a mbi dru, a thjesht përtokë, dhe, kur perëndimi shpalohej në horizont si një krifë e portokalltë, krijesa e shihte dhe e shihte, me të dyja kokët, me të katër sytë, duke psherëtirë me të dyja gojët e me të dyja flegurat e secilës hundë, duke kapsallitur të katërta qepallat, dhe mallëngjehej e mallëngjehej e mallëngjehej, përqafohej me veten, duar e krahë që zgjateshin e lakoheshin

nëpër rrumbullsinë e trupit të vet. Më qesharake se kaq, e çmund të hasej për sytë e një breshke? Krijesa ngashërehej me perëndimin, njëra gojë diçka i thoshte tjetrës, njëra gojë herë ngjishej pas tjetrës si grabitqare, por asgjë nuk ndodhte pasi pas disa çastesh gojët shkëputeshin dhe mbesnin aty ku mbesin gojët, aty ku breshka besonte se e kanë vendin të gjitha gojët e të gjitha krijesave që mund të gjallonin pas shfaqjes së kësaj krijese. Asnjërës prej gojëve nuk u mungonte ndonjë pjesë, të dyja ishin të plota, madje dukej se ishin më të plota pasi i qenë ngjeshur njëra-tjetrës, pasi ishin ngjyer me bojën e njëra-tjetrës, pasi kishin kryer atë veprim pa kurrfarë kuptimi për breshkën. Krijesa rrinte gjatë dhe e ndiqte lakoren e diellit në perëndim, ashtu siç ndiqte breshka plot kureshtje një shteg të ri pas çdo shtegu të mëparmë. Krijesa ndiqte shtigjet e tejqyrta të diellit, shtigjet e pambarimta që kurrë nuk mund të ishin të njëlløjta, shtigjet, shtigjet, shtigjet ku shkundtte ngjyrën e vet një bisht i ngopur me pluhur të portokalltë. Të kundruarit e perëndimit tashmë qe si një kolerë që i qe ngjitur nga pas edhe breshkës, një kolerë që sikur qe lëngur dhe e kish mbështjellë me veshtullinë e saj rrashtën e breshkës, atë rrashtë që as ditët javët muajt vitet dekadat e shekujt nuk kishin mundur ta depërtonin dhe breshka ndjente një shqetësim, po aq sa edhe drojë, po aq sa edhe peshtjëllim e ngazmend tek kundronte krijesën që kundronte perëndimin, tek kundronte perëndimin nëpërmjet krijesës por pa guxuar ta kundronte vet drejtpërsëdrejti. Dhe në një prej këtyre perëndimeve, pas shumë syresh, një vetëtimë çan qiellin sikur t’ëish sulur bash në pikën më të brishtë të tij, – tek seksi, – dhe e godet krijesën me një tërbim të llahtarshëm nxehtësie dhe drite. Breshka, e tronditur dhe frikamashe siç është, fut kokën brenda në zhguall dhe mbyll fort qepallat duke ndjerë lëkurën e qafës t’i paloset pas mjekrës.

Të nesërmen breshka qau. Qau me dënese dhe dhimbjen e ndjente në të gjithë zhguallin e fortë. Krijesa, ajo topolakja, ajo qesharakja, ajo butakja, ajo e pazbërthyeshma, ajo e domosdoshmja për sytë e saj të kaftë, nuk qe më topolake, butake, qesharake, edhe pse i mbartte ende sensin i së pazbërthyeshmes: tashmë dyfish. Krijesa qe e dyfishuar. E kish humbur qesharaken, rrumbullsinë e mëprshme. Tashmë krijesa qe dy krijesa, dhe secila krijesa me një kokë, një gojë, dy duar e dy këmbë. Gjithë sa kish mbetur nga ajo vetëtimë që i kish çarë më dysh ishin disa gjurmë drite, të lëna si njollat që lë sëmundja në disa zona mishi në trajta dhe porcione jo të barabarta.

Kam jetuar për ca kohë në Kopenhagen, duke Ku përpjekur të mësoj gjuhën daneze, dhe pikërisht atëherë zbulova shkrimtarin norvegjez Knut Hamsun, karriera e të cilit ishte një nga më të çuditshmet e shekullit të kaluar. Hamsuni nuk është aq i njohur në Amerikë, ndoshta mallkimi i një gjuhe të vogël, por ndikimi i tij sigurisht ndihet; Isaac Bashevis Singeri ka pohuar se “e gjithë shkolla moderne e letërsisë artistike në shekullin e njëzetë buron nga Hamsuni, ashtu si letërsia ruse në shekullin e nëntëmbëdhjetë “doli nga fraku i Gogolit”. Megjithatë, në Skandinavi, Hamsuni nënkuptonte telashe. Gjatë atyre muajve në Kopenhagen, hyja herë pas here në një nga libraritë e vjetra që mund të gjendeshin në të gjithë lagjen latine të qytetit. Sa herë kur pyesja për veprat e Hamsunit, njeriu pas banakut (ishte gjithmonë një burrë) tundte kokën dhe deklaronte: “Ai ishte tradhtar!” U përpoqa të mbaja mend dyqanin që të mos ndihesha sërish në siklet.

Sigurisht, e dija se për çfarë bëhej fjalë. Gjatë pushtimit gjerman të Norvegjisë në Luftën e Dytë Botërore, Hamsuni kishte qenë bashkëpunëtor; takoi Gëbelsin dhe Hitlerin dhe kishte qenë i papenduar deri në fund. Ishte befasuese: si ishte e mundur që njeriu që shkroi “Uria”, “Misteret” dhe “Pan”, libra jashtëzakonisht origjinalë, të kishte pasur simpati për nazistët? Hamsuni kishte fituar çmimin Nobel në vitin 1920 dhe, ndryshe nga simpatizantët e tjerë të fashizmit, si Céline dhe Pound, ai kishte pasur një ndikim të madh kontrollues dhe të qëndrueshëm ndaj publikut, atë të një magjistari. Singe-i pranoi se ishte “hipnotizuar” prej tij; Hese e quajti shkrimtarin e parapëlqyer; Heminguej ia rekomandoi romanet e tij Skot Fitzxheraldit; Ande Zhid e krahasoi me Dostojevskin, por besonte se Hamsuni ishte “ndoshta edhe më i mprehtë”. Lista e atyre që e donin zërin e tij dinak dhe anarkik është e gjatë.

Vendet skandinave, në më pak se një shekull, krijuan një letërsi të jashtëzakonshme; një listë e shkurtër përfshin Andersen, Kierkegaard, Jens Peter Jacobsen, August Strindberg, Henrik Ibsenin dhe Sigrid Undset. Megjithatë, asnjëri prej tyre nuk ishte aq magjepsës sa Hamsuni, veprat e të cilit përfshijnë njëzet romane, gjashtë drama, dy vëllime me poezi dhe tri përmbledhje tregimesh. Më bindës janë romanet e hershme, dhe, në veçanti, “Uria”, një lloj “Ruga e Re Grub” e George Gissing, halucinante, përvëlak, gjysmë çmenduri dhe argëtues.

Një shenjë paralajmëruese e këtij romani u duk në vitin 1888, kur një nga katër pjesët e tij u botua në një revistë letrare daneze jetëshkurtër të quajtur *Ny Jord* (“Tokë e re”). Autori e nënshkroi si “Anonim”, por bashkësia e vogël letrare daneze-norvegjeze e mësoi shpejt emrin e tij. Hamsuni, pa mbushur ende të tridhjetat, u bë befas një njeri për t’u marrë parasysh, dhe aq më tepër kur një vit më vonë, ai botoi librin e parë, “Nga jeta kulturore e Amerikës moderne”, një sulm i vrazhdë, zbavitës dhe herë pas here i marrë ndaj Botës së Re, të cilin kritik u Georg Brandes (përkrahës i hershëm i Niçes) e vlerësoi shumë. Kur u botua “Uria”, në vitin 1890, Hamsuni informoi recensentët se po provonte diçka ndryshe; nuk ishte, këmbënguli ai, i interesuar për martesat dhe topat, libri nuk ishte në të vërtetë roman. Përkundrazi, siç i tha një shoku: “Ajo që më intereson janë emocionet e pafundme të shpirtit tim të vogël, jeta e veçantë, e çuditshme e mendjes, misteret e nervave në një trup të uritur”.

Rrëfimtari i Hamsunit, shkrimtar, është një katalogues i kujdesshëm i gjendjeve të tij psikologjike, nuk është viktimit e tyre, por, si vetë Hamsuni, një zë i brezit të vet kundër sistemit. Nuk ka shumë ngjarje, por që nga rreshti i parë: “Pikërisht kur po ecja i uritur në Kristiania, nëpër atë qytet të çuditshëm prej të cilit askush s’mund të ikë pa u shenjuar prej tij” - dëshpërimi i çuditshëm, i gëzueshëm i romanit nuk të shqitet kurrë. Shkrimtarët e varfër, ambicioz të pavarur në qytetet perëndimore mund të mos jenë më të uritur, por sigurisht ata vuajnë të njëjtat poshtërime si rrëfimtari i Hamsunit: botuesit i paguajnë shumë pak, i bëjnë të presin pafundësisht për një përgjigje dhe janë indiferentë ndaj dhuntive të tyre të fuqishme të dhëna nga Zoti. Më shumë se një herë, heroi i uritur i Hamsunit zbulon se “gjendja e tij nervore kishte dalë jashtë kontrollit”, si në rastin kur, në një çast, ai nuk është në gjendje të flegjë: “*Papritmas kërcas gishtat disa herë dhe qesh. Çfarë drejtin ishte kjo! Ha! Mendova se kisha gjetur një fjalë të re. Ulem në shtrat dhe them: Nuk gjendet në gjuhë, e kam shpikur unë - Kuboå. Ajo ka shkronja si një fjalë - i dashur Jezus, njeri, ti ke shpikur një*

Takimi me Hitlerin pas pushtimit nazist të Norvegjisë

KNUT HAMSUN, SHKRIMTARI ME KARRIERËN MË TË ÇUDITSHME TË SHEKULLIT

Jeffrey Frank, *The New Yorker*

Përktheu: Granit Zela



fjalë me rëndësi të madhe gramatikore...Kuboå... Fjala u shqua fort në errësirën që kisha përballë. Ulem me sy hapur, i mahnitur nga zbulimi dhe duke qeshur me gëzim. Pastaj filloj të pëshpëris: ata mund të më spiunojnë dhe kisha ndërmend ta mbaja sekret shpikjen time. Kisha kaluar në çmendurinë e pastër të urisë”.

Pjesa e parë përfundon me rrëfimtarin në një gjendje gati të lumtur pasi merr dhjetë korona për një fejtën, por situata e tij në përgjithësi nuk duket se do të përmirësohet. Romani nuk respekton rregullat gramatikore, kohët kapërcehen dhe rrëfimtari duket gjithnjë e më i pavarur. Në fund, kur rrëfimtari hip në një anije, ngjan sikur Hamsuni ka hequr mënjane perden e shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe të shikonte absurditetet e shekullit të njëzetë.

“Uria” ishte një ndjesi letrare, megjithëse reagimi kritik ishte i përzier. Hamsuni natyrshëm shpresonte që Brandes, një zë i modernizmit, të bëhej aleat, por për Brandesin libri ishte monoton, një gjykim kaq i dhimbshëm për Hamsunin, sa që ai i shkroi, duke i thënë: “S’ndihem krejt vetëm pa ty, por pa mirëkuptimin tuaj, është e kotë të vazhdoj”. Ai besonte se Brandesi s’e kishte lexuar mjaftueshëm romanin: “Po ta shohësh në tërësi, s’mendoj se do të gjenit më shumë emocione psikike te “Raskolnikov” sesa në librin tim”. Brandesi dhe të tjerët, sidoqoftë, kishin filluar të kuptonin se Hamsuni jo vetëm që nuk ndihej rehat me kohën e tij, por ishte në shumë mënyra një personalitet që e kishte të pamundur t’i përshtatej, ndoshta edhe i rrezikshëm.

Knut Hamsun - i pagëzuar Knud Pedersen - lindi në vitin 1859 në Norvegjinë qendrore rurale. Tre vjet më vonë, familja u zhvendos në Hamarøy, për të punuar në Hamsund, një fermë që i përkiste xhaxhait të tij. Hamsun nuk ndoqi shkollën deri

në moshën nëntë vjeç, dhe më pas jo për shumë kohë; fëmijëria e tij ishte e izoluar dhe e mjerë. Xhaxhai, të cilin më vonë e përshkroi si “beqar i përjetshëm, dorështrenguar dhe gjakxehtë”, e rrihte me një vizore dhe abuzoi me të; por ai ishte gjithashtu përgjegjës për bibliotekën lokale dhe Hamsun pak a shumë vetëmësoi norvegjishten, e cila atëherë, në formën e saj të shkruar, ishte pothuajse identike me gjuhën daneze. Prejardhja e tij modeste dhe mungesa e edukimit zyrtar ishin çështje që lidheshin me ndjeshmërinë ashtu si edhe me krenarinë e tij; në një letër drejtuar Brandesit shumë vite më vonë, ai pyeti: “Çfarë di dikush si unë - i lindur fshatar-fermer, pa diplomë në asgjë, i paafte për të ulur dhe lexuar filozofi?”

Në adoleshencën e parakohshme, Hamsun kishte dy tregime të dobëta të botuara në tirazh shumë të kufizuar dhe, për shkak të kësaj, i kërkoi një tregtari të pasur norvegjez të quajtur Erasmus B. K. Zahl, mbështetje financiare. Për të tronditur Hamsunin, Zahl i dërgoi gjashtëmbëdhjetëqind korona, atëherë me vlerë rreth katërqind dollarë. Megjithatë, paratë nuk e çuan shumë larg dhe Hamsun luftoi për të mbijetuar, kryesisht në Kopenhagen, e cila në atë kohë ishte qendra e gravitetit kulturor në Skandinavi.

Në vitet tetëdhjetë, udhëtoi dy herë për në Amerikë. U ndal në Nju Jork, ku u mahnit nga një hekurudhë që ngrihej “në ajër, mbi shtëpitë e njerëzve”, por qëndroi më shumë në Wisconsin dhe Minesota. Kaloi gjithashtu tetë muaj në Çikago si fatorino teleferiku dhe punoi në një fermë të madhe në Dakota, një mjedis që e përdori për disa histori të hershme. Mendimi i Hamsunit për vendin ishte i përzier. Sipas tij Amerika ishte i pushtuar nga materializmi dhe patriotizmi i tepruar, dhe në një moment mbajti një fjalë

të zezë në mbështetje të katër anarkistëve të dënuar me varje pas bombës në Haymarket, në Çikago. Por i admironte parimet e shprehura në Deklaratën e Pavarësisë. Dhe e admironte Mark Tueinin, të cilin e pa duke mbajtur një leksion në Nju Jork, dhe nga i cili sigurisht mësoi shumë për përdorimin e të folurës së përditshme popullore. U kthye në atdhe në verën e vitit 1888.

Një vit pas botimit të “Uria”, Hamsun nisi serinë e leksioneve në Norvegji, duke sulmuar me guxim dhe pa pikë turpi brezin e vjetër letrar; një objektiv i veçantë ishte Ibseni, i cili atëherë ishte gjashtëdhjetë e tre vjeç dhe sapo ishte kthyer pas njëzet e shtatë vjetësh jashtë shtetit. Kur Hamsun foli në Kristiania (tani Oslo), Ibseni kishte një ndenjëse në rrethin e parë dhe aty ishin, ndër të tjerë, kompozitori Edvard Grieg, eksploruesi polar Fridtjof Nansen dhe një pianiste e re koncertesh, Hildur Andersen, e cili ishte bashkëpunëtorja më e ngushtë e Ibsenit. Pas gjysmë ore ligjëratë, siç e përshkruan Kolloeni, Hamsun shpërtheu në akuza ndaj Ibsenit i cili sipas tij kishte sjellë në skenë një përmasë psikologjike “të i rëndomtë dhe të rreme”. Ibseni, nga ana e tij, thjesht ndenji ulur aty, pas asnjë lloj reagimi. (Besohet të ketë pasur në mendje Hamsunin kur shkroi dramën “Arkitekti”, i botuar vitin e ardhshëm. Drama flet për një arkitekt të plakur, i cili është i tmerruar se mos e ka lënë pas brezi i ri. “Kam filluar të kem frikë, kaq shumë frikë nga të rinjtë, - thotë ai.

Hamsun, deri atëherë portreti i një artisti të ri, i kompletuar me syze pa bishta; një bashkëkohës e përshkroi si “të rrezikshëm për të gjitha gratë, interesant dhe mbresëlënës”. Grimca të kësaj mbrese vërehen në romanin e tij të dytë, “Misteret” (1892) - një titull i përshtatshëm për një nga librat e tij më të çuditshëm dhe më të çmuar. Gjithçka në lidhje me të është pak misterioze, që nga çasti kur “një i huaj u shfaq në qytet, një farë Nagel, një sharlatan i jashtëzakonshëm, i çuditshëm që bëri shumë gjëra të çuditshme”. Nuk është e qartë pse Nageli është atje ose çfarë do të përfitojë nga qëndrimi. Ai bie në dashuri me Dagny Kiellandin, vajzën e një kleriku dhe ka një lidhje me një grua më të vjetër; mban një kuti violine, por gati është e sigurt që s’ka asnjë violinë brenda.

Ai është ndoshta në kufijtë e çmendjes, dhe padyshim vetëvrasës; megjithëse romani ka një rrëfimtar në vetën e tretë, po aq provokues sa “Uria”. Biografi i Hamsunit me origjinë angleze, Robert Ferguson, citon përshkrimin e vetë Hamsunit për librin: “Heroi i “Mistereve” është një dukuri patologjike, pjesërisht i çmendur dhe pjesërisht gjeni” - përshkrim që ngjan shumë me autorin. Romani është disi fragmentar; monologët joracionalë ndërkëmbehen me diskutimet e Marksit, Tolstoit ose Ibsenit, dramat e të cilëve, s’është çudi që hidhen poshtë nga Nageli si “tallash i dramatizuar”.

Recensat për të, sërish, ishin të përziera; një kritik tha se Hamsuni “nuk kishte hequr dorë nga halucinacionet e sëmura të romanit “Uria” dhe u etiketua si një kopjues oportunist i letërsisë moderne ruse. Sot te “Misteret” mund të dallohet forma dhe shpirti i romanit modern, i krijuar në një kohë kur romani modern ende nuk ekzistonte.

Dy librat e ardhshëm “Botuesi Lyng” dhe “Tokë e përhimë”, ishin romane të mbështetura në personazhe realë, i pari për një redaktor të urrejtshëm gazete dhe i dyti një vështrim poshtëruar ndaj bashkësisë artistike në Kristiania, dhe meritojnë errësirën në të cilën kanë përfunduar. Por më pas erdhi “Pan”, botuar në vitin 1894, një roman i shkurtër, seksi, lirik i mbushur me aludime të mbinatyrshmes. Hamsun, me anglishten e tij të mangët, e përshkroi “Pan” me saktësi goxha të madhe në një letër drejtuar botuesit të tij gjerman, Albert Langen: “Mendoni për Nordlandin në Norvegji, këto rajone të Lapper-t, misteret, bestytnitë madhështore, diellin e mesnatës, mendoni për J. J. Rousseau në rajone, duke u njohur me një vajzë nga Nordlandi, ky është libri im”. Rrëfëhet si kujtime nga një Tomas Glahn, i cili është zhvendosur në pyllin verior me qenin e tij, Ezopin, dhe ngatërrohet në mënyrë romantike me Edvardën, vajzën e një tregtari të pasur vendas. Glahn, me “sy kafshë”, është si Nageli, i tërhequr nga veprimet joracionale.

Në një moment, Edvarda e krahason Glahnin në mënyrë të pafavorshme me një rival, një mjek të çalë. “Edhe sikur të ishe i çalë, para së gjithash, nuk mund të përballësia me të”, këmbëngul ajo. Glahn më vonë fillon të përsiasë: “Jo, edhe sikur të isha i çalë e para e punës, s’mund të dilja kundër doktorit, apo jo? Përfundimisht s’do të

përballesha me të; këto ishin fjalët e saj... Duke qëndruar në mes të dyshemesë, tund armën time, e vendos tytën në këmbën e majtë dhe tërheq këmbëzën. Plumbi më përshkon këmbën dhe dyshemenë. Ezopi i frikësuar, lëshon një psikamë të shkurtër".

“Pan” është i tillë; Glahn dhe Edvarda e mundojnë veten po aq sa mundojnë njëri-tjetrin, Glahn bën gjëra të tilla si hedhjen e njëres prej këpucëve të Edvardës në ujë “qoftë nga gëzimi që ajo është kaq e afërt ose prej një dëshire për të pohuar veten dhe për t’i kujtuar asaj ekzistencën time”. Ndër befasitë e librit është struktura, e cila përfshin një epilog, “Vdekja e Glahnit”, të treguar nga një rrëfimtari i dytë, i cili duket se i përket tërësisht një romani tjetër. S’ka rëndësi, rrëfimi i Glahnit dhe vdekja e tij i përkasin atij. Hamsun i shkroi Langenit se “çdo kapitull është një poemë, çdo varg i punuar shumë” dhe se çdo faqe, mendonte ai, ishte “mall mendimesh dhe fantazish”.

Romani tjetër “Viktoria”, një romancë e stërmbushur, verbuese, e ndërgjegjshme për klasën shoqërore dhe e dhimbshme për djalin e një mullixhiu që dashuron vajzën e një aristokrati, erdhi katër vjet më vonë, pikërisht pasi Hamsuni u martua me Bergljot Bech, vajzën e një familje të shuqar norvegjeze, dhe ishte suksesi i parë i vërtetë financiar. Kaluan gjashtë vite të tjera para se të botohej romani i tij i ardhshëm, “Ëndërrimtarët”, dhe pas kësaj karriera e Hamsunit filloi të merrte një rrugë disi të ndryshme.

Ingar Sletten Kolloen-i është biografi i parë që ka pasir mundësi të plotë përdorimi të arkivit të Hamsunit dhe në Norvegji, libri i tij shkaktoi debate të rëndësishme për bashkëpunimin e shkrimtarit me nazistët dhe për trajtimin nga autoritetet pas luftës. Kolloen tregohet veçanërisht i aftë në përshkrimin e jetës personale: e martesës së dytë me aktoren Marie Andersen, e trazuar nga xhelozia dhe tërbimi, kur ai ishte dyzet e nëntë vjeç dhe ajo njëzet e shtatë; dhe marrëdhënieve me fëmijët, një vajzë me Bergljotin dhe dy djem e dy vajza me Marien. Mund të shihet interesi i Hamsunit për çështjet botërore, i cili është mjaft i ngushtë: besimin në fatin e parcaktuar të Gjermanisë dhe, për arsye që askush nuk i ka kuptuar, ndonjëherë, urrejtjen ndaj Anglisë.

Robert Ferguson vëren se Hamsuni e kishte ushqyer këtë paragjykim që në rininë e tij dhe mund të hamendësohet vetëm se disa takime personale e ndihmuan të krijonte një pikëpamje për një komb të tërë; siç kanë vërejtur Kolloeni dhe të tjerët, britanikët ishin për Hamsunin siç ishin hebrenjtë për nazistët. Anglezët shfaqen në role arrogante në disa nga librat e tij. Në mes të “Në vendin e çudirave”, Hamsun kujton një udhëtim me tramvaj në Mynih: “Një vajzë e vogël . . . bie, futet midis kuajve dhe shkelet, lëndohet. Por arrijmë ta nxjerrim të gjallë. Ndërkohë britaniku po pi duhan me llullë. Kur gjithçka ka mbaruar dhe shoferi vonon një çast para se të niset, britaniku shikon orën i acaruar, dhe kërkon rimbursim të biletës”.

Në dy romane, “Benoni” dhe “Roza”, një anglez i përshkruar në mënyrë karikatureske takon dhe më pas martohet me Edvardën, vajzën nga romani “Pan” dhe te “Gëzimi i fundit”, i vitit 1912, Hamsun nuk vetëpërmbahet: “Anglia së shpejti do të duhet të krijojë shtëpi të të moshuarve për fëmijët e vet. Ajo i zhvesh nga identiteti gjinor njerëzit me anë të sporteve dhe ideve të ngulitura; nëse Gjermania nuk do ta kishte mbajtur në një gjendje shqetësimi të përhershëm, do të ishte kthyer te pederastia n”ë disa breza. Ndoshta, këto pikëpamje u përforcuan me kalimin e viteve, gjatë Luftës së Parë Botërore dhe më pas, për një arsye tjetër, më egoiste: Anglia kurrë nuk i vlerësoi në të vërtetë për librat e Hamsunit, ndërsa publiku i lexuesve gjerman e adhuroi qysh në krye të herës.

Në shekullin e ri, Hamsun dukej se pikëllohej për jetën e mëparshme; në pranverën e vitit 1907, mbajti një leksion, “Ndero të rinjtë”, në të cilin, afër të pesëdhjetave, denoncoi urdhëresën e katërt dhe, bashkë me të, brezin e prindërve të tij. (Kolloen vëren se Hamsun ishte aq i zënë me këtë leksion sa s’pati kohë të udhëtonte për në Hamarøy për të marrë pjesë në funeralin e të atit.) Pas “Gëzimi i fundit”, sikur të pranonte se nuk ishte më një rrëfimtari i besueshëm rinor, Hamsun e braktisi tërësisht rrëfimin në vetën e parë; me “Segelfoss Town”, në vitin 1915, ai filloi të shkruante romane voluminoze me dy vëllime, ngjarjet e të cilave vendosen në qytete të vogla të populluara nga endacakë, shitës droge, dhe burokratë. Deri më tani, më i suksesshmi prej

tyre ishte “Zgjimi i tokës”, botuar në vitin 1917, një sagë epike rreth mundimeve dhe gëzimeve të Isakut, një fermer, dhe Ingerit, një grua me buzë të shtrembëra me të cilën kalon një jetë.

“Zgjimi i tokës” ishte një sensacion i vërtetë në Norvegji, botimi i parë prej tetëmbëdhjetë mijë kopjesh u shit në rreth tre javë - një numër i jashtëzakonshëm në një vend me një popullsi nën tre milionë - dhe pothuajse që nga dita e botimit kishte zëra se Hamsun do të fitonte çmimin Nobel për Letërsinë. Kur nuk u dha asnjë çmim për letërsinë në vitin 1918, basti ishte se ai do ta merrte atë në vitin 1919, kur mbushi gjashtëdhjetë vjeç, por atë vit Akademia Suedeze zgjodhi një zviceran, Carl Spitteler-in, i njohur për katër vëllimet e tij poetike me titull “Pranvera olimpike”.

Kur fitoi Hamsuni, në vitin 1920, kjo ndodhi më shumë për shkak të “Zgjimi i tokës”, të cilën Akademia e pa si një mësim për “luftën heroike”. Libri ka pjesën e tij të errësirës - një ngjarje qendrore është vrasja e një foshnje, por ishte para së gjithash përbënte një kremtim të virtyteve të thjeshta rurale. Lexuesve sot mund t’u ngajë me llojin e romanit që vetë-shpallet i rëndësishëm, me të cilin Hamsuni i ri do të ishte tallur. Asokohe nuk i pëlqente më daljet publike dhe shkoi gati pa dëshirë në ceremoni, në Stokholm, ku, nën efektin e një jehone kureshtare për pohimet e tij “Ndero të rinjtë”, tha diçka shumë të trishtueshme dhe shumë të çuditshme: “Ajo që unë duhet në të vërtetë të bëj tani, në ndriçimin e plotë të dritave, përpara kësaj asambleje të lavdishme, është të mbuloj secilin prej jush me dhurata, me lule, me blatime poezie - të jesh edhe një herë i ri, të hipësh mbi kreshtën e valës... Sot më janë bërë ndere dhe lavde, por më ka munguar një dhuratë, më e rëndësishmja nga të gjitha, e vetmja që ka rëndësi, dhurata e rinisë”.

Në vitin 1970, një danez i quajtur Thorkild Hansen shkroi “Gjyqi i Hamsunit”, një studim me tre vëllime që pak a shumë arriti në përfundimin se nazizmi i Hamsunit ishte rezultat i pleqërisë (Hamsun ishte tetëdhjetë e një vjeç në prill 1940, kur ndodhi pushtimi gjerman); i shurdhimit (edhe radioja ishte deri diku e padobishme për të); iizolimit (jetonte në Nørholm, prona e tij në Norvegjinë jugore); dhe i ndikimit të gruas së tij, Maria, entuziazmi i së cilës për Gjermaninë naziste është i dokumentuar mirë. Biografia e Robert Fergusonit (1987) pak a shumë miratoi idenë se Hamsun nuk e kuptoi kurrë plotësisht poshtërsinë me të cilën e lidhi emrin e tij, një pamje ngushëlluese për njerëzit si unë, të cilët jo vetëm e donin Hamsunin, por s’mund të besonin se simpatitë e tij për pushtuesit ishin shumë të thella. (Filmi i shkëlqyer i vitit 1996 “Hamsun”, në të cilin Max von Sydöe luan Hamsunin e moshuar, ka këtë këndvështrim.) Por Kolloeni tregon se ishte më e ndërlikuar se kaq.

Ndërsa opinionet e Hamsunit u bënë shumë publike gjatë viteve 1930, ai dukej se e kuptoi që artisti dhe polemisti duhej të ndaheshin nëse duhej të lulëzonin të dy. Në vitin 1936, kur Hamsun ishte shtatëdhjetë e shtatë vjeç, u botua romani i tij i fundit, “Unaza është e mbyllur”, dhe recensentët vunë re me njëfarë lehtësimi që ishte thjesht një roman në të cilin, pavarësisht gjithçkaje, artisti i kishte qëndruar besnik artit të tij. Por admiruesit e tij e kishin parë me njëfarë shqetësimi qëndimin e tij politik; për shumë ishte e pafalshme kur, në mesin e viteve tridhjetë, ai sulmoi aktin e dhënies së çmimit Nobel për Paqen gazetarit anti-nazist Carl von Ossietzky, i cili ishte torturuar dhe burgosur nga kolegët e tij gjermanë. Edhe më keq, ai mbështeti Vidkun Kuislingun, ministrin norvegjez të mbrojtjes që themeloi Partinë por-fashiste të Bashkimit Kombëtar, në vitin 1933. Megjithëse kjo mund të tolerohej si një veprim trillan, gjithçka ndryshoi pas pushtimit gjerman të 9 prillit 1940. dhe Hamsuni u kërkoi bashkatdhetarëve të tij të flaknin armët dhe të bashkëpunonin.

Pushtuesit nazistë u bënë gjithnjë e më të pamëshirshëm dhe më të zgjuar në manipulimin e trofeut të tyre, Hamsun, i cili disa herë u përpoq të shpëtonte bashkatdhetarë të ndryshëm, gati gjithmonë pa sukses. Kur botuesi i Hamsunit, Harald Grieg, kërkoi ndihmën e tij për të siguruar lirin e një shkrimtari të cilin e kishte arrestuar Gestapo, Hamsun organizoi një takim me Jozef Terbovenin, Komisionerin e Rajhut në Norvegji. Terboven luajti të gjitha kartat me Hamsunin para se të thoshte jo; u ndanë me neveri të ndërsjelltë. Gazetat e Oslos, megjithatë, botuan fotografi të Hamsunit në një takim në dukje të gëzuar me Komisionerin e Rajhut, dhe ai sigurisht e kuptoi se ishte përdorur.

Hamsun nuk i miratoi politikat racore

të Hitlerit dhe, siç thekson Kolloeni, ishte në kontakt miqësor me hebrenjtë gjatë gjithë jetës së tij, duke përfshirë Georg Brandes-in dhe botuesin e tij të parapëlqyer, Christian König-un. Megjithatë, ai ishte një njeri i kohës së tij dhe një herë sugjeroi, jo sipas frymës së Deklaratës Balfour-it, se mund të ishte me përfitim për të gjithë nëse populli hebre do të kishte vendin e tij. Dy nga fëmijët e Hamsunit, i biri Tore, një artist dhe e bija, Ellinor, e cila studioi aktrim, jetonin në Berlin në fund të viteve 1930, megjithëse jo, me sa duket, me shumë entuziazëm për atë që po ndodhte. Kur Hamsuni i vizitoi në shkurt të vitit 1938, ata jetonin në një lagje hebreje dhe kishin miq hebreinj. Tore ishte veçanërisht i afërt me Maks Taunin, një botues, i cili ishte takuar me Hamsunët në Oslo; me ndihmën e Hamsunit, Tau u shpëtua nga nazistët.

Takimi i Hamsunit me Hitlerin u zhvillua në Berghof më 26 qershor 1943, një kohë kur lufta po shkonte keq për gjermanët. Hitleri, atëherë pesëdhjetë e katër vjeç dhe me shumë mjekime, nuk ishte në formë të mirë. As Hamsun nuk ishte; kishte pësuar të paktën një atak të lehtë në zemër dhe dëgjimi i ishte përkeqësuar. Pasi Hitleri e pyeti për zakonet e të shkruarit, duke shtuar se ai personalisht parapëlqente të punonte në mbrëmje, ai e çoi Hamsunin në dhomën e tij të punës, ku u shërbyen çaj dhe u ra dakord që Egil Holmboe, një norvegjeze, të bënte përkthimin. (Përkthyesi i zakonshëm i Hitlerit, Ernst Züchner, mbajti shënime pas një perdeje.) Hitleri me sa duket shpresonte që shkrimtari ta frymëzonte, ta gëzonte dhe ndoshta të fliste për gjenium, një temë që i interesonte gjithmonë. “Përveçse plotësisht i lidhur me ju, ndiej se jeta ime ngjan shumë në disa mënyra me tuajën” - i tha Hitleri në një moment. Por Hamsun-i nuk kishte dëshirë të fliste as për shkrimin, as për artin, as për gjenium. Ai donte të fliste për politikën dhe për egërsinë e pushtimit. Në veçanti, donte që Hitleri ta shkarkonte Jozef Terbovenin. Hamsuni filloi duke u ankuar se Terboveni po pengonte rrugët e kalimit të anijeve norvegjeze dhe kur Hitleri u përpoq të ndërpresë këtë linjë diskutimi, ai vazhdoi: “Për më tepër, Komisioneri i Rajhut në disa raste ka thënë se në të ardhmen nuk do të ketë asnjë vendi të quajtur Norvegji.”

“Ndryshe nga vendet e tjera të pushtuara”, i tha Hitleri, “Norvegjia ka qeverinë e saj”. “Gjithçka që ndodh në Norvegji vendoset nga Komisioneri i Rajhut”, ishte përgjigja e Hamsunit dhe ai u përpoq të shpjegonte se Terboveni po shkatërronte reputacionin e Hitlerit. Përfundimisht, Hamsuni bëri diçka të padëgjuar: e ndërpreu Hitlerin. Metodat e Komisionerit të Rajhut “nuk funksionojnë këtu, ne nuk mund ta durojmë prusianitetin e tij”, tha Hamsuni. “Dhe pastaj ekzekutimet! Duhet t’u jepet fund!” Züchner, pas perdes, e dinte që



Holmboe nuk e kishte përkthyer shpërthimin e fundit. Kur Hitleri filloi të fliste, Hamsuni e ndërpreu përsëri: “Terboveni nuk do një Norvegji të lirë, por një protektorat, kjo është perspektiva që ai na jep”. Pastaj ai kishte një pyetje: “A do t’i kujtohet atij ndonjëherë se për çfarë është këtu?” Hitleri u përpoq ta mbyllte temën, duke thënë: “Komisioneri i Rajhut është një luftëtar, ai është aty vetëm për detyra të lidhura me luftën”. Shumë shpejt Hamsuni filloi të qajë. “Nuk është se ne jemi kundër pushtimit”, i tha Hitlerit. “Do të na duhet për një kohë. Por ai njeri po shkatërron më shumë sesa mund të rindërtojë Hitleri!” Përsëri, Holmboe nuk e përktheu pjesën më të rrezikshme. Përkundrazi, ai u largua nga Hitleri dhe e paralajmëroi Hamsunin: “Mos fol”. Nuk kishte mbaruar me kaq. Hitleri filloi të fliste për prodhimin, për më shumë divizione tankesh dhe armë të reja sekrete. Ndërsa po fliste, Hamsuni u përpoq disa herë të tjera të ndërhynte, duke thënë se nuk kishte ardhur për këto. Kur Hitleri përsëriti se mund të shihej vullneti i mirë i Gjermanisë në faktin se Norvegjia kishte qeverinë e saj, Hamsuni, i dëshpëruar, e ndërpreu dhe tha: “Po flas me një mur!” Holmboe, shkruan Kolloen, nuk e përktheu as këtë duke thënë: “Ne kemi premtimin e Fyhrerit”. Para se të largohej, Hamsun tha: “Ne besojmë te Führeri, por dëshirat e tij po shtrembërohen”. Ai shtoi, “Nuk është lloji i duhur i ndryshimit në Norvegji. Gjithçka do të çojë në një luftë të re.” Edhe kjo mbeti e papërkthyer, por tashmë Hamsun kishte thënë mjaftueshëm që Hitleri të thoshte: “Mjaft! Ti s’kupton asgjë!” Hitleri doli jashtë dhe Hamsun qau përsëri; ai ishte veçanërisht i mërzitur që Hitleri nuk i kishte thënë personalisht lamtumirë. Më vonë, Hitleri u kishte bërtitur ndihmësve të tij: “Mos ta shoh më këtë lloj njeriu këtu!”

Reputacioni i Hamsunit ishte i rrënuar; jo vetëm q e kishte takuar Hitlerin, por, në një moment, i këshilluar gabim, ia kishte dhënë Gëbelsit medaljen e tij të çmimit Nobel. Fati i tij i pasluftës ishte tashmë në diskutim. Në nëntor 1944, në Moskë, Molotov, ministri i jashtëm sovjetik, diskutoi *rastin Hamsun* me Terje Wold-in, ministër norvegjez i drejtësisë në mërgim dhe Trygve Lie-n, ministër i jashtëm në mërgim. Autori i “Viktoria” dhe “Pan” është një artist shumë i madh për t’u trajtuar si një nazist i zakonshëm, tha Molotov, dhe, në një moshë kaq të shtyrë, duhet të lejohet të ketë vdekje natyrale. Wold u përgjigj në anglisht: “Ju jeni shumë i butë, zoti Molotov”.

Norvegjia u çlirua në maj të vitit 1945 dhe norvegjezët nuk i falën bashkëpunëtorët. Terboveni u vetëvra para se të pushkatohej; Kuislingu dhe drejtues të tjerë të Bashkimit Kombëtar u ekzekutuan me pushkatim në tetor dhe mijëra u burgosën, duke përfshirë Marie Hamsun, aktoren, shkrimtaren dhe bashkëshorten e Hamsunit e cila u dënua me tre vjet burg dhe gjobë. Hamsun u përball me akuza për tradhti, por askush s’dinte çfarë të bënte me shkrimtarin më të madh të kombit, tashmë pothuajse tetëdhjetë e gjashtë vjeç. Ai u arrestua dhe në tre vitet e ardhshme u mbajt në një azil pleqsh, në klinikën kryesore psikiatrike në Oslo dhe më pas u kthye në azilin e pelqeve. U vizitua nga disa mjekë dhe psikiatër dhe shumë norvegjezë u ngushëlluan me një gjetje psikiatrike se Hamsuni, megjithëse i arsyeshëm, ishte “përgjithmonë i dëmtuar” mendërisht. Vetë ai u ndie i fyer nga ideja që dikush mendonte se aftësitë e tij mendore ishin të mangëta. “S’kishte asnjë problem me mua, isha thjesht i moshuar dhe i shurdhër!” këmbënguli më vonë. Ai e dinte se njerëzit e shihnin si tradhtar prandaj nuk i lexonte gazetat.

Gjykata norvegjeze e gjobiti me katërqind e njëzet e pesë mijë korona (atëherë rreth tetëdhjetë e shtatë mijë dollarë) dhe u lejua të kthehej në Nørholm, ku pati një rënie të ngadaltë dhe të qëndrueshme fizike. Në pranverën e vitit 1950-të, e nxitur nga fëmijët e saj, Marie, e cila atëherë ishte gjashtëdhjetë e tetë vjeç, u kthye në shtëpi dhe, pas një ndarje katërvjeçare, gjithçka që Hamsuni i tha asaj ishte: “Ti ke ikur për një kohë të gjatë, Marie. Gjatë gjithë kohës që nuk ishe, nuk kam pasur me këtë flas përveçse me Zotin.” Pak ishin të gatshëm ta falnin atëherë për sjelljen gjatë luftës, dhe duket se edhe sot është e pamundur të bëhet një gjë e tillë. Megjithatë, mund të shikosh ende, i magjepsur, teksa shkrimtari bën kthesën e tij të fundit në librin “Nëpër shtigje të pashkelura”. Ai duket se po synonte atë që e kishte quajtur “dhurata e rinisë” dhe në ato faqet e fundit duket sikur kishte arritur, sado pak, ta rifitonte.



Lindur se prapthi!

RITA PETRO

OnufriRoman